

DREJT LISBONËS

Vlerësimi i nevojave për trajnime profesionale,
si dhe i krijimit të mundësive për punësim
të femrave në zonat rurale

unite for children

unicef 

DREJT LISBONËS

2

Vlerësimi i nevojave për trajnime profesionale,
si dhe i krijimit të mundësive për punësim të femrave në zonat rurale

Prishtinë, Shkurt, 2008

Ky raport është përpiluar nga Iniciativa Kosovare
për Stabilitet (IKS), me përkrahje të UNICEF-it.
Copyright © IKS

Foto: Hazir Reka
Petrit Rrahmani

Design: XHAD Studio

VEREJTJE

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë raport nuk paraqesin detyrimisht pikëpamjet dhe opinionet e UNICEF-it.

PERMABAJTJA

LISTA E TABELAVE	4
SHKURTESAT DHE AKRONIMET	5
FALËNDERIME.....	6
METODOLOGJIA	7
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	8
HYRJE	11
KAPITULLI I: NGA BUMI NË STAGNIM	17
Bumi i pasluftës	18
Zymtësia e pasluftës	20
Në kërkim të vendeve të punës?.....	21
Rrjeti i sigurisë	22
KAPITULLI II : REALITETET RURALE	25
Podujeva	26
Rahoveci	28
Skënderaj.....	30
KAPITULLI III: BOTA E MESHKUJVE	35
T'shkon f'tyra	36
Bota e meshkujve	39
Shkathtësitë e kërkuara	44
KAPITULLI IV: RETORIKA DHE REALITETI	49
Të paarritshme	52
KAPITULLI V: MUNDËSIA E DYTË	65
KAPITULLI VI: DREJT LISBONËS	75
KAPITULLI VII: PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE	81
ANEKSI I: PROPOZIMI PER SISTEMIN E ARSIMIT	92
ANEKSI II: TABELA E SHKATHTËSIVE TË NEVOJSHME	94
ANEKSI III: SHEMBULLI I PETESORIT: FEMRAT	95
ANEKSI IV: SHEMBULLI I PYTESORIT: NDERMARRESI	101
ANEKSI V: HARTA E KOSOVËS.....	105

LISTA E TABELAVE

Tabela 1	ILO 2007	15
Tabela 2	Popullata urbane/rurale Podujevë, Skënderaj, Rahovec	28
Tabela 3	Numri i bizneseve dhe i të punësuarve	41
Tabela 4	Bizneset e femrave në këto tri komuna	41
Tabela 5	Punësimi publik në komunën e Skenderajt, të Rahovecit dhe të Podujevës... 44	
Tabela 6	Shkathësitë e femrave në sektorin publik në Skënderaj, Rahovec dhe Podujevë	45
Tabela 7	Punëdhënësi më i madh i femrave	46
Tabela 8	Dhjetë punëdhënësit më të mëdhenj	48
Tabela 9	Qendra e Aftësimit Profesional në Mitrovicë	55
Tabela 10	Shkalla e pjesëmarrjes së femrave në të tri QAP.....	57
Tabela 11	Shkalla e arritshmërisë së të papunëve të regjistruar	59

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

ABETS	Sistemi për Arsimin dhe Aftësimin Bazik të të Rriturve
KAAP	Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional
ESPIG	Grupi për Strategjinë Ekonomike dhe Identifikimin e Projekteve
ESI	Iniciativa Evropiane për Stabilitet
ETF	Fondacioni Evropian i Arsimit dhe Trajnimit
BE Shtylla	Shtylla e Bashkimit Evropian në kuadër të UNMIK-ut
BVP	Bruto Prodhimi Vendor
GTZ	Bashkëpunimi Teknik Gjerman
ILO	Organizata Ndërkombëtare e Punës
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
ISCED	Klasifikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Arsimit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migrim
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat e Kosovës (NATO)
PSZHK	Plani i Strategjisë Zhvillimore të Kosovës
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MCYSNRA	Ministria e Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Çështjeve Jorezidente
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
KAMSH	Korniza Afat-Mesme e Shpenzimeve
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NATO	Organizata e Traktatit Veri Atlantik
EJF	Edukimi jo-formal
OJQ	Organizatë Joqeveritare
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
OXFAM	Oxford Committee for Famine Relief (organizatë humanitare britanike)
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetë-Qeverisëse
PTK	Posta dhe Telekomit i Kosovës
SASS	Përmirësimi i Shërbimeve për Mbështetje dhe Këshilla
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Administratës Ndërkombëtare në Kosovë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuar për Fëmijë
MB	Mbretëria e Bashkuar
SHB	Shtetet e Bashkuara
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
QAP	Qendra për Aftësim Profesional
PSHLF	Programi për Shkrim-Lexim të Femrave

FALËNDERIME

Ky studim është përgatitur nga Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS dhe bazohet në udhëzimet analitike të përgatitura nga ekspertja e edukimit Luljeta Belegu-Demjaha. IKS-ja ka qenë përgjegjëse për gjithë aktivitetin hulumtues në terren, analizën e të dhënave, draftimin dhe prezantimin. Luljeta Belegu-Demjaha në veçanti ka shikuar plan-programin dhe aspektet e aftësive të Programit për Shkrim-Lexim të financuar nga UNICEF-i. IKS-ja mban gjithë përgjegjësinë editoriale dhe analitike.

Ekipi, në emër të të gjitha femrave që kanë hasur në pengesë për t'u shkolluar dhe punësuar në viset rurale të Kosovës, dëshiron të falënderojë UNICEF-in në Kosovë, të cilët kanë marrë iniciativën për të ngritur çështjen e punësimit dhe nevojën për aftësi profesionale të femrave nga viset rurale, duke përkrahur këtë studim. Shpresojmë që të gjeturat dhe rekomandimet do të ndihmojnë Qeverinë e Kosovës dhe donatorët që të ndërtojnë politika me qëllim të fuqizimit të grave përmes edukimit dhe trajnimit dhe me këtë rast të promovojnë një zhvillim më të qëndrueshëm dhe më të barabartë në të ardhmen. Edukimi për të gjithë është qenësor për lehtësimin e varfërisë, si dhe për kohezion social dhe ekonomik.

Falënderimi ynë i veçantë shkon për Aferdita Spahiun, udhëheqëse e sektorit për edukim pranë UNICEF-it në Prishtinë, si dhe për zyrtares e projektit për edukim Kozeta Imamin. Ne i falënderojmë për përkrahje të vazhdueshme dhe ndihmë gjatë gjithë projektit.

Gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë stafin e Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe stafin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për udhëzime të vlefshme dhe për përkrahje. Një falënderim i veçantë shkon për të gjithë zyrtarët e komunave, mësuesit, aktivistet e OJQ-ve, nxënëset femra, si dhe ndërmarrësit të cilët kanë ndarë kohën, mendimet dhe ekspertizën e tyre me ekipin tonë.

Përfundimisht, mirënjohja jonë shkon edhe për pjesëmarrësit të cilët kontribuan me komentet e tyre gjatë seminarit të mbajtur më 28 shkurt në Prishtinë.

METODOLOGJIA

Analizat janë të bazuara në metodologjinë hulumtuese të kombinuar me të dhëna të konsultuara nga literatura e gjerë, si dhe me hulumtime kualitative dhe empirike. Hulumtimi në terren është kryer nga një ekip i gjerë i përbërë prej gjashtë analistëve dhe hulumtuesve dhe është zhvilluar prej muajit korrik 2007 deri në muajin tetor të vitit 2007.

Raporti bazohet në më shumë se 150 intervista me politikbërës, praktikantë, femra dhe aktorë të bizneseve në komunat si Prishtinë, Podujevë, Prizren, Rahovec, Skënderaj dhe Mitrovicë. Intervistat shumë detaje me informuesit kyç janë karakteristikë që përkufizojnë këtë metodologji hulumtimi, siç edhe ilustron me përdorimin e citateve dhe tregimeve personale.

Intervistat janë zhvilluar në formë të gjysmëstrukturuara, bazuar në dy pyetësorë të dizajnuar enkas për të kuptuar trendet e tregut të punës dhe shkathtësitë që u nevojiten ndërmarrësve vendorë në të ardhmen, si dhe për të identifikuar pengesat që ndalojnë femrën për të qenë pjesë përbërëse e ekonomisë. Pyetësorët janë shoqëruar me intervista detaje, si dhe me vizita në terren. Të gjeturat në këtë raport janë të prezantuara me anë të tregimeve, tabelave dhe përqindjeve.

Që të tri mostrat e komunitetit janë të ndryshme në madhësi (që sillen prej 72.490 deri më 131,300 banorë), në pozitë gjeografike, strukturë ekonomike dhe në nivelin e të hyrave. Të bashkuara, ato ndajnë shumë karakteristika, që janë tipike për Kosovën rurale dhe paraqesin një ndërthurje të çështjeve dhe sfidave. Mostra e bizneseve të intervistuar sillen prej kompanive me një punëtorë femër deri te kompanitë me 367 punëtorë, prej atyre private deri në ato në pronësi shoqërore, si dhe kompanitë e sapoprivatizuara. Bizneset e intervistuar janë një pasqyrim i sektorit privat në Kosovën rurale.

Në harmoni me përshkrimin e detyrave, Kapitulli i parë përbëhet prej një përmbledhjeje mbi indikatorët aktual makroekonomikë, si dhe trendeve të punësimit. Kapitulli 2 dhe 3 fokusohen në shkathtësitë e nevojshme dhe trendet e tregut të punës, në të tri komunat e përdorura si model, që gjenden në pjesën perëndimore, qendrore dhe verilindore të Kosovës. Kapitulli 3 e njofton lexuesin me pikëpamjet tradicionale të cilat kufizojnë zgjedhjet e femrave. Kapitulli 4 përmban një rishikim kritik të masave dhe programeve ekzistuese për aftësimin profesional dhe edukimin e të rriturve. Po ashtu, prek çështjen e arritshmërisë, rëndësisë së tregut të punës, buxhetin për edukimin dhe trajnime dhe barazi gjinore. Kapitulli 5 përmban një vlerësim të Programit të UNICEF-it për shkrim-lexim të femrave, dhe po ashtu shqyrton ide të ndryshme se si të shkohet përpara. Në kapitullin konkludues ne adresojmë lidhjen mes edukimit, punësimit dhe migrimit dhe prezentojmë një vizion për të ardhmen. Rekomandimet mbi politika janë të përmbledhura në Kapitullin 7.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në mes të bisedimeve diplomatike rreth statusit final të Kosovës është shumë e lehtë të humbasësh shikimin për sfidat afatgjata zhvillimore që duhet të adresohen sa i përket të ardhmes politike. Janë pesë çështje të një rëndësie të veçantë, që politikëbërësit e Kosovës nuk duhet t'i injorojnë:

- **Analfabetizmi funksional vazhdon të jetë i shpërndarë.** 14 për qind e femrave rurale, krahasuar me 4 për qind të meshkujve rural, janë analfabete¹. Ndërsa rreth 12.5 për qind pranohet të jenë analfabetë funksional². Me fjalë të tjera, një në katër femra nuk di të lexojë recetat e mjekut, si të votojë, si të kërkojë certifikatën e lindjes prej komunës, si të mbledhë çmimet në tregun vendor, si dhe nuk di të lexojë përralla për fëmijët e vet.
- **Femrat janë burimi më i madh i ekonomisë së Kosovës,** i cili mbetet i pashfrytëzuar. Në mungesë të shkathtësive bazike të shkrimit dhe leximit, shumica e femrave janë të përjashtuara prej tregut të punës. Dy nga tri femrat në moshë pune janë joaktive në ekonomi: vetëm nëntë për qind e femrave kanë punë me pagesë. Biznese në pronësi të femrave përbëjnë vetëm nëntë për qind³. Gjendja është edhe më dramatike mes femrave me shkathtësi të dobëta, ku më pak se pesë për qind e femrave pa shkollë të mesme kanë qenë të punësuar në vitin 2006⁴.
- **Përderisa Kosova nuk investon më shumë në njerëzit e saj,** nuk ka asnjë mundësi që të bëhet një ekonomi konkurente brenda Bashkimit Evropian. Kosovës i duhen urgjentisht politika integruese për të shndërruar ekonominë rurale, si dhe i duhen fonde për të investuar në zhvillimin e kapitalit njerëzor. E ardhmja e grave fermere, të rinjve dhe minoriteteve varet prej mundësive të tyre për rritjen e produktivitetit të fermave, për të bërë një tranzicion të suksesshëm prej punësimit joformal ose për të gjeneruar të ardhura përmes vetëpunësimit. Investimet në shkathtësitë bazike dhe në të mësuarit gjatë gjithë jetës janë qenësore. Dështimi për të rritur punësimin e femrave rurale do ta mbajë Kosovën peng të një rrethi vicioz të moszhvillimit dhe varfërisë rurale.

1 UNICEF, Elena Galliano, Elena Volpi, dhe PRISM, 'Arsimi në fëmijëri të hershme & Programi shkrim-lexim për femra, Raporti përfundimtar, Vlerësimi afatmesëm, fq.5, 2004

2 MASHT, UNICEF dhe ESK 'Shqyrtim i çështjeve gjinore në Kosovë', 2002, fq.7

3 ESK, Numri i bizneseve të regjistruara dhe taksapaguesve të bizneseve në pronësi të femrave për vitin 2006, siguruar nga Hysni Elshani, zyrtar i statistikave në ESK, shtator 2007.

4 ESK Statistikat sociale 'Statistikat e tregut të punës', fq.34

- Çelësi i stabilitetit të Kosovës varet nga edukimi dhe rritja e mundësive për punësim.** Sapo Kosova të kalojë prej ekonomisë agrare në një ekonomi moderne, teprica e punëtorëve në bujqësi duhet të kalojë prej bujqësisë për ekzistencë në punë jashtë bujqësisë dhe të bazuara në shkathtësi. Në vitet që do të vijnë Kosova nuk ka shans që të krijojë vende të mjaftueshme pune për të absorbuar papunësinë. Kosovës i nevojitet ndihmë nga jashtë për të lehtësuar këtë presion. Si shenjë e zotimit për stabilitet dhe prosperitet në rajon, Bashkimi Evropian duhet të investojë në edukim dhe trajnim në Kosovë dhe t'i hapë kufijtë për migrim të përkohshëm jashtë Kosovës. Pa një mundësi të sigurt ekonomike përmes migrimit të fuqisë punëtore, Kosova mund të përballet me rrëmujë sociale dhe jostabilitet politik.
- Shoqëria kosovare - politikanët, shoqëria civile, mësuesit, mediat dhe kritikët** duhet të vështrojnë me kujdes qëndrimet kulturore, traditën si dhe normat shoqërore që pasqyrojnë rolin dhe pozitën e femrave, si dhe zgjedhjet dhe mundësitë e tyre të limituara. Evropianizimi i Kosovës së pari duhet të fillojë në mendje dhe në shtëpi. Ligjet të cilat sigurojnë barazi gjinore shpesh nuk janë të mjaftueshme për të eliminuar pabarazitë e vazhdueshme gjinore. Po ashtu, mbështetja vetëm në zhvillim ekonomik nuk është e mjaftueshme për të adresuar pabarazitë gjinore. Lufta kundër paragjyqimeve dhe përjashtimeve është përgjegjësi e çdokujt.

Qëllimi i këtij raporti është që të japë ide të reja dhe të kontribuojë në dizajnimin e strategjive gjithëpërfshirëse për t'i fuqizuar gratë që të marrin rol më aktiv në shoqërinë dhe ekonominë e Kosovës. Ky raport ka për qëllim që të nxisë debate të nivelit kombëtar, duke nxjerrë në pah lidhjet mes zhvillimit ekonomik, edukimit dhe mundësive për punë. Gjithashtu ka për qëllim ngritjen e vetëdijës për luftimin e barrierave kulturore dhe paragjyqimeve të cilat kufizojnë zgjedhjet e femrave.

Prandaj, ky raport është më shumë se vetëm për femrat rurale, në thelb është për të ardhmen ekonomike të Kosovës. Në qoftë se Kosova me të vërtetë pretendon që të bashkohet drejt standardeve evropiane të jetesës, promovimi i të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimi i kapitalit njerëzor duhet të zërë vend qendror në strategjitë e zhvillimit social dhe ekonomik⁵.

Edukimi dhe trajnimi janë instrumente për të zhvilluar një shoqëri çfarë Kosova dëshiron të jetë në të ardhmen. Edukimi është qenësor për të bërë Kosovën një lojtar konkurrent në Evropë, si dhe t'i ndihmojë shoqërisë kosovare që të bëhet 'evropiane' në kuptim të barazisë gjinore, sociale dhe ekonomike. Edukimi po ashtu luan një rol të rëndësishëm në konsolidimin e demokracisë së re të

Kosovës. Demokracia varet nga pjesëmarrja aktive e qytetarëve dhe nga aftësia e njerëzve për të bërë zgjedhje të duhura.

Sfidat janë shumë të mëdha, por Kosova nuk ka nevojë ta zbulojë rrotën. Kur Portugalia i është bashkuar bashkësisë më 1 janar të vitit 1986, niveli i vijimit të shkollës ka qenë shumë larg mesatares evropiane. Në vitet e mëhershme, një valë e konsiderueshme e migrantëve portugezë për punë kanë lëvizur në veri, në kërkim të punëve në ndërtim apo bujqësi. Katërmbëdhjetë vjet më vonë, me 23-24 mars të vitit 2000, Portugalia ka organizuar samitin historik të Bashkimit Evropian. Në Lisbonë, kryetarët e shteteve evropiane soleminisht kanë miratuar se njerëzit janë pasuria më e madhe e Evropës. Kur është nxjerrë strategjia e Lisbonës, qeveritë evropiane janë pajtuar se deri në vitin 2010 Bashkësia Evropiane duhet të bëhet 'ekonomia më konkurruese në botë dhe ekonomia më dinamike e bazuar në njohuri, e aftë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik me më shumë vende pune dhe me vende pune më të mira'⁶.

HYRJE

*'Edukimi mund të ndihmojë në vendosjen e themeleve për paqe, ndërtim të kombit, zvogëlim të varfërisë, si dhe rritje ekonomike. Nuk është e tepërt të thuhet se e ardhmja e Kosovës varet nga ajo se çka dhe si investon në arsimimin e njerëzve të saj'*⁷

Ekonomitë bashkëkohore drejtohen nga informacioni dhe dituria. Një e vërtetë e dhimbshme është se të metat e sistemit të arsimit dhe të trajnimeve në Kosovë, si dhe niveli i ulët i shkathtësive janë bërë pengesë për rritjen dhe zhvillimin ekonomik. Kosova ka hyrë në një rreth vicioz me një rritje të ngadalshme ekonomike, zhvillim të dobët të sektorit privat dhe varfëri rurale.

Me të ardhura për kokë banori prej 1.300 €, Kosova është një ishull i varfër mu në zemër të Evropës⁸. Me vetëm 54 për qind të popullatës në moshë pune ekonomikisht aktive, Kosova ka shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në Evropë. Bujqësia mbetet punëdhënësi më i madh; 85 për qind e ushqimit të prodhuar në Kosovë kurrë nuk përfundon në treg. 45 për qind e popullsisë në Kosovë jeton nën shkallën e varfërisë, me më pak se 1.4 Euro në ditë⁹. Numri i të papunëve të regjistruar është rritur pandërprerë dhe çdo vit afër 30.000 të rinj tjerë hyjnë në tregun e punës. Rritja ekonomike në shkallë prej 3.1 për qind, siç është parashikuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, nuk është e mjaftueshme për të filluar absorbimin e të papunëve ekzistues¹⁰.

Kosova nuk ka fonde, infrastrukturë dhe resurse njerëzore për ta përmirësuar ekonominë e saj pa ndihmë nga jashtë. E varur mjaft shumë nga donatorët dhe importi, Kosova pothuajse nuk eksporton asgjë në tregjet e jashtme. Vetëm 6.2 për qind e importeve mbulohen nga eksporti; dy të tretat e të hyrave të qeverisë mbledhen në kufi, përmes pikave doganore, akcizës dhe TVSH-së në importe. Në vitin 2005, afër 6.5 për qind e BPV varej drejtpërdrejt nga prezenca e UNMIK-ut. Infrastruktura kryesore e Kosovës –duke filluar nga energjia, rrugët dhe sistemi i ujitjes–është vjetëruar, ndërsa kapitali njerëzor i saj është shterur.

7 FET, 'Plani shtetëror i FET-it për Kosovën, 2007', fq.2

8 Korniza afatmesme e shpenzimeve 2008-2010, Vëllimi I, Korniza makro fiskale, Draft 17 korrik 2007, fq.4

9 Banka Botërore ' Vlerësimi i varfërisë në Kosovë: Përshpejtimi i rritjes ekonomike për të zvogëluar varfërinë e përhapur, Vëllimi I, tetor 2007

10 Korniza afatmesme e shpenzimeve 2008-2010, Vëllimi I, Korniza makro fiskale, Draft 17 korrik 2007, fq.6

Analfabetizmi funksional është mjaft i përhapur: 62 për qind e popullatës së rritur në Kosovë kanë nivel të ulët të arsimimit dhe vetëm 1 për qind kanë përfunduar shkollimin e lartë¹¹. Megjithëse niveli i analfabetizmit tek personat nën moshën 45- vjeçare ka rënë nën 5 për qind, analfabetizmi i femrave është ende tri herë më i lartë se ai i meshkujve¹². Analfabetizmi është veçanërisht i lartë tek femrat e fshatit, me 14 për qind femra analfabete, krahasuar me 4 për qind meshkuj analfabete të fshatit¹³. Përfshirë edhe ato që mezi lexojnë apo shkruajnë, rezulton se afër një në katër femra të fshatit janë analfabete funksionale.

Një pjesë e problemit është trashëguar nga diskriminimi dhe moskujdesi dhjetëvjeçar. Që nga viti 1991 e tutje, arsimit ka qenë arenë qendrore politike. Arsimit fillor, i garantuar me kushtetutë, u zhvillua nën kushtet e diskriminimit dhe diferencimit. Në mes të studentëve shqiptarë dhe atyre serbë u ndërtuan mure ndarëse, ndërsa turnet e mësimi u bënë në atë mënyrë që ata të ishin të ndarë veç e veç. Arsimit i mesëm dhe i lartë shqiptar u zhvillua fshehurazi nëpër shtëpi private, shtalla dhe garazhe. Sistemi i edukimit paralel, i financuar nga taksat vullnetare, ia doli mbanë të mbledhë 330.000 studentë nëpër shkolla, por një numër i madh i vajzave, veçanërisht në zonat rurale, e ndërprejnë krejtësisht shkollimin.

Niveli i analfabetizmit në mesin e kësaj 'gjeneratë të humbur' – femrave të reja të moshës shkollore gjatë viteve 1990 – është tri herë më i lartë se për meshkuj. Rreth 16 për qind e femrave mes moshës 16 dhe 19- vjeçare nuk kanë as edhe një ditë shkollë; një e katërta e tyre ka përfunduar vetëm katër vjet të arsimit fillor¹⁴. Dy të tretat e femrave në moshë punuese (25 deri në 64- vjeçare) kanë vetëm shkollën fillore ose më pak¹⁵.

Por, një pjesë e problemit është po ashtu dështimi i politikëbërësve të sotëm që të trajtojnë seriozisht çështjen e arsimit. Situata është alarmante; një prej dy fëmijëve e ndërpresin shkollimin pa i mbushur ende 18 vjet¹⁶. Dy të tretat e të rinjve e ndërpresin shkollimin pa asnjë kualifikim¹⁷. Afër 12 për qind e ndërpresin shkollimin e obligueshëm dhe 28 për qind nuk e përfundojnë shkollimin e mesëm¹⁸. Veçanërisht sa i përket shkollimit të femrave, Kosova mbetet shumë larg Evropës dhe mbetet pas vendeve fqinje në rajon. Me vetëm një në dy vajza shqiptare që vazhdojnë shkollimin e mesëm, niveli i vijueshmërisë së femrave në shkollimin e mesëm është ndër më të ulët në Evropë¹⁹.

11 FET, 'Plani shtetëror i FET-it për Kosovën, 2007', fq.2

12 Observimi i punësimit dhe shkathtësive në Kosovë 'Integrimi me Evropën: strategjia për mësimin e të rriturve për Kosovën (2005-2015), prill 2004, fq.18

13 UNICEF 'Arsimi në fëmijëri të hershme & Programi shkrim-lexim për femra, Vlerësimi afatmesëm', fq. 5, 2004

14 MASHT, UNICEF, ESK 'Shqyrtim i çështjeve gjinore në arsimin në Kosovë', 2002, fq.21

15 RIINVEST, 'Arsimi dhe zhvillimi ekonomik në Kosovë', Prishtinë, 2004

16 ILO 'Shqyrtimi i politikave të punësimit për Kosovën', i papublikuar, 2006


17 Më pak se një e treta e personave të moshës 15-19 vjeçare marrin pjesë në arsim dhe trajnime; niveli më i ulët në Ballkanin Perëndimor. Vetëm 1 në 5 prej të gjithë personave të moshës 19 – 20 vjeçare vazhdojnë shkollimin terciar. Dy të tretat e meshkujve kanë së paku shkollën e mesme, por vetëm një e treta e femrave. Burimi: Integrimi me Evropën: strategjia për mësimin e të rriturve për Kosovën (2005-2015), Observimi i punësimit dhe shkathtësive në Kosovë, prill 2004

18 ILO 'Shqyrtimi i politikave të punësimit për Kosovën', i papublikuar, 2006

19 ESK, Statistikat e Tregut të Punës, 2002

Varfëria e përhapur po ashtu reflektohet në rezultate të dobëta arsimore. Teorikisht, shkollimi është falas për të gjithë, por ngarkesat financiare për t'i paguar librat shkollorë, ushqimin dhe udhëtimin, krejtësisht mbeten barrë e familjeve. Afër 34 për qind e të rinjve e ndërpresin shkollimin për shkaqe ekonomike.

Tabela 1: ILO 2007²⁰



Lënia anash në masë të madhe e femrave të fshatit nga shkollimi dhe mësimi gjatë gjithë jetës e dëmton shoqërinë kosovare në shumë mënyra. Femrat luajnë një rol të rëndësishëm si edukatore dhe arsimimi i ndihmon nënat që të sigurojnë zhvillim normal të fëmijëve të tyre. Arsimimi po ashtu i ndihmon femrat fermere që ta adaptojnë produktivitetin sipas teknologjive të reja, të kenë qasje në shërbimet këshillimore, të marrin kredi rurale dhe të investojnë në aktivitete fitimprurëse. Arsimimi është mbrojtje nga varfëria ekstreme; janë femrat kryefamiljare ato më të goditurat nga kjo varfëri ekstreme dhe nga lënia anash. Arsimimi i fuqizon femrat, duke i bërë ato më pak të varura financiarisht e po ashtu më pak të varfra në aspektin social. Shkollimi po ashtu u mundëson femrave që të jenë pjesëmarrëse aktive si qytetare dhe votuese, që rezulton me stabilitet më të lartë dhe kohezion shoqëror²¹.

Ky raport i tanishëm shqyrton detajisht shkaqet e përqindjes së lartë të ndërprerjeve dhe vijimin e ulët të shkollimit të femrave të fshatit dhe përpiket që t'i identifikojë pengesat e punësimit të femrës në Kosovën rurale. Raporti nxjerr në pah trendet e tregut të punës dhe shkathtësive që kërkohen në tri komunat rurale dhe po ashtu vlerëson rolin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), si dhe të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) në sigurimin e qasjes së barabartë në arsim dhe trajnime profesionale. Raporti konkludon se institucionet

20 UNMIK, IPVO, ILO 'Plani i veprimit për rini', 2007, fq.29

21 Raport i Bankës Botërore për hulumtimin për politika 'Stimulimi i zhvillimit përmes barazisë gjinore në aspektin e të drejtave, burimeve dhe të drejtës për t'u shprehur, janar 2001, fq.100

përgjegjëse kanë dështuar t'i realizojnë premtimet e tyre, të shkruara në ligjet dhe në dokumentet strategjike. MASHT-i, në veçanti, e ka humbur mundësinë që të zhvillojë Programin për Shkrim-Lexim të femrave, i filluar në vitin 2002, me qëllim të luftimit të analfabetizmit të femrave në vend. Shërbimet për punësimin publik, që janë nën MPMS, kanë dështuar në integrimin e femrave në programet e tyre për aftësime profesionale dhe nuk iu përgjigjen nevojave të tregut të punës. Me dy të tretat e femrave jashtë punës, ekziston një sasi e konsiderueshme e punës për t'u bërë, për të mënjeluar pabarazitë ekonomike mbi baza gjinore.

Nuk ka rregullim të shpejtë në politikat e arsimit, andaj donatorët dhe politikbërësit duhet të jenë të durueshëm. Investimet në arsim marrin kohë derisa të japin rezultate dhe kërkojnë planifikim afatgjatë dhe përfshirje të disa ministrive dhe bartësve tjerë, për një kohë më të gjatë. Investimi në arsimimin dhe aftësimin profesional të femrave të fshatit nuk nënkupton që në mënyrë magjike dhe të menjëhershme të arrihet një nivel më i lartë i punësimit të femrave. Në mënyrë që Kosova të ketë ndonjë shans 'Drejt Lisbonës' deri në vitin 2022, zhvillimi i resurseve njerëzore duhet të jetë prioritet kombëtar.

Politikbërësit kosovarë duhet të jenë largpamës; duke investuar në arsimimin dhe trajnimin e gjysmës së popullsisë suaj, do të thotë të investoni në të ardhmen tuaj. Ekzistojnë shumë anë pozitive nga ekzistimi i një barazie më të madhe në mes të dy gjinive. Shoqëria kosovare do të korrë rezultate në një periudhë afatgjate, atëherë kur sa më shumë femrave rurale do t'u jepet mundësia e zhvillimit të shkathtësive kryesore dhe e rritjes së punësueshmërisë së tyre. Zvogëlimi i dallimit gjinor në shkollim dhe shkathtësi do ta rrisë produktivitetin, do t'i rrisë të ardhurat e familjeve rurale dhe do të nxisë kohezionin social.

Politikbërësit evropianë po ashtu duhet të jenë largpamës dhe të kuptojnë se të investosh sot në kapitalin njerëzor të Kosovës do të thotë të investosh në forcën e ardhshme punuese të Evropës. Është në vetë interesin e Evropës që ta ndihmojë kalimin e Kosovës nga një shoqëri agrare në ekonomi tregu evropiane dhe konkurrenente. Pa burime shtesë për zhvillimin e resurseve njerëzore dhe pa migrim të forcës punuese në një periudhë afatmesme, ky raport argumenton se rajoni rrezikon të hyjë në një varfëri më të madhe ekonomike dhe me pakënaqësi sociale. Në fund të fundit, sukcesi i projektit evropian në Kosovë do të vlerësohet në klasa, zyrat e punësimit dhe në shtëpitë rurale.





KAPITULLI I: NGA BUMI NË STAGNIM

Në verën e vitit 1998, ekonomia e Kosovës ishte e shkatërruar. Konflikti rezultoi me 120,000 shtëpi të dëmtuara apo të shkatërruara. Sektori i bujqësisë ishte i shkatërruar dhe shumica e gjedheve ishin vjedhur. Infrastruktura kryesore, prej rrugëve e deri te shkollat, ishte në gjendje të mjerueshme. Mungesa e investimeve dhe dëmtimet e ngjashme i shndërruan shumicën e shërbimeve publike, përfshirë edhe ato më të mëdha, atë të energjisë, të ujit dhe telekomit, në kompani jofunksionale. Varfëria dhe vuajtja ishin përhapur në tërë vendin.

Kosova ka qenë gjithmonë pjesa më e varfër e Jugosllavisë. Industrializimi në Kosovë ka filluar vonë dhe është përqendruar kryesisht në industrinë e mëdha, si ajo e minierave, metalurgjisë dhe bujqësisë. Të ardhurat për kokë banori në vitin 1981 ishin sa një të tretat e të ardhurave mesatare në Jugosllavi dhe shkalla e papunësisë, sipas të dhënave zyrtare ishte afër 40%. Në fillim të viteve të 1990-ta prodhimi industrial u shkatërrua dhe e ktheu ekonominë e Kosovës në një ekonomi agrare. Legjislacioni diskriminues rezultoi me përjashtim masiv të shqiptarëve të Kosovës nga vendet e punës në sektorin publik. Në këtë krizë, familjet mbijetuan duke u marrë me bujqësi dhe duke migruar. Rrjetet e familjeve të zgjeruara zëvendësuan shtetin. Në fillim të vitit 1990 qeveria e shqiptarëve në ekzil ka vlerësuar se afro 217.000 e shqiptarëve të Kosovës kishin migruar, kryesisht në Gjermani dhe Zvicër. Në fund të vitit 1990, vlerësohet të ketë pasur gjysmë milioni kosovarë që jetonin jashtë vendit, që punonin dhe dërgonin para në vend. Paratë që silleshin në Kosovë nga punëtorët emigrantë krijuan një rrjet të sigurisë ekonomike, por nuk arritën të mënjanojnë efektet e tmerrshme të represionit politik dhe ekonomik. Më 1996, BPV kishte një rënie dhe zbriti në më pak se 400 dollarë amerikanë.

Bumi i pasluftës

Në verën e vitit 1999, "ngritja" filloi nga zero. Prezenca e asistencës ndërkombëtare rezultoi me një shpërthim të menjëhershëm në tregti dhe në ndërtimtari. Në vitet e para, me ndihmën e donatorëve dhe diasporës, Kosova pati një rritje të dyfishtë dhe në vitin 2001 të ardhurat mesatare arritën në 750 dollarë amerikanë²². Deri në vitin 2005, FMN ka vlerësuar se shpenzimet e përgjithshme ndërkombëtare në Kosovë kane kaluar 5 miliardë Euro, gjysma e të cilave janë harxhuar në rrogat e ndërkombëtarëve²³. Në pikën kulminante, punësimi i stafit vendor arriti në 5,242 (2001) dhe staf ndërkombëtar në 5,931 (2002), si dhe ngritje në prodhimet dhe shërbimet vendore.

22 Banka Botërore, Rishikimi institucional dhe i shpenzimeve publike në Kosovë, Vëllimi I, 2006

23 IMF ' Kosova: Shtytja e politikave drejt rritjes dhe zhvillimit ' 2005

Prezenca e madhe e UNMIK-ut ngriti kërkesat e qirasë, të shitjes dhe shërbimeve²⁴. Shitoret e vogla, restorantet dhe kafenetë u shtuan si kërpuhat pas shiut për nevojat e ndërkombëtarëve dhe vendorëve. Deri në vitin 2006, numri i bizneseve të regjistruara kishte arritur shifrën 55,884²⁵.

Përveç donatorëve, fitimet dhe kursimet e kthyer në shtëpi nga kosovarët që punonin jashtë po ashtu rritën dukshëm konsumin dhe kërkesat, sidomos në ndërtimtari dhe tregti. Në vitet e para, familjet kosovare kanë pranuar më shumë para të gatshme nga të afërmit sesa nga puna e tyre në Kosovë. Në vitin 2002, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka vlerësuar se nga të ardhurat e përgjithshme në Kosovë 1.570 milionë €, 720 milionë € vijnë nga të ardhurat e pagave nga jashtë²⁶. Ndihma e huaj dhe të hyrat private në formën e kursimeve dhe pagave nga jashtë llogaritet që përbëjnë gjysmën e BVP-së së Kosovës në kohën kur arriti kulminacionin.

Rrjedha e fondeve të donatorëve dhe të ardhurave i mundësuan Kosovës që të ringjallin tregun e saj, që ishte një nga tregjet më të varfëra në botë. Në vitin 2003, importi është ngritur në 966 milionë € dhe në vitin 2006 vlera e përgjithshme e importit ishte 1.241 milionë €. Sidoqoftë, me 77 milionë € në eksport, vetëm 6.2 % të importit mbuloheshin nga eksporti, dhe metalet e papërpunuara përbëjnë bazën e eksporteve "të prodhuara në Kosovë!"²⁷ Kjo tregon se Kosova ka dështuar në industrinë e prodhimit, përkundër faktit se ka pasur një ngritje të eksportit të metaleve të minierave dhe të metalit të procesuar. Rryma vazhdon të ndërpritet në baza ditore, qoftë nga problemet teknike apo nga mungesa e të hyrave në central. Ndërprerja e rrymës për orë të tëra vazhdon të jetë një nga pengesat kryesore në zhvillim dhe në largimin e investitorëve.

Mosmarrëveshjet lidhur me pronësinë dhe pasiguria nga mungesa e ligjeve e kanë vonuar privatizimin deri në fillim të vitit 2005. Deri në qershor të vitit 2007, agjencia për privatizim ka tenderuar 510 subjekte, ka nënshkruar 287 kontrata dhe ka gjeneruar 321 milionë € përfitim në privatizim²⁸. Privatizimi i industrive kryesore, si dhe ndërmarrja e çelikut në Vushtrri, Ferronikeli në Glllogovc, i disa minierave mihëse dhe agroprocesorëve, ka ndikuar të ketë një rritje të vogël të eksportit. Sektorët që kanë përparuar më shumë janë sektori i minierave, industria e prodhimeve bujqësore, industria e drurit dhe metaleve. Prodhimi e ka rritur përgjysmë eksportin. Eksporti i perimeve, për shembull, është dyfishuar nga 1 milion në 2 milionë €²⁹.

Natyrisht, ka pasur edhe një ngritje të vogël në aktivitetet e sektorit privat në vitet e fundit. FMN ka vlerësuar se ka një ngritje të investimeve në sektorin privat në vitin 2006 nga 397 në 526 milionë €³⁰.

24 UNMIK, Shtylla e Bashkimit Evropian, Ndikimi i UNMIK-ut në ekonominë e Kosovës, 2006.

25 MTI 'Një vështrim statistikor i sektorit të ndërmarrjeve- analizë', 2007, fq. 4

26 ESPIG, "Drejt planit zhvillimor për Kosovën", gusht 2004, fq.8

27 Nga konsolidimi drejt qëndrueshmërisë, mirëmbajtja dhe përmirësimi i arritjeve, Gjendja ekonomike në Kosovë 2007, Shtylla e BE-së në UNMIK, shtator 2007

28 Nga konsolidimi drejt qëndrueshmërisë, mirëmbajtja dhe përmirësimi i arritjeve, Gjendja ekonomike në Kosovë 2007, Shtylla e BE-së në UNMIK, shtator 2007

29 Raport nga Këshilli për Arsim Këshillit Evropian për objektivat konkrete për të ardhmen në arsim dhe sisteme të trajnimit, shkurt 2001

30 Nga konsolidimi drejt qëndrueshmërisë, mirëmbajtja dhe përmirësimi i arritjeve, Gjendja ekonomike në Kosovë 2007, Shtylla e BE-së në UNMIK, shtator 2007

Gjithashtu, numri i bizneseve të regjistruara është ngritur për më shumë se 5,000³¹. Kreditë ndaj industrive kanë 3% ngritje³², kurse në bujqësi nga 12.5 milionë në 16.5 milionë €³³.

Ka një lëvizje pozitive në kredi dhe investime, si dhe shmangie nga ekonomia e tregut dhe shërbimeve. Janë në rritje industritë prodhuese që gjenerojnë vende të reja pune dhe punësim më të lartë. Procesi i privatizimit, sidoqoftë, ka tërhequr pak investitorë të huaj dhe ka krijuar një numër të kufizuar të vendeve të "reja" të punës. Vendet e punës ende janë shumë të kufizuara, duke marrë parasysh mbylljen e 600 ndërmarrjeve shoqërore që ende pritet të shuhen. Për shkak të paqartësive ligjore të Kosovës, që janë rezultat i statusit të pazgjidhur, privatizimi nuk mund të shfrytëzohet për investimet në infrastrukturë publike dhe zhvillimin e kapitalit njerëzor, të cilat janë më se të domosdoshme. Pra, miliona të tërë janë të "parkuar" në xhirollogaritë e bankave të huaja.

Sot ekonomia e Kosovës është më se e ndjeshme ndaj goditjeve të ekonomisë nga jashtë. Ngritja e shpejtë e ekonomisë nuk zgjati shumë. Përkundër një ngritjeje së voni në mbledhjen e tatimeve, dy të tretat e të hyrave të qeverisë ende mblidhen në formë të doganës, akcizës dhe TVSH-së në import. Dy burimet kryesore të fondeve që kanë ndihmuar deri tani ekonominë e brishtë të Kosovës, donacionet dhe të hyrat e donatorëve, duket se kanë pësuar rënie në vitet në vijim. Ngritja dyfishore në vitet e para të pasluftës është përcjellë me një periudhë të rënies në vitin 2002 dhe 2003 dhe pothuajse në një stagnim në vitin 2005³⁴. Në vitin 2006, rritja e BVP-së u ngrit përsëri në 3 % – pothuajse pa asnjë ndikim në përmirësimin e standardit të jetës dhe ekonomisë³⁵.

Zymtësia e pasluftës

Tani, tetë vjet pas luftës, për të ruajtur ekuilibrin në vend kërkohet një vëmendje e veçantë; shpërthimi i pasluftës nuk pati ndonjë ndikim në ndryshimet strukturore, nuk ka ngritur produktivitetin e fuqisë punëtore dhe nuk ka ndryshuar natyrën e ekonomisë tanimë të ngecur të Kosovës. Ndryshimet ekonomike janë të brishta dhe ka shumë sfida të mëdha zhvillimore për t'u adresuar. Këtu përfshihen shkalla e lartë e papunësisë strukturale të rrënjësuar, harxhim i kapitalit njerëzor dhe gjendja e mjerueshme e shërbimeve publike dhe infrastrukturës³⁶.

Varfëria dominon. Sipas raportit të Vlerësimit të Varfërisë në Kosovë të Bankës Botërore, të publikuar në tetor 2007, 45 për qind e popullatës së Kosovës jeton nën pragun e varfërisë me më pak se 1.42 € në ditë. 15 për qind e popullatës së Kosovës jeton në varfëri të skajshme që nuk mund t'i mbulojnë as nevojat e të ushqyerit³⁷. Grupet më të rrezikuara, sipas Bankës Botërore, janë familjet

31 Nga konsolidimi drejt qëndrueshmërisë, mirëmbajtja dhe përmirësimi i arritjeve, Gjendja ekonomike në Kosovë 2007, Shtylla e BE-së në UNMIK, shtator 2007

32 AQBK – Statistikat mujore, janar 2007.

33 Burimi: Buletini i AQBK-së, Struktura e sektorit financiar, numër 4, Prishtinë 2006, fq. 22.

34 Banka Botërore, Rishikimi institucional dhe i shpenzimeve publike në Kosovë, Vëllimi I, 2006, fq.4

35 Nga konsolidimi drejt qëndrueshmërisë, mirëmbajtja dhe përmirësimi i arritjeve, Gjendja ekonomike në Kosovë 2007, Shtylla e BE-së në UNMIK, shtator 2007, fq.4

36 Kosova: Shtytja e politikave drejt rritjes dhe zhvillimit, FMN, 2005, fq.2

37 Banka Botërore 'Vlerësimi i varfërisë në Kosovë: Përshpejtimi i rritjes ekonomike për të zvogëluar varfërinë e përhapur, Vëllimi I, tetor 2007

fshatare, familjet me më shumë se 7 anëtarë, familjet me kryefamiljarë femra, të papunët dhe personat më kualifikim të ulët të punës.

Varfëria kryesisht e kaplon Kosovën rurale. Në aspektin strukturor, ka pak ndryshime në 5 dekadat e fundit të socializmit dhe pothuajse një dekadë të qeverisjes nga ndërkombëtarët. Përqindja e popullatës në vendet rurale mbetet e njëjtë, rreth 60% e popullatës, pa ndryshuar që nga viti 1963. Që nga viti 1979 Banka Botërore e ka përshkruar varfërinë në Jugosllavi si varfëri kryesisht "rurale".³⁸ Kjo vlen edhe sot. Derisa varfëria urbane ka rënë për 5%, varfëria rurale është ngritur.

Bujqësia mbetet një nga sferat me shkallën më të lartë të punësimit në Kosovë, që punëson rreth 145,000 persona krahasuar me afro 85,000 në sektorin privat jashtë fermave³⁹. Ky sektor karakterizohet me modele jostabile të punësimit dhe prodhim të ulët. Rroga mesatare në sektorin e bujqësisë është 88 Euro në krahasim me rrogën mesatare nacionale të 236 Euro⁴⁰. Në vitin 2007, sipas Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, agrobiznesi dhe bujqësia primare së bashku përbëjnë 40 për qind të BPV-së⁴¹.

Në vitin 2004 bujqësia përbënte 16 për qind të vlerës së përgjithshme të eksportit⁴². Bujqësia kryesisht zhvillohet në shkallë të ulët në ferma më të vogla se dy hektarë. 85 për qind e prodhimit të ushqimit në Kosovë nuk arrin në treg. Ka vetëm 1,800 ferma komerciale⁴³. Duke i marrë parasysh burimet natyrore të Kosovës, bujqësia primare dhe agrobiznesi nuk mund të bartin barrën e punësimit të tërë fuqisë punëtore rurale⁴⁴. Po ashtu, nuk mund të ketë as rritje të produktivitetit në sektorin e bujqësisë pa një reduktim substancial në fuqinë punëtore.

Ky lloj i ekonomisë rurale të Kosovës, sidoqoftë, nuk kërkon një specifikim të shkathtësive dhe kualifikimeve në arsim dhe aftësim të popullatës rurale të Kosovës. Intervistat e 450 familjeve për Strategjinë e Arsimit Rural në Kosovë 2004 tregojnë se tri të tretat e popullatës së rritur (mbi 18 vjet) kishin më pak se arsimin e mesëm e prej tyre gjysma nuk ishin fare të arsimuar apo kishin më pak se 8 vjet të shkollës fillore. Vetëm 4 për qind të familjeve kishin vijuar arsimin e të rriturve apo ndonjë program trajnimi. Problemi nuk lidhet me kërkesat, por me mundësitë që ofrohen. Kërkesat për arsimin joformal të të rriturve në vendet rurale janë shumë më të mëdha sesa mundësitë që ofrohen. Arsimi joformal dhe mësimi gjatë gjithë jetës nuk janë të koordinuar dhe organizohen kryesisht ad-hoc, duke përfshirë kështu një numër shumë të vogël të njerëzve⁴⁵.

38 ESI 'Ndërprerja e linjës së shpëtimit, Migrimi, familjet dhe e ardhmja e Kosovës', 18 shtator 2006, fq.1

39 MASHT, MPBZHR, FAO 'Një strategji për arsimimin e popullsisë në viset rurale në Kosovë', 2004-2009, fq.24

40 MASHT, MPBZHR, FAO 'Një strategji për arsimimin e popullsisë në viset rurale në Kosovë', 2004-2009, fq.24

41 Korniza afatmesme e shpenzimeve 2008-2010, vëllimi I, Korniza makro fiskale, 17 korrik 2007

42 Plan i përgjithshëm për bujqësi 2006, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

43 MASHT, MPBZHR, FAO 'Një strategji për arsimimin e popullsisë në viset rurale në Kosovë', 2004-2009, fq.24

44 MASHT, MPBZHR, FAO 'Një strategji për arsimimin e popullsisë në viset rurale në Kosovë', 2004-2009, fq. 25

45 MASHT, MPBZHR, FAO 'Një strategji për arsimimin e popullsisë në viset rurale në Kosovë', 2004-2009, fq.6

Në kërkim të vendeve të punës?

Sfida e vetme më e madhe për Kosovën është krijimi i vendeve të reja dhe të mira të punës. Punësimi është në gjendje dramatike. Me vetëm 54 % të punësuar, Kosova ka shkallën më të ulët të punësimit në Evropë. 74 për qind e meshkujve dhe vetëm 33 për qind e femrave janë ekonomikisht aktivë. Në shifra më të sakta, 326,026 persona, përfshirë 152,198 femra (47 për qind) ishin zyrtarisht të regjistruar si të papunë në dhjetor të vitit 2006. Kjo shënon një shkallë të papunësisë që arrin 42 %⁴⁶. Afro 90 % të të papunëve janë të regjistruar si të papunë afatgjatë që nuk kanë gjasa të gjejnë punë në të ardhmen e afërt. Papunësia e të rinjve dhe femrave arrin deri në 60 %. Afro 30,000 të tjerë i shtohen numrit të punëkërkuësve çdo vit.

Kosova ka nevojë të madhe për vende pune dhe të ardhura, por ka pak gjasa që të ketë një rritje që do të zbuste varfërinë dhe të zvogëlonte numrin e të papunëve. Sektori i bujqësisë nuk mund të shtojë prodhimin apo të jetë efikas nëse nuk fillon të mbajë punëtorët. Vendet e punës të ofruesve të shërbimeve publike, sipas të gjitha gjasave, do të zvogëlohen në procesin e ristrukturimit. Sektori publik, që ka në punë tani rreth 76,000 persona, është zotuar që të zvogëlojë punësimin në sektorin publik në 3,000 të punësuar në tre vjetët e ardhshëm⁴⁷. Kjo sjell përgjegjësinë e krijimit të vendeve të punës në sektorin privat. Sektori privat i Kosovës është kryesisht tregti, me kapital të ulët, si dhe tejet i vogël për të gjeneruar mjaft vende të reja pune.

Me ristrukturimet që planifikohen tani, FMN ka pohuar se “do të ishte joreale që politikëbërësit të synojnë të zvogëlojnë papunësinë në mënyrë radikale”⁴⁸. Plani i Strategjisë Zhvillimore të Kosovës (PSZHK), i punuar me konsultime intensive për 18 muaj me radhë, përmban dy skenarë të zhvillimit për periudhën 2007-2013. Skenari optimist thotë se do të ketë një rritje mesatare vjetore deri më 6 për qind, rritje të përkrahjes së donatorëve prej 1.4 milionë Euro dhe investime të mëdha në sektorin e energjisë dhe transportit. Megjithatë, edhe sipas këtij skenari më optimist (dhe shumë joreal-ist) të bazuar në eksportin e energjisë, ekonomia e Kosovës do të mund të krijonte diku 100,000 vende pune.⁴⁹ Kjo, me fjalë të tjera, nënkupton se një kosovar mesatar do të jetë po aq i varfër dhe numri i të papunëve do të jetë i njëjtë sa është sot edhe në vitin 2013⁵⁰. Më një rritje 3.1 për qind, siç parashihet nga ministri e Ekonomisë dhe Financave, një kosovar mesatar do të jetë edhe më i varfër në 2013 sesa është sot⁵¹.

Rrjeti i sigurisë

Kosova ka qenë gjithmonë rrjet i eksportit të fuqisë punëtore. Edhe në ditët e zenitit të socializmit jugosllav, në kohën kur Kosova ka qenë një nga përfituesit më të mëdhenj të Fondit Zhvillimor të

46 Të dhënat në ‘papunësinë’ tregojnë numrin më të vogël real të të papunëve, përderisa tregojnë numër më të madh të atyre që kërkojnë punë. Legjislacioni i tanishëm kërkon që secili që aplikon për ndihmë sociale duhet ta regjistrojë çdo anëtar të familjes, i cili është i moshës punuese, si të papunë. Shumë femra dhe të rinj, të cilët nuk kërkojnë punë, janë të regjistruar si të papunë. Në ndërkohë, pasi që nuk ka benefite për të papunët, ka shumë që janë të dekurajuar dhe të cilët nuk regjistrohen fare si të papunë.

47 Korniza afatmesme e shpenzimeve 2008-2010, Vëllimi 1, 30 maj 2007 Draft, fq.17

48 Kosova: Shtytja e politikave drejt rritjes dhe zhvillimit, FMN, 2005, p.2

49 Plani dhe strategjia e Kosovës për zhvillim, dhjetor 2006 Draft

50 Plani dhe strategjia e Kosovës për zhvillim, dhjetor 2006 Draft

51 Korniza afatmesme e shpenzimeve 2008-2010, Vëllimi I, Korniza makro fiskale, 17 korrik 2007

Jugosllavisë, krijimi i vendeve të reja të punës nuk mund të mbante hapin me rritjen e popullsisë. Kurrë nuk ka ndodhur që më shumë se 22 për qind e popullatës së moshës së përshtatshme për punë të ketë një vend pune jashtë bujqësisë për mbijetesë⁵². Gjatë viteve 1990, pas përjashtimeve masive të shqiptarëve nga vendet e punës dhe rënies së ekonomisë, migrimi u bë një rrjet sigurie, në veçanti për familjet rurale. Vlerësohet se numri më i madh i kosovarëve që kanë jetuar jashtë dhe kanë dërguar para në vend të ketë arritur në momentin më kulminant në gjysmë milioni.

Rëndësia e të dërguarit të parave në vend është parë edhe menjëherë pas luftës. Kursimet dhe paratë e dërguara në Kosovë nga diaspora kosovare kanë ndihmuar në ndërtimtarë. Emigrantët kosovarë kanë qenë më se zemërgjerë. Duke krahasuar emigrantët nga Shqipëria, Maqedonia dhe Kosova në Belgjikë, Itali, Gjermani dhe në Mbretërinë e Bashkuar, IOM tregon se emigrantët kosovarë kanë pasur tendenca më të mëdha (63%) që të dërgojnë para në krahasim me 47% të shqiptarëve nga Shqipëria dhe me 32% të maqedonasve⁵³.

Pas luftës, rënia drastike në migrim shënon përfundimin e epokës së migrimit. Shkalla e lartë e kthimit të shqiptarëve të Kosovës ka pasur një ndikim qenësor në familjet rurale. Deri në vitin 2004, niveli i parave të marra nga jashtë ka rënë për 123 milionë Euro⁵⁴. Meqë të ardhurat mujore ranë nga 58.83 Euro në 41.65 Euro, një rënie prej 25 për qind në një vit, të ardhurat e një familjeje në vendet rurale kanë rënë për një të tretën mes viteve 2003 dhe 2004.

Fati i familjes Maksuti në Skënderaj është rast tipik i një familjeje rurale që varet nga të ardhurat nga jashtë. Në fshatin Lubovec mund të arrish vetëm përmes rrugëve të pluhurosura dhe përplot gropa. Gjatë luftës, fshati ishte djegur tërësisht. Nga 200 shtëpitë e paraluftës, sot kanë mbetur vetëm 80. Shumica e familjeve jetojnë duke kombinuar paratë nga jashtë, ndihmat sociale dhe të ardhurat nga bujqësia. Në vitin 1995, burri i Makfire Maksutit kishte migruar në Gjermani dhe ajo iu bashkëngjiti një vit më vonë. Pas kthimit nga Gjermania, në vend të shtëpisë gjetën vetëm gërmadhat e shtëpisë së djegur. Rroga e 150 Eurove e burrit të saj nuk mjaftonte që të rindëronte shtëpinë dhe të mbante familjen. Ai u nis përsëri të punojë jashtë vendit, në Suedi, e të dërgojë një shumë prej 250 Eurove në shtëpi. Gruaja e tij 43-vjeçare jeton vetëm me djalin 13 vjeçar dhe dy vajza 10 e 15-vjeçare. Pa të ardhurat e tij, familja nuk mund të mbijetonte me ndihma sociale⁵⁵.

Sot, sipas Bankës Botërore, çdo i pesti kosovar (1 në 5) ka së paku një anëtar të familjes emigrant. Dallimi gjithmonë në rritje mes familjeve të "pasura" dhe të "varfëra" varet shumë nga fakti se a kanë të ardhura nga jashtë. E vetmja zgjidhje për shumë të rinj në fshatra është të martohen me një "vajzë me letra". Duke marrë parasysh situatën jostabile të tregut të punës në Kosovën rurale, migrimi i fuqisë punëtore mbetet mënyra më efektive për zvogëlimin e varfërisë dhe stabilizimin e ekonomisë. Paratë nga jashtë dhe migrimi i fuqisë punëtore mundësojnë mbajtjen e një rrjeti të sigurisë për të mbajtur familjet rurale që të mos i kaplojë më shumë varfëria. Realiteti i vendeve si fshati Lubovec në Skënderaj do të jenë temë e kapitullit të ardhshëm.

52 Ndërprerja e linjës së shpëtimit, Migrimi, familjet dhe e ardhmja e Kosovës, ESI, shtator 2005, fq.18

53 Zana Vath dhe Richard Black, Migrimi dhe zvogëlimi i varfërisë në Kosovë, dokument pune, 2007, fq.18.

54 Ndërprerja e linjës së shpëtimit, Migrimi, familjet dhe e ardhmja e Kosovës, ESI, shtator 2006, fq.8

55 Intervistë me Makfire Maksuti, mësuese, Lubovec-Skënderaj, gusht 2007.





KAPITULLI II : REALITETET RURALE

Podujeva, Rahoveci dhe Skenderaj janë tri komuna tipike rurale. Me një popullatë që arrin 277,490, ato përbëjnë përafërsisht 15 për qind të popullatës së përgjithshme të Kosovës⁵⁶. Sipas madhësisë, komuna e Skenderajt në qendër të Kosovës ka 72,490 banorë e më pas Podujeva në verilindje të Kosovës me 131,300 banorë. Të tri komunat janë kryesisht rurale dhe fermat familjare janë bazë e ekonomisë lokale.

Natyra e femrave që mbijetojnë dhe varshmëria e lartë në migrimin e fuqisë punëtore ka ndihmuar që të mbijetojnë strukturat familjare tradicionale. Mesatarja e anëtarëve për familje është prej 7.6⁵⁷ në Skenderaj deri në 7.9⁵⁸ në Podujevë, që është mbi mesatarën kosovare prej 6.2 anëtarëve për familje. Qendra më e madhe urbane, qyteti i Podujevës ka më pak se 45.000 banorë⁵⁹.

Tabela 2: Popullata urbane/rurale Podujevë, Skenderaj, Rahovec

Komuna	#Fshatrat	# popullsia urbane	# popullsia rurale
Podujeva	78	45,000	përafërsisht 70%
Rahoveci	35	23, 200 ⁶⁰	përafërsisht 70%
Skenderaj	52	7,200	përafërsisht 70%
Gjithsej	165	75400	

Podujeva

E vendosur në verilindje të Kosovës, Podujeva ka një distancë jo të madhe me Prishtinën, kryeqytetin e Kosovës. Rreth 78 fshatra dhe qyteti i Podujevës janë të shpërndara në 633 km². Në madhësi, e shtrirë në fushën e Llapit e rrethuar me male në lindje dhe perëndim, Podujeva është komuna e tretë për nga madhësia në Kosovë. Rrjeti i rrugëve që kalojnë nëpër komunë është relativisht i mirë për standardet e Kosovës, të asfaltuara me vrima e te çara. Udhëtimi deri në Prishtinë i merr 40 minuta deri në një orë. Ka autobusë dhe minibusë të shpeshtë që e lidhin Podujevën dhe Prishtinën. Hekurudha tani nuk funksionon.

56 Popullsia: Rahovec - 73,700 (Përshkrim i komunës nga ana e OSBE-së, fq.2. 2002); Skenderaj - 72,490 (KK Strategjia zhvillimore e Komunës së Skenderajt 2005-2010' 2005-2010); Podujevë - 131,300 (Përshkrim i komunës së Podujevës nga ana e OSBE-së, 2004: fq.2); popullsia e Kosovës - supozohet se ka 1.85 milion banorë.

57 KK Skenderaj, UNDP, EDA, 'Strategjia zhvillimore e komunës së Skenderajt 2005-2010', fq.7. Madhësia e familjes mesatare: 7-8

58 USAID/KIPRED "Përshkrim i komunës së Podujevës", fq.3

59 USAID/KIPRED "Përshkrim i komunës së Podujevës", fq.2; vlerësohet 35,000 deri 45,000 banorë.

60 OSCE Municipal Profile, faqe 2. Të dhëna nga Departamenti i Urbanizmit, nëntor 2002

Një nga burimet më të mëdha të ujit, liqeni artificial Batllava, është po ashtu i vendosur në Podujevë. Gjatë verës aty shkojnë vizitorë të shumtë nga tërë Kosova. Pjesa më ironike është se në tërë komunën, si në qytetet dhe fshatrat e tjera të Kosovës, ka ndërprerje të rregullta të ujit gjatë ditës dhe natës. Lufta e pati kapluar edhe Podujevën. Rreth 37 % të shtëpive ishin ose të dëmtuara apo të shkatërruara plotësisht. Vlerësohet të ketë dëme te luftës që arrijnë shumën 350 milionë Euro. Afro 200 ndërmarrje private të themeluara në vitet '90 janë shkatërruar gjatë luftës.

Qyteti i Podujevës duket i varfër, me dyqane të vogla të paregjistruara të renditura në rrugët ngjyrë hiri e të pluhurosura, të mbingarkuara me vetura të vjetra të parkuara pa rregull. Ndërmarrësit presin muaj të tërë për të parë si shkon biznesi para se t'i regjistrojnë. Dhe padyshim, ka shumë dyqane që mbyllen për shkak të profitit të ulët. Shumica e bizneseve janë familjare. Po ashtu, merren në punë anëtarët e familjes së gjerë. "Nuk mund të marrësh në punë persona të panjohur kur ke shumë anëtarë të familjes që kërkojnë punë," thotë Bashkim Osmani, pronar i kompanisë Laberioni. Kompania Laberioni prodhon lëngje dhe është një nga ndërmarrjet më të mëdha private që ofron punë për 53 persona⁶¹.

Sa u përket të punësuarve të rregullt, prodhuesi më i madh në Podujevë sot është "Zahir Pajaziti", një kompani ish-socialiste me emrin FAN, që prodhon rrjeta të çelikut për konstruksione ndërtime. "Zahir Pajaziti" është privatizuar në vitin 2006 dhe i ka në punë 200 persona sot⁶². Prodhuesi i dytë më i madh është një ish-fabrikë e blloqeve që tani quhet Euro-Block, me 100 punëtorë⁶³. Nuk ka femra në katet e fabrikave – prej 300 punëtorëve të "Zahir Pajazitit" dhe Euro-Block-ut, vetëm 8 janë femra. Kjo reflekton një trend të përgjithshëm që ekziston në Kosovë. Në kohën e socializmit, përqindja e femrave të punësuar jashtë shtëpisë ishte 23%⁶⁴. Shumica e femrave që punonin ishin në fabrikat e tekstitit dhe veshmbathjeve, si kompania Kosovotex në Prishtinë apo "Emin Duraku" në Gjakovë. Me një kolaps të sektorit të tekstitit dhe veshmbathjeve, punësimi i femrave në industri ka rënë tërësisht. Sipas një ankete të bërë nga Fondi Zhvillimor i Femrave i OKB-së, punësimi i femrave ka rënë 3.1 për qind⁶⁵. Sektori më i madh i punësimit të femrave sot nuk gjendet në zonën industriale në Podujevë, por në fshatin Peran, 3 km në lindje të qytezës së Podujevës.

Agroprodukt Commerce, pronë e familjes Shabani, daton qysh nga viti 1991. Kompania është e specializuar në mbledhjen, seleksionimin dhe paketimin e kërpudhave për eksport. Përveç stafit permanent të 8 personave, përfshirë edhe dy femra, Agroprodukt Commerce ka punësuar çdo vjeshtë edhe nga 400 punëtorë sezonal për 3-4 muaj në sezonin e kërpudhave. Avni Shabani i rrëfen IKS-it për vështirësitë që ka pasur për të gjetur punëtoze sezonale femra pas luftës. Në fillim

61 Intervistë me Bashkim Osmanin, pronar i prodhuesit të pijeve Laberion, Podujevë, 2007

62 Intervistë me Selim Dëshishkun, bashkëpronar, kompania "Zahir Pajaziti", Podujevë, 2007

63 Intervistë me Shpejtim Beselicën, Head of finance, kompania Euroblok, Podujevë, 2007

64 Gratë në punë, Situata dhe mundësitë ekonomike për gratë në Kosovë, citat nga Statistikat vjetore 1989, fq.67, fusnota 36

65 Gratë në punë, Situata dhe mundësitë ekonomike për gratë në Kosovë, 2000, fq.50

ka pasur rezistencë, por pasi që është punësuar grupi i parë i femrave pa probleme, tani 80% të punëtorëve sezonal përfaqësohen nga femrat. Disa nga femrat që fitojnë një rrogë shtesë përmes punësimit sezonal me Agroprodukt janë nga fshati Dobërdol⁶⁶.

Fshati Dobërdol shtrihet në fushën e Llapit, 7 km larg nga qendra e Podujevës dhe 5 km nga kufiri me Serbinë. Rruga kryesore e fshatit është e asfaltuar, derisa rrugët anësore janë rrugica të paasfaltuara me baltë. Dobërdoli nuk ka qasje në burimet publike të ujit dhe gjysma e fshatit është e lidhur me sistemin lokal të ujësjellësit. Posaçërisht në dimër, ndërprerjet e rrymës, si në pjesët tjera të Kosovës, gjatë ditës dhe natës zgjat me orë të tëra⁶⁷.

Dobërdoli është rast tipik i 78 fshatrave të Podujevës. Para luftës, aktivitetet kryesore ekonomike ishin bujqësia, kryesisht gruri, misri dhe patatet. Që nga përfundimi i luftës, nga 170 familje në fshat, vetëm disa familje ende kultivojnë tokën për nevojat e veta. Komuna e Podujevës ka përafërsisht 34.214 hektarë të tokës bujqësore, por, pa zbatim të ligjeve adekuate për tokat, shumë fusha janë shndërruar në toka ndërtimore dhe një pjesë e madhe e tokave bujqësore mbesin të papunë, në mungesë të interesit dhe profitit.

Të vetmit “të punësuar” në fshat janë ata të shkollës fillore të fshatit, të pompës së benzinës dhe 14 shitore të vogla. Shumica e fshatarëve të Dobërdolit mundohen të gjejnë punë në Podujevë apo Prishtinë. Disa fshatarë punojnë në administratën komunale në Podujevë, në policinë e Kosovës, KEK, në Spitalin Universitar të Prishtinës dhe, gjatë sezonit, në fabrikën e kërpudhave Agroproduct Commerce.

Mungesa e dinamikës së biznesit në qytetin e Podujevës dhe fshatrat përreth si Dobërdoli arsyeton shkallën e lartë të papunësisë; 48% e meshkujve dhe 73% e femrave janë të papunë. Me shkallë të analfabetizmit 5% tek meshkujt dhe 16% tek femrat, komuna e Podujevës renditet e fundit si një nga komunat me shkollim më të ulët në Kosovë⁶⁸.

Rahoveci

Komuna e Rahovecit është e vendosur në fushën e plleshme të Dukagjinit në Kosovën Perëndimore. Me klimën e butë që ka, Kosova Perëndimore ka qenë e njohur për prodhime bujqësore, posaçërisht hortikulturë dhe verë. Komuna e Rahovecit njihet për peizazhet e bukura që shtrihen në afro 276 km. Qyteti i Rahovecit është po ashtu i famshëm për dialektin e veçantë të Rahovecit, një përzierje e gjuhës shqipe, bullgare dhe serbe. Rruga prej Prishtinës në Rahovec zgjat afro 1 orë e gjysmë, që duke marrë parasysh distancën vetëm prej 64 km, tregon qartë për kushtet e rrugëve. Derisa i afrohem komunës shihen pamjet e kodrinave të gjelbra dhe vreshtave në të dy anët e

66 Intervistë me Avni Shabanin, drejtor i Agroprodukt Commerce, Podujevë, 2007

67 Intervistë me Jusuf Gashin, kryetar i fshatit Dobërdol, gusht 2007

68 UNDP, Raporti për zhvillimin njerëzor, 2004, fq.110

rrugës. Në kohën e të korrave fermerët renditen në të dy anët e rrugës dhe shesin pemët dhe perimet në stendat e improvizuara.

Bujqësia është aktiviteti kryesor ekonomik në Rahovec. 14 000 hektarë të tokës bujqësore, përafërsisht 50% e tokës, janë ferma, e prej tyre 6,900 hektarë shfytëzohen për grurë, 3.400 hektarë për rrush dhe 3 700 hektarë për pemë dhe perime. Rreth 2/3 e 73,700 banorëve të 35 fshatrave të Rahovecit nxjerrin të ardhurat nga aktivitetet bujqësore.

I famshëm për rrushin dhe verën, Rahoveci ka një histori të gjatë të kultivimit dhe përpunimit të rrushit. Të dhënat arkeologjike dëshmojnë se rrushi është kultivuar këtu që nga shekulli I. Përpunimi i rrushit industrial ka filluar në vitin 1953 me themelimin e fabrikës shtetërore për prodhimin e verës "Rahovec". Gjatë viteve të 80-ta, shkalla e punësimit arriti kulminacionin me 1,200 të punësuar, kur vera eksportohej kryesisht në Gjermani dhe shtetet tjera evropiane⁶⁹.

Kapaciteti i prodhimit të verës është 36,000 tonë, por aktualisht bodrumet e verës punojnë nën kapacitetet e tyre ekzistuese. I privatizuar në vitin 2006 me 294 persona të punësuar, bodrumi i Rahovecit (i riemëruar "Stone Castle" nga pronari i ri), është një nga punëdhënësit më të mëdhenj dhe prodhon afro 2 milionë litra verë momentalisht.

Përveç bodrumeve të verës, një nga prodhuesit dhe punëdhënësit më të mëdhenj është mulliri M&Silosi në Xërxë, po ashtu i privatizuar së voni. Mulliri ka rifilluar prodhimin në fillim të vitit 2007 dhe është duke prodhuar momentalisht afro 300 tonë miell gjatë 24 orëve, që është gjysma e kapacitetit të tij prej 600 tonëve. Fabrika është shumë moderne, ndërtesa e renovuar dhe hollet janë të pajisura me teknologjinë e fundit që është sjellë nga Italia⁷⁰. Korenica është një kompani tjetër e pajisur në Xërxë. Kompania Korenica, e vendosur në hollet e privatizuara të ish-ndërmarrjes shoqërore "18 Nentori" në Xërxë prodhon dyer dhe dritare të drurit si dhe parkete. Nga 56 të punësuar, 3 janë femra. Një nga kompanitë e para shoqërore që janë privatizuar në Kosovë është në fshatin Bërnjakë, në mes të Rahovecit dhe Xërxës. Ndërmarrja Osa Termosistemi, e privatizuar në 2003, është e specializuar për prodhimin e sistemeve të ndryshme të ftohjes, frigoriferë, ngrohës, kolektorë solarë dhe radiatorë. Punësimi në të është rritur prej 15 në 56 sot, duke përfshirë edhe dy femra⁷¹. Një kompani tjetër prodhimi, Spektri-18 Nentori, po ashtu e privatizuar në vitin 2003, është në kërkim të klientëve dhe shitjes me lirime të prodhimeve të saj. E specializuar në prodhimin e paketimeve të ndryshme të plastikës, duke përfshirë edhe qese, shishe dhe konteinerë plastike, numri i punëtorëve është zvogëluar nga 182 në 50 sa janë sot. Pronari i ri i ka thënë IKS-it se privatizimi ia ka harxhuar të gjitha kursimet, duke i lënë vetëm një shumë të vogël për të investuar në teknologjinë e re dhe në kapacitetet prodhuese. Krahasuar me 6,000 tonë të produkteve të plastikës të prodhuara para luftës, kapaciteti aktual i kompanisë është 30 tonë në muaj.

69 Intervistë me Agron Aličkajn, sekretar gjeneral në bodrumin e verës Stone Castle, ish NBI Rahoveci, Rahovec, 2007

70 Intervistë me Hajdar Vuçiternën, drejtor i fabrikës së miellit M&Silosi, Xërxë, Rahovec, 2007

71 Intervistë me Sadbere Latifi-Osa, bashkëpronare; 'Osa tremosistem', korrik 2007.

Privatizimi në Rahovec ka arritur t'i ruajë vendet e punës, megjithatë nuk ka ndihmuar edhe në gjenimin e punësimit më se të nevojshëm për femrat, në veçanti në fshatrat siç është Zoqishta. Zoqishta, që gjindet në një terren kodrinor me një tokë pjellore dhe vreshta, është një fshat i zhvilluar, 7 km nga qyteti i Rahovecit. Sa i përket infrastrukturës kryesore, Zoqishta ka një shkollë fillore (1-9 klasëshe) dhe një ambulante të vogël shëndetësore, që nuk punon tani. Prezenca e manastirit ortodoks serb pranë xhamisë së fshatit ka ndihmuar për të tërhequr më shumë fonde nga donatorët. Në vitin 2003/04, Oxfam me pjesëmarrjen e komunitetit ka ndërtuar një sistem të ri të ujësjellësit, ndërsa në vitin 2004 donatorët kanë ndërtuar një sistem të ri të kanalizimit. Sidoqoftë, shumica e fshatarëve vazhdojnë të shfrytëzojnë bunaret familjare për shkak të shpenzimeve të larta për rrymën që duhet të vërë në përdorim pompat e ujit. Po ashtu, pompat shpesh nuk punojnë për shkak të ndërprerjes së rrymës. Përveç bujqësisë, janë edhe 2 dyqane të vogla, 1 automekanik dhe një zdrukhtar. Para luftës, Zoqishta kishte 1,200 banorë, nga të cilët 300 ishin të etnicitetit serb dhe të tjerët shqiptarë. Sot Zoqishta ka 154 familje⁷² me afro 661 banorë⁷³, që jetojnë në fshat dhe 220 që jetojnë në pjesë të tjera të Kosovës apo që janë jashtë si punëtorë emigrantë.

Zoqishta është fshat i pasur, sipas standardeve të Kosovës. Në vitin 2006 Fehmi Gashi, kultivuesi më i sukseshëm i rrushit në Rahovec, ka marrë një shpërblim nga Ministria e Bujqësisë⁷⁴. Fehmi Gashi dhe gruaja e tij kanë kultivuar 15,000 kg rrush, i rritur në 1.60 hektarë tokë. Fehmiu ka shitur 1 kg rrush me çmim prej 0.50 Euro dhe ka fituar 7,500 Euro, duke i lënë atij një profit neto që është ekuivalent me një rrogë mujore prej 500 Eurosh. Shumica e familjeve në Zoqishtë jetojnë nga bujqësia dhe e kanë rrushin një nga prodhimet kryesore bujqësore fitimprurëse. Përveç rrushit, disa fshatarë kanë filluar po ashtu të kultivojnë dredhëzat. Vetëm 8 familje marrin ndihma sociale në krahasim me dy të tretat e familjeve në fshatërat si Açaeva në Skënderaj.

Skënderaj

Komuna e Skënderajt, e vendosur në fushën e Drenicës të Kosovës Qendrore, është shumë pak e pasur me burime natyrore. E shtrirë në 374 km², me terren të ashpër malor, vetëm 211km² janë tokë pjellore, ndërsa pjesa tjetër është tokë jokualitative. Nga 72,490 banorë sa ka githsej, më se 90 për qind apo 65,290 jetojnë në një nga 52 fshatrat e kësaj komune.

Infrastruktura publike pothuajse mungon fare. Më pak se 1,700 familje janë të kyçura në sistemin publik të ujësjellësit dhe distanca prej shkollave më të afërta është së paku 4 km. 42% e familjeve të Skënderajt varen nga ndihmat sociale. Rrugët kryesore të komunës duhet urgjentisht të riparo-

72 94 familje jetojnë në fshat, ndërsa 20 familje shqiptare dhe 40 familje serbe jetojnë jashtë fshatit

73 Pothuajse të gjithë prej tyre janë shqiptarë, përpos 4 murgjve serbë që jetojnë në kishën e fshatit

74 Intervistë me Fehmi Gashin, Zoqishtë, Rahovec, 2007

hen ose të asfaltohen. Vetëm 5.5 km të rrugëve kryesore janë të asfaltuara; 17 km të tjera mbetet të riparohen. Rrugët sekondare jashtë qytetit janë në gjendje edhe më të keqe; disa fshatra janë plotësisht të shkëputura, sidomos gjatë dimrit. Sa i përket infrastrukturës teknologjike (IT), ndarja digjitale në mes Skënderajt dhe pjesës tjetër të Evropës është e gjerë dhe e thellë. Vetëm 600 familje në qytetin e Skënderajt janë të lidhura me linjat telefonike tokësore. Pjesa tjetër e komunës është e mbuluar me shërbime të pasigurta të telefonisë mobile të instaluar në vitin 2001. Ka disa lidhje interneti në fshatrat jashtë qytetit.

Qyteti i Skënderajt është një orë larg nga Prishtina, përmes rrugës nga Mitrovica për në Pejë. Skënderaj është një ndër komunat më të varfra, pothuajse pa ndonjë industri për të cilën mund të flitet dhe me shkallë të lartë të papunësisë dhe varfërisë. Skenderaj po ashtu njihet si djepi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe vendi ku ka eskaluar konflikti i armatosur. Adem Jashari sot është shndërruar në hero kombëtar, ka qenë nga fshati Prekaz i Poshtëm në komunën e Skenderajt.

Qyteti i Skënderajt duket i varfër. Gërmadhat e shtëpive të vjetra dhe mbeturinat e veturave janë shenja të mjaftueshme që na rikujtojnë se lufta ka prekur në masë të madhe këtë rajon. Përveç disa dyqaneve të vogla, salloneve për flokë dhe autoshkollave, nuk ka shumë biznese përgjatë rrugës kryesore. Disa lokale të bizneseve janë të zbrazëta. Sheshi kryesor në qendrën e qytetit ditë e natë është i mbushur me të rinj që dalin të shoqërohen; një shenjë që mundësitë ekonomike për të rinjtë e Skënderajt janë të vogla. Edhe para konfliktit të viteve '99, Skënderaj ishte një nga zonat më të varfëra.

Ka pasur disa investime të mëdha në vitet e '70 – një fabrikë blloqesh, një fabrikë municioni dhe një fabrikë tekstili. Industrializmi i Skënderajt ishte afatshkurtër. Në fund të viteve të '80 dhe fillim të '90-ve, shumica e fabrikave, me përjashtim të asaj të municionit që u shëndërrua në bazë ushtarake në vitin 1998, ose janë mbyllur ose janë transferuar. Pothuajse të gjitha ndërmarrjet shoqërore janë privatizuar, por vështirë se mund të flitet për ndonjë industri sot. E vetmja ndërmarrje prodhuese që ende prodhon është fabrika e blloqeve 'Vellezerit Geci', por gjatë dimrit prodhimi shpesh zvogëlohet përgjysmë për disa muaj. Kur punon, ka 150 punëtorë⁷⁵. Ndonëse një kohë ka qenë një punofruese e madhe për femra, fabrika e plastikës dhe lodrave Kosova Inex është shuar që pas privatizimit në vitin 2005. Në të kaluarën, rreth 40 % e fuqisë punëtorë prej 178 punëtorëve ishin femra. Pronarët e rinj mbetën pa fonde dhe shpresojnë se do të gjejnë investitorë të huaj që do të sjellin paratë e gatshme të nevojshme që të rifillojnë prodhimin⁷⁶. Punofruesi më i madh i femrave sot është ish-qendra tregtare e rihapur si shtëpi e mallrave me emrin Ben-Af, që shërben për shitje dhe ushqim të shpejtë.

75 Intervistë me Nehat Gecin, bashkëpronar, fabrika e bllokave 'Vëllëzerit Geci', Skenderaj, 2007.

76 Intervistë me Ismet Mustafën, bashkëpronar, fabrika e lodrave – Kosova Inex, Skenderaj, korrik 2007.

Me privatizim pothuajse të përfunduar dhe me 841 biznese të regjistruara në komunë, vlerësohet të jenë përafërsisht 11,674 vende pune për 43.494 banorë në moshë pune⁷⁷. Kjo çon në një shkallë të punësimit prej 27%. Mungesa e mundësive për punë dhe kualiteti i dobët i tokës nënkupton se 2,455 familje apo 12,305 persona jetojnë nga ndihma sociale. Ka në fakt më shumë njerëz që marrin ndihmë sociale në komunën e Skënderajt sot në krahasim me ata që marrin rroga nga punësimi i rregullt⁷⁸. Një e treta e pranuesve të ndihmave sociale janë fëmijë të moshës 5-15 vjeçare – mundësitë e të cilëve për të vijuar arsimin e duhur janë minimale.

Ka shumë familje, si ajo e Xhyllferije Veselit, që mundohet të mbijetojë me ndihma sociale. Xhyllferije Veseli është një 35-vjeçare, nënë e pesë fëmijëve të moshës 8, 11, 13, 16 dhe 19- vjeçare. Ajo jeton në fshatin e Aqarevës, një fshat tipik i varfër dhe i vendosur në kodrat e Skënderajt. Nuk ka sistem të kanalizimit apo ujësjellësit. Përveç bujqësisë, tregu lokal i Aqarevës përbëhet prej katër shitoreve familjare ushqimore dhe një internet kafeje. Me disa përjashtime, shumica e familjeve pinë ujë nga bunarët privatë; uji ndalet shpesh. "Shteti" është prezent me vetëm një shkollë fillore (1-9 klasëshe) dhe me një ambulante. Burri i Xhyllferijes ka vdekur gjatë luftës në vitin 1998. Sot ajo jeton në një shtëpi dydhomëshe me dysheme të betonit pa ujësjellës brenda. Në vend të dritareve, ajo shfrytëzon batanie dhe çarçafë për ta ndalur të ftohtit. Stufa e improvizuar e druve mezi ngroh muret e ftohta të betonit. Vajza e saj më e re, Adelina, tani në klasën e dytë të shkollës fillore, është e sëmurë nga sëmundja e mushkërive. Xhyllferija merr 62 Euro nga shteti dhe 38 Euro nga një OJQ, sa për të mbuluar disa shpenzime për shërimin e Adelinës. Kështu, nuk u mbesin para për lapsa, veshmbathje dhe barna. Djali më i madh i saj, 19 vjeçar, u detyrua të braktisë shkollimin pas përfundimit të shkollës fillore. Edhe pse Xhyllferija beson në arsim, ajo nuk ka mundësi t'i mbajë fëmijët në shkollë. "Frikësohem se edhe vajza do të detyrohet të lërë shkollën pasi ta përfundojë filloren ... si mund të paguaj për shkollimin e saj me 62 Euro që i marr nga ndihmat sociale", pyet ajo IKS-in⁷⁹. Për fat të keq, ka shumë familje të ngjashme në Aqarevë. Aqareva është shtëpi e 141 familjeve, ku një e treta e popullatës varen nga ndihmat sociale⁸⁰.

77 KK Skenderajt, UNDP, 'Strategjia për zhvillimin ekonomik të komunës së Skenderajt 2005-2010', fq.11.

78 Intervistë me Halit Hamzën, drejtor i Zyres për Punë Sociale, komuna e Skenderajt, 11 korrik, 2007. Herët në vitin 2007, numri i përfituesve të asistencës sociale është reduktuar për 141 familje si shkak i limiteve buxhetore

79 Intervistë me Xhyllferije Veselin, dhjetor, 2007

80 Të dhënat e IKS-it nga hulumtimi në Aqarevë, nëntor 2006-janar 2007





KAPITULLI III: BOTA E MESHKUJVE

T'shkon f'tyra

"N'vende t'vjetra, adete t'reja sqiten," përsërit Naim Kabashi nga fshati Apterushë në Rahovec, një thënie që dëgjohet shpesh e që shpjegon qartë pikëpamjet tradicionale të pandryshueshme që përcaktojnë pozitën e femrës në shoqëri. Në rrethin e politikave dhe kafeve në Prishtinë, pikëpamjet tradicionale për rolin e femrës shihen si "gjëra që i përkasin të kaluarës". Jetërat e femrave si Shemsije Brahimi, Hanife Ramishi apo Valdete Gashi paraqesin realitetin e tanishëm dhe nuk janë përjashtime.

Shemsije Brahimi, 36 vjeçare, jeton me familjen e gjerë në fshatin e AçaREVËS. Familja është e organizuar sipas parimeve tradicionale patriarkale, ku disa vëllezër jetojnë nën një kulm me prindërit, gratë dhe fëmijët. Familjet patriarkale funksionojnë si një njësi e vetme ekonomike me një buxhet të përbashkët dhe resurse që i ndajnë bashkërisht. I zoti i shtëpisë, zakonisht mashkulli më i vjetër i familjes, i merr të gjitha vendimet. Ai delegon dhe organizon punën dhe mbi të gjitha ai e kontrollon buxhetin e familjes dhe merr vendime se a duhet një femër të vazhdojë shkollimin apo të kërkojë punë jashtë shtëpisë.

Femrat si Shemsije Brahimi, të martuara në këtë familje, janë plotësisht të varura nga vendimet që merren nga zoti i shtëpisë. 'Nëse dua ta vizitoj familjen time, duhet të marr leje nga kunati, jo nga burri, se ai është "zoti i shtëpisë", thotë Shemsija, 'ai duhet ta dijë nëse një nga nuset nuk është në shtëpi që të organizojë punët e shtëpisë'. Jeta rutimore e kunatave, si e Shemsijes, ndjek një rutinë të ashpër të punëve të shtëpisë, punëve në ara dhe përgjegjësive për rritjen e fëmijëve. Çdo mëngjes, gratë e familjes gatujnë nëntë bukë dhe pesë pite. Për shkak se nuk ka ujë, gratë duhet të mbushin kova me ujë prej bunarit që ta mbushin makinën për larjen e teshave. Rrallë ka rrymë, kështu që teshat shpesh lahen me dorë. "Që kur jam martuar, në moshën 16- vjeçare, kam zier e kam punuar për 50 anëtarë të familjes së burrit. Tani, që kur familja është ndarë në dy shtëpi, i bëj të njëjtat gjëra për 25 anëtarë. Mjaft ka qenë, tërë jeta më ka shkuar duke zier dhe duke pastruar, thotë Shemsija për IKS.

Burri i Shemsijes punon si mësues në shkollën fillore të AçaREVËS. Vajza e tyre Lavdija ka mbaruar vetëm shkollën fillore e djali më i vjetër ka vazhduar shkollimin e mesëm në Skënderaj. Rroga e babait prej 180 Euro është e mjaftueshme për të paguar shkollimin e djalit, por jo të vajzës. Përveç shpenzimeve, arsyet e tjera për ta braktisur shkollën Lavdija pas shkollës fillore janë distanca dhe transporti i parregullt, si dhe fakti që është vajzë. Lavdija i kalon ditët në shtëpi duke pritur, siç thotë nëna e saj, pret "msitin me kërkun dorën."

Pse të investojmë në shkollimin e vajzës që do të martohet dhe nuk do të rrijë në shtëpi, është një pyetje që dëgjohej shpesh. Besimi se shkollimi është një mënyrë për të kaluar nga shtresa fshatare që jeton nga bujqësia për mbijetesë në një shtresë më të lartë të shoqërisë, është humbur gjatë viteve të jostabilitetit dhe të rënies së ekonomisë. Ngritja më e lartë në shkollimin e femrave ka qenë në vitet e 60-ta kur shkollimi u ka garantuar një punësim për tërë jetën në industrinë socialiste dhe institucionet shtetërore. Njerëzit kanë besuar shumë se 'Veç me shkollë ka ardhmëri' dhe djemtë dhe vajzat e zonave rurale kanë vijuar shkollimin në numër të madh. Analfabetizmi ka rënë nga 94 për qind para vitit 1950 në 30 për qind në vitin 1970⁸¹. Shkollimi është parë si shpëtim nga bujqësia apo migrimi – e vetmja alternativë e mundshme për shumë meshkuj të vendeve rurale pa ndonjë perspektivë për punë në Kosovë. Me rënien e ekonomisë në Jugosllavi, besimi në shkollim ka humbur. Që nga vitet e 80-ta 30% e studentëve shqiptarë nuk kanë mundur të regjistrohen në shkollat e mesme⁸². Numri i femrave fshatare që kanë braktisur shkollën është rritur në mënyrë drastike – një trend që vazhdon edhe sot. Arsyet më të shpeshta që përmenden për femrat që braktisin shkollimin e lartë janë mundësitë e vogla për punë, harxhimet e shkollimit dhe rreziku për moralin e femrës.

Nuk e vlen të rrezikosh rënien e reputacionit moral të vajzave nëse mundësitë për të gjetur punë pas diplomimit janë minimale. Gjatë intervistimit të familjeve në vitet e 80-ta nga antropologja Janet Reineck, çështjet e moralit ishin një nga arsyet e fshehta për të mbajtur femrat në shtëpi. 'Janë vetëm disa vajza që kanë vijuar shkollën dhe janë ende vajza të mira,' i kanë treguar asaj, por 'njerëzit këtu mendojnë se vajza prishet kur shkon në shkollë.' Vajzës mund t'i merret fytyra⁸³. Duket se pak kanë ndryshuar gjërat prej 1980-tës. Pikëpamjet tradicionale për moralin vazhdojnë të jenë pengesa direkte për shkollim.

Në vitin 2007, kur IKS-i ka pyetur pse një vajzë e re nuk e vijon shkollën e mesme, na është thënë shumë herë 'se vajzat kur po dalin në shehër, po na marrin fytyrën'. 'Besohet se vajzat që shkojnë në fakultet / vijnë arsimin e lartë, shpjegon Sebahate Myftari nga Rahoveci, 'do të bëhen të pamoralshme dhe do t'i humbin vlerat'⁸⁴. Të të 'merret fytyra' apo të 'humbësh vlerat' ende i referohet humbjes së moralit në sytë e komunitetit të femrave që kalojnë shumë kohë jashtë shtëpisë pa përcjelljen e kushërinjve meshkuj.

Sevdije Kabashi, mësuese në shkollën fillore të Zoqishtës në Rahovec, konfirmon se "Ka shumë pak vajza në fshat që vazhdojnë shkollimin e mesëm, se disa vajza nuk janë sjellur mirë, pra fshatarët tani hamenden para se t'i dërgojnë vajzat e tyre në shkollë'.

Kur fshatarët u provokuan të japin shpjegime përse ato 'nuk janë sjellë mirë', ata thanë se 'ato shkojnë në kafene dhe rrinë me djem'. Një nga shumë vajza që u detyruan nga të tjerët ta braktisin shkollimin ishte Shemsije Kastrati nga Xërxa në Rahovec, e cila në një orë të Programit për Shkrim-Lexim kishte shkruar se:

81 Politika ekonomike 1973:637, Burimi: E kaluara si refugjat: Çështjet gjinore, imigrimi dhe ideologjia në mesin e shqiptarëve të Kosovës, 1991, Janet Reineck

82 E kaluara si refugjat: Çështjet gjinore, imigrimi dhe ideologjia në mesin e shqiptarëve të Kosovës, 1991, Janet Reineck, fq.167

83 E kaluara si refugjat: Çështjet gjinore, imigrimi dhe ideologjia në mesin e shqiptarëve të Kosovës, 1991, Janet Reineck, fq.170-171

84 Intervistë me Sebahate Myftarin, pronare e autoshkollës 'Moderna-s', Rahovec, shtator 2007.

'kur kam qenë fëmijë, [...] babai im nuk më ka lejuar që të vazhdoj shkollimin [...] më ka mbyllur në shtëpi dhe nuk më ka lënë të dal fare.'⁸⁵

'Në të kaluarën, asnjë femër nuk ka mundur të dalë nga shtëpia pa burrin e saj', kujton Makfire Maksuti, një mësuese e këtij programi nga fshati Lubovec në Skënderaj.⁸⁶ 'Shumë femra në Lubovec nuk dinë të shkruajnë e të lexojnë, por turpërohen ta pranojnë', shpjegon Makfirja. Para luftës, shkolla fillore në fshat ka ofruar vetëm 5 klasë; disa vajza kanë ecur 4 km deri në shkollën më të afërt. Si pjesë e programit të arsimit nga UNICEF Makfire Maksuti ka mësuar një grup të 9 femrave nxënëse, shumica e tyre në të njëzetat.

Një nga nxënëset ishte Hanife Ramishi. Hanife Ramishi është 21-vjeçare dhe jeton me babain e saj të moshuar dhe motrën e hendikepuar 35 vjeçare. Motra tjetër e Hanifes dhe vëllezërit janë martuar dhe jetojnë jashtë vendit. Familja ka një hektar tokë dhe një lopë dhe merr pensionin që i takon babait dhe pensionin invalidor për motrën. Hanifja e ka lënë shkollën pas përfundimit të klasës së tretë 'sepse nuk kemi pasur mjaft para dhe sipas mentalitet tradicional, femrat nuk duhet të shkojnë në shkollë.' Pas përfundimit të kursit të shkrimit dhe leximit bazik, Hanifja e ka marrë lejen dhe tani mund të vozisë familjen për në Skënderaj në shitore apo të shkojë të mjeku. Hanifja ka thënë se vetëm disa femra mund të ecin deri te rruga kryesore e asfaltuar, që shpie te fshati, pa kushërinjtë meshkuj. 'Sipas mentalitetit të fshatit, femrat nuk duhet të shkojnë vetëm në Mitrovicë më autobus', shpjegon ajo, 'Unë mund të shkoja vetëm në kursin e shkrimit dhe leximit bazik, se ishte më afër shtëpisë', po të ishte jashtë fshatit, ajo do të ishte ballafaquar me rezistencë nga familja e saj.⁸⁷

Qoftë në Skënderaj, Rahovec apo Podujevë, pikëpamjet tradicionale për moralin vazhdojnë të ndalojnë femrat rurale të lëvizin lirshëm. Njëzetvjeçarja Valdete Gashi nga Rahoveci ka konfirmuar se deri sot në Zoqishtë vajzat e reja nuk lejohen të shkojnë në fshat apo ta vizitojnë Rahovecin pa shoqërimin e kushërinjve.⁸⁸

Këto pikëpamje nuk janë vetëm pikëpamje të fshatit, por edhe të qendrave të vogla urbane si Rahoveci apo qyteti i Skënderajt. Unë jam e befasuar se sa është i madh numri i femrave analfabete në qytetin e Rahovecit', janë fjalët e Fiqirije Kajtazit, që ka mësuar një nga dy grupet e Rahovecit në Programin e Shkrimit dhe Leximit bazik të UNICEF-it. Shtatë nxënëset e saj janë larg prej izolimit dhe jetojnë në qytetin e Rahovecit. Nxënëset e saj ishin pjesë e "gjeneratës së humbur" të vitit 1990. Miranda ishte 19 vjeçare, Elvanja 22, Samilja 23, Bademja 31, Elvanja 34, Luljeta 36 dhe më e vjetra ishte Zyrafetja 38 vjeçare.⁸⁹

85 IKS e ka marrë këtë thënie nga shënimet e Luljeta Kryeziu, mësuese në programin 'Dritare Jete', Xërxe, Rahovec, gusht 2007.

86 Intervistë me Makfire Maksutin, mësuese në klasat e shkrim-leximit, fshati Lubovec, Komuna e Skënderajt.

87 Intervistë me Hanife Ramishin, nxënëse, fshati Lubovec, Komuna e Skënderajt.

88 Intervistë me Valdete Gashin (Familja e Avdurrahman Gashit), fshati Zoqishtë, komuna e Rahovecit, 22 nëntor, 2006.

89 Intervistë me Fiqirije Krasniqin, mësuese në klasët e shkrim-leximit, grupi I, 29 gusht, 2007. Edhe në grupin e dytë në Rahovec, 7 femra nga gjithsej 8 kanë qenë analfabete.

Bota e meshkujve

Në Kosovën rurale femrat janë shumë larg nga syri i publikut. Të izoluara në shtëpitë e tyre, në punët e lodhshme bujqësore në ferma, duke rritur dhe shkolluar gjeneratat e reja dhe duke u kujdesur për të vjetrit, femrat mungojnë në statistikat zyrtare dhe në diskursin publik.

Të dhënat statistikore në Kosovë, sidoqoftë, merren me një dozë të madhe skepticizmi. Prej shumës së përgjithshme të 4,104 bizneseve në Rahovec, Podujevë dhe Skenderaj, të regjistruara në MTI, në MEF zyrtarisht janë të regjistruar si taksapagues vetëm 2,232. Duke marrë parasysh dallimet e mëdha mes të dhënave zyrtare dhe realitetit në terren, IKS ka zgjedhur një qasje nga terreni për të mbledhur dhe detajizuar intervistat me punëdhënësit privatë dhe publikë.

Tabela 3: Numri i bizneseve dhe i të punësuarve

Komuna	# i bizneseve të regjistruara	# i taksapaguesve**	# i punëtorëve***
Podujeva	1,874	1,089	3,223
Rahoveci	1,389	667	2,432
Skënderaj	841	476	1,415
Total	4,104	2,232	7,070

* Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

** Ministria e Financave dhe Ekonomisë

*** Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Përshtypja që del nga kjo është se “bota është e meshkujve”; disa femra janë të punësuar me rrogë dhe vetëm disa femra i kanë bizneset e tyre. Nga 76 bizneset private të intervistuar nga IKS-i, një të tretat nuk kanë të punësuar femra fare, një të tretat kanë të punësuar vetëm një femër dhe vetëm 7 kompani kanë të punësuar më shumë se 3 femra.⁹⁰ Në Rahovec, vetëm 7.4 % e bizneseve janë pronë e femrave (103 biznese); kryesisht butiqe, rrobaqepëse dhe sallone të flokëve. Mesatarisht, ndarja e bizneseve private në 3 komuna është më pak se 9%.

Tabela 4: Bizneset e femrave në tri komuna

Komuna	# i bizneseve të regjistruara	# biznesve të femrave	Përqindja
Podujeva	1,874	170	9 %
Rahoveci	1,389	103	7.4 %
Skënderaj	841	96	11.4 %
Total	4,104	369	9.3 %

Një numër i madh i femrave janë ekonomikisht aktive në bujqësi, shumica në afërsi të shtëpive të tyre, duke u përkujdesur për kopshtet me perime, për gjedhet dhe duke përgatitur ushqimin për familjet e tyre. Vetëm disa femra marrin rrogë (me para të gatshme) nga këto aktivitete; pothuajse

90 IKS hulumtimi në të terren , Rahovec, Podujevë, Skënderaj, korrik-tetor, 2007.

asnjë nuk ka mundësi të paguajë pension apo sigurim shëndetësor dhe varshmëria ekonomike nga familja është pothuajse absolute.

Ne kemi shtruar një pyetje të thjeshtë: pse femrat nuk marrin pjesë në tregun e punës në vendet rurale? Një arsye është obligimi që kanë ndaj familjes dhe fëmijëve. Dy arsye të tjera janë se femrat nuk punojnë për shkak të mungesës së mundësive për punësim për shumicën e femrave të zonave rurale, si dhe mungesa e shkathtësive të tyre për tregun e punës.

Ka pak arsye për nostalgji ndaj së kaluarës socialiste të viteve 1988, ku vlerësohet se 90.3 % të femrave shqiptare ishin ekonomikisht të varura, kurse vetëm 22% nga të punësuarit ishin femra.⁹¹ Dallimi më i madh në socializëm ishte se 39.2 % ishin të punësuar në industri, derisa sot pak mund të flitet për një industri të mirëfilltë. Shumica e ndërmarrjeve në Skënderaj, Rahovec apo Podujevë ka të bëjë me ndërtimtari – tulla, përforcime çeliku, dritare, korniza dyeresh apo prodhime bujqësore, duke përfshirë pijet dhe verën, mullinj të dhe mbledhësit e kërpudhave. Industritë tradicionale ku femrat janë punësuar në të kaluarën, shumica në tekstil, veshmbathje dhe industri të ushqimit, janë shuar.

Meqë vendet e punës janë të rralla, femrat ballafaqohen me një konkurrencë të vështirë. Ka shumë pak vende të punës krahasuar me konkurrencën për punësim të një numri të madh të femrave dhe meshkujve me shkathtësi të ulëta. Në një fshat tipik, të vetmet “vende lokale të punës” janë në shkollën fillore dhe ambulancat (nëse ekzistojnë), në dyqanet familjare, ndoshta në ndonjë punëtor druri, mekanik automjetesh, pompë benzine apo prodhim të dyerve apo dritareve, në ndonjë internet kafe apo edhe si vozitës taksit. Vetëm disa nga këto vende pune janë të përshtatshme për femrat, duke marrë parasysh shkathtësitë dhe parajykimet shoqërore për profesionet e caktuara. Pra, nuk është befasi që profesioni më i zakonshëm dhe më i popullarizuar tek femrat rurale është ai i mësueses së shkollës fillore për femrat me shkathtësi më të larta, dhe i flokëtares, për ato që nuk kanë shkathtësi. Punë e cila po ashtu mund të kombinohet më lehtë edhe me punët e shtëpisë dhe kujdesit ndaj fëmijëve.

Sipas një studimi të UNIFEM-it në vitin 2000, shumica e femrave që kanë punë me pagesë në zonat rurale punonin si mësuese. Më pak se 16% të femrave kanë pasur vende të punës me pagesë. Femrat që kanë punuar në industri kanë qenë 31%, që reflekton një rënie totale të industrive tradicionale ku femrat janë punësuar në të kaluarën. Shumica e femrave të intervistuar nga UNIFEM-i dëshironin të punonin, por nuk kishte vende pune dhe nuk kishin shkathtësitë e nevojshme për tregun e punës.⁹² Një numër i madh i femrave punonin në shtëpitë e tyre si rrobaqepëse dhe floktare, apo ishin përgjegjëse në shitoren e familjes. Nga ato që ishin të punësuar jashtë shtëpisë, një të tretat punonin në biznes, shumica si shitëse, dhe një të tretat në profesione të ndryshme. Prej femrave profesionale, afro 39% punonin si infermiere dhe 22% si mësuese.⁹³

91 Rilindja, 24 mars 1988, burimi: E kaluara si refugjat: Çështjet gjinore, imigrimi dhe ideologjia në mesin e shqiptarëve të Kosovës, 1991, Janet Reineck

92 Gratë në punë, situata dhe mundësitë ekonomike për gratë në Kosovë, UNIFEM, DFID, 2000, fq.45


93 Gratë në pune, situata dhe mundësitë ekonomike për gratë në Kosovë, UNIFEM, DFID, 2000, fq.45

Një studim në vitin 2006 nga She-ERA, një asociacion i bizneseve të femrave, konfirmoi të njëjtat trende. Nga 1,450 femra të intervistuar, vetëm 4% janë të përfshira në aktivitetet bujqësore, 15% në biznesin e prodhimit të tekstit, uniformave, prodhimeve qumështore, konservimin e perimeve, brumërat, thurja e tepihëve dhe rrobaqepësia, 38 % janë në sektorin e shërbimeve dhe 43% në tregti.⁹⁴ “Shërbimi” më i njohur që ofrohet nga femrat është floktaria – me 44 për qind të femrave në sektorin e shërbimeve kanë salon të frizereve, 27 për qind të salloneve të estetikës dhe 8 për qind shërbime shëndetësore. Duke u mbështetur në zgjerimin e salloneve të floktareve për të ngritur punësimin e femrave, sidoqoftë, nuk mbetet ndonjë opion i vërtetë. Potenciali për rritjen e shumicës së bizneseve, tek të cilat femrat janë pronare, është i kufizuar. Shumica (56.3 %) janë biznese të një femre; vetëm 3% punësojnë më shumë se 4 persona.

Të dhënat nga anketa po ashtu konfirmojnë mungesën e lëvizshmërisë për shumicën e femrave nga vendet rurale, si dhe shkallën e lartë të varshmërisë. Shumica e femrave udhëheqin bizneset duke qëndruar në shtëpi për të qenë afër familjeve të tyre për shkak të pamundësisë për të punësuar dikë për t’u kujdesur për fëmijët. Më pak se 5% operojnë bizneset e tyre në ndonjë qytet a fshat tjetër.⁹⁵ Në 77 për qind të rasteve, është faktikisht burri, babai apo djali që marrin vendimet kryesore të bizneseve. Numri i femrave ndërmarrëse që jetojnë kryesisht nga rrogat e tyre personale është vetëm 13%.⁹⁶ Ka, sidoqoftë, një interes të madh për aftësim profesional dhe ndërtimin e kapaciteteve - 82 për qind kanë shprehur interes të madh për avancimin e shkathtësive profesionale, posaçërisht në lëmin e marketingut, teknik të shitjes, resurseve njerëzore dhe menaxhimit të financave dhe IT-së.⁹⁷

Numri total i bizneseve të intervistuar: 76

Komuna e Podujevës:	21	28%
Komuna e Rahovecit:	25	33%
Komuna e Skenderajit:	30	39%



94 Grate afariste në Kosovë, Analizë e bizneseve në pronësi të grave, 2006, She-ERA, fq.108

95 Grate afariste në Kosovë, Analizë e bizneseve në pronësi të grave, 2006, She-ERA, fq.116

96 Grate afariste në Kosovë, Analizë e bizneseve në pronësi të grave, 2006, She-ERA, fq.106

97 Grate afariste në Kosovë, Analizë e bizneseve në pronësi të grave, 2006, She-ERA, fq.135

**Tabela 5: Punësimi publik në komunën e Skenderajit,
Rahovecit dhe të Podujevës**

SKENDERAJ								
Gjinia	Kuvendi Komunal ⁹⁹	Arsim ¹⁰⁰	Shëndetësi ¹⁰¹	KEK ¹⁰²	PTK	Ujësjiellës ¹⁰³	Pastrimi ¹⁰⁴	Totali
Meshkuj	167	722	82	100	12	28	21	1132
Femra	38	184	103	1	4	1	0	331
Totali	205	906	185	101	16 ¹⁰⁵	29	21	1463
RAHOVEC ¹⁰⁶								
Meshkuj	152	700	63	38	16	28 ¹⁰⁷	26 ¹⁰⁸	1023
Femra	22	234	64	0	8	0	1	329
Totali	175	934	127	38	24 ¹⁰⁹	28	27	1352
PODUJEVË								
Meshkuj	213	1012	90	373	10	30 ¹¹⁰	34	1762
Femra	53	374*	158	5	4	1	1	596
Totali	266	1386	248 ¹¹¹	378	14 ¹¹²	31	35 ¹¹³	2358
TOTALI								5173
Femra								1256

* Ky numër përfshin numrin total të femrave të punësuar në sektorin e arsimit në Podujevë pa specifikim të nivelit arsimor

Nuk ka pasur shumë ndryshime prej vitit 2000 kur është bërë studimi i UNIFEM-it, anketa e She-Era-s në vitin 2005 si dhe pranverës së vitit 2007 kur UNICEF/IKS ka nisur hulumtimin. Sektori publik, përfshirë edhe administratën publike, në veçanti arsimin dhe sektorin e shëndetësisë, mbetet punëdhënësi më i madh i femrave. Profesionit i vetëm i famshëm i femrave mbetet profesioni i mësueses. Me 792 femra të punësuar, që përbëjnë 65 % të punësimit të femrave në sektorin publik, sektori i arsimit mbetet padyshim punëdhënësi më i madh në Rahovec, Podujevë dhe Skenderaj. Pastaj administrata në komuna punëson gjithsej 113 femra dhe sektori i shëndetësisë 325 femra. Punësimi i femrave në sektorin publik në të tri komunat, përfshirë edhe shërbimet publike, arrin në 1,256 – çereku i punësimit të përgjithshëm publik.

Por, sektori publik nuk është punëdhënësi i madh i femrave me shkathtësi të ulëta nga viset rurale. Shumica e femrave të punësuar në sektorin publik kanë së paku shkollimin e mesëm; vetëm 0.07 % të femrave të punësuar kanë më pak se arsimin fillor. Nga 26 femra të punësuar në kompanitë

98 Skenderaj 331, Rahovec 329, Podujevë 596

99 Intervistë me Nasuf Shabanin, drejtor i administratës së përgjithshme në Kuvendin Komunal të Skenderajit.

100 Të dhënat nga Ahmet Tahiri, zyrtar i arsimit, Kuvendi Komunal, Skenderaj.

101 Të dhënat nga Azem Geci, zyrtar për financa, Shtëpia e Shëndetit, komuna e Skenderajit

102 Të dhënat për të tri komunat për KEK nga Pranvera Muhadri, Divizioni i Resurseve Njerzore, KEK, 2007

103 Të dhënat nga Iljaz Halili, drejtor, Njësia e Ujësjiellësit, komuna e Skenderajit.

104 Të dhënat nga Haki Zahiti, kompania 'Pastrimi', komuna e Podujevës

105 Të dhënat nga Hyka Rexha, administratore rajonale e PTK-së, Mitrovicë

106 Të dhënat nga Halit Kerndali, zyrtar, komuna e Rahovecit

107 Të dhënat nga Feim Mullaabazi, zyrtar i ujësjiellësit, Rahovec

108 Të dhënat nga Xhemajli Haxhimustafa, zyrtar, kompania 'Pastrimi', komuna e Rahovecit.

109 Të dhënat nga Besa Doranber, administratore rajonale e PTK-së, Prizren

110 Të dhënat nga Mehdi Dervishi, zyrtar i ujësjiellësit, Podujevë

111 Të dhënat nga Bahri Thaçi, drejtor, Shtëpia e Shëndetit, Podujevë

112 Të dhënat nga Fisnik Bytyçi, zyrtar, PTK, Prishtinë

113 Të dhënat nga Hasan Mehmeti, zyrtar, kompania 'Pastrimi', Prishtinë.

e shërbimeve publike, vetëm 6 prej tyre kanë kryer shkollën e mesme. Nga 113 të punësuar për administratën komunale, 75 e kanë të përfunduar shkollën e mesme dhe vetëm 11 kanë të kryer më pak se shkollën fillore.

Tabela 6: Shkathtësitë e femrave në sektorin publik në Skënderaj, Rahovec dhe Podujevë

Shkathtësitë	Kuvendi Komunal	Sektori i arsimit	Sektori i shëndetësisë	Shërbimet komunale	Totali	Gjithsej %
Postdiplomike	1	0	16	0	17	1.4%
Fakulteti	24	778 ¹¹⁴	14	1	817	65%
Shkolla e lartë	2	2	0	0	4	0.3%
Shkollimi i mesëm	75	9	262	20	366	29%
Shkollimi fillor	11	3	32	5	51	4.1%
Më pak se shkollimi fillor	0	0	1	0	1	0.07%
Totali	113	792	325	26	1,256	100

Sektori privat, në anën tjetër, është shumë i vogël ende, si në madhësi ashtu edhe në strukturë për të krijuar vende të mjaftueshme të punës që të absorbojë numër më të madh të të papunëve dhe të femrave dhe meshkujve me shkathtësi të ulëta. Shumica e 4,104 bizneseve të regjistruara në Podujevë, Rahovec dhe Skënderaj janë të shkallës së ulët, biznese familjare të shitjes me shumicë e pakicë, kompani ndërtimore dhe ofrues shërbimesh, përfshirë restorantet, baret dhe shkollat e vozitjes. 1,874 bizneset në Podujevë, për shembull, punësojnë mesatarisht 1.7 persona dhe 43.3 % të punësimit janë në tregti.¹¹⁵ Nuk është për t'u befasuar se punëdhënësi më i madh i femrave në tri komunat, që punëson 35 femra në përgjithësi – është Ben-Af-i në Skënderaj, një supermaket dhe seri e restoraneve të ushqimit të shpejtë (fast food) në rritje e sipër. E dyta ndërmarrje për nga numri i femrave të punësuar është Valrisi Company, një butik pronë e një femre dhe një shitore e rrobaqepëseve në Podujevë me 21 punëtorë. I treti për nga madhësia është mulliri dhe prodhuesi i pastave M&Silosi në Xërxë Rahovec.¹¹⁶

114 Ky numër përfshin numrin e përgjithshëm të femrave të punësuar në sektorin e arsimit në Podujevë pa specifikuar nivelin e arsimit.

115 SOK, Numri i bizneseve të regjistruara për vitin 2006, nga Hysni Elshani, zyrtar i ESK-ut, shtator 2007

116 IKS-Hulumtimi në terren, Xërxë, Rahovec 2007.

DREJT LISBONËS

44

Vlerësimi i nevojave për trajnime profesionale, si dhe i krijimit të mundësive për punësim të femrave në zonat rurale



Tabela 7: Punëdhënësi/punofruesi më i madh i femrave

Emri	Sektori	Komuna	Vendi	Femra	Meshkuj	# punëtorëve
Ben-af	supermarket	Skenderaj	Qyteti i Skenderajt	35	65	100
Valrisi	Butik/rrobaqepësi	Podujevë	Qyteti i Podujevës	35	65	100
tailoring	Podujevë/ Podujevo	Podujevë/Podujevo Town	21	0	21	
M&Silosi	Prodhime bujqësore	Rahovec	Xërxë	15	352	367
Laberion	Prodhime bujqësore	Podujevë	Fshati Glamnik	9	44	53
Elma	rrobaqepësi	Rahovec	Qyteti i Rahovecit	9	1	10
Besiana	hotel	Podujevë	Qyteti i Podujevës	8	30	38
FAN	Material ndërtimor	Podujevë	Qyteti i Podujevës	7	193	200
Gashi	Prodhime bujqësore	Podujevë	Qyteti i Podujevës	5	6	11
ProCredit Bank	Shërbime financiare	Skenderaj	Qyteti i Skenderajt	5	6	11
Dona	Shitore për fëmijë	Skenderaj	Qyteti i Skenderajt	5	2	7
Total				119	699	818

Shkathtësitë e kërkuara

Me 367 persona në listë të rrogës, përfshirë 15 femra, M&Silosi është punëdhënësi më i madh i femrave në tri komunat dhe i treti punëdhënës i femrave në përgjithësi. M&Silosi është privatizuar në vitin 2005 nga një biznesmen shqiptar i Maqedonisë, i cili premtoi të investojë 20 milionë Euro dhe të hapë 350 vende të punës. Kapaciteti i përgjithshëm për mbledhjen e grurit në katër silosë është 52,000 tonë. Kompania paguan rroga për 367 të punësuar, shumica ish- punëtorë, por tani vetëm 169 punojnë. Stafii prej 15 femrave është i koncentruar në laboratorë dhe në punë administrative. Shumica e teknologjisë është e importuar nga Italia dhe është moderne.

Hajdar Vuçitërna, drejtori i prodhimit në 'M&Silosi', është specialist në inxhinierinë e teknologjisë së grurit, miellit dhe prodhimit të pastave. Ai ka përfunduar studimet në Zagreb, mundësuar nga bursa e kompanisë. Ai i është bashkëngjitur 'M&Silosi'-it pas privatizimit. Si Vuçitërna, shumica e të punësuarve të M&Silosi-i kanë punuar më parë për të njëjtën kompani në socializëm. Me teknologjinë e re, shume prej shkathtësive të marra gjatë 1970 apo 1980-tave janë të pashfrytëzueshme e të vjetërsuara.

Brenga më e madhe e kompanisë është të gjejë inxhinierë të kualifikuar të teknologjisë për të zëvendësuar fuqinë punëtorë të vjetër të kompanisë.¹¹⁷ Në të kaluarën, shkolla e mesme profesionale në Rahovec ka ofruar 2 kurse specializimi në drithëra, miell dhe prodhim të pastave dhe të punësuarit janë dërguar në vende të ndryshme në ish-Jugosllavi për trajnim. 'Që nga viti 2000, askush nuk ka menduar për organizimin e trajnimeve profesionale apo shkolla, andaj kemi mungesë, shpjegon Hajdari, vetë ish-mësimdhënës në shkollën e mesme në Rahovec. Ai mbetet optimist, por pranon se mungesa e ekspertëve të inxhinierisë dhe teknologjisë mund ta dëmtojë biznesin në të ardhmen e afërt.¹¹⁸

M&Silosi nuk është rast i veçantë. Shumica e ndërmarrjeve të privatizuara të intervistuar kanë raportuar për mungesë të stafit të kualifikuar teknik dhe inxhinierëve industrial. Mungesa e shkathtësive renditet prej shkathtësive të prodhimit dhe procesimit, paketimit dhe inxhinierisë teknologjike. OSA Termosistem në Rahovec, për shembull, kërkon punëtorë me përvojë në ftohës, ngrohës dhe pajisje për ftohje. Ka shumë të rinj me shkathtësi kompjuteri dhe gjuhëve të huaja, por s'ka me përvojë në industri. Mungesa e ekspertëve të kualifikuar po ashtu i dëmton kompanitë e vogla si kompania 'Gashi' për prodhimin i pijeve në Podujevë. Tri deri në katër herë në vit Sejdi Gashi duhet të sjellë inxhinierin nga Zvicra për të analizuar prodhimin e pijeve. Çdo udhëtim i kushton kompanisë 'Gashi' afro 2000 Euro plus shpenzimet për akomodim, që është e barabartë me një rrogë mesatare mujore prej 250 Eurove'.¹¹⁹ Kjo shton shpenzimet e prodhimit dhe zvogëlon konkurrencën e kompanisë.

117 Intervistë me Hajdar Vuçitërnën, drejtor i prodhimit, dhe Lendita Pulën, udhëheqëse e Departamentit të Resurseve Njerëzore, M&Silosi, Xërxë, Rahovec, 2007.

118 Intervistë me Hajdar Vuçitërnën, drejtor i prodhimit, 'M&Silosi', Rahovec, 2007.

119 Intervistë me Sejdi Gashin, pronar, prodhues i pijeve kompania 'Gashi', Podujevë, 2007.

Tabela 8: Dhjetë punëdhënësit më të mëdhenj

Ndërmarrja	Aktiviteti	Vendi	# meshkuj	# femra	Punësimi total
M&Silosi	Prodhimtari bujqësore	Xërxë	352	15	367
Stonecastle vineyards and winery	Prodhimtari bujqësore	Fshati Bernjake	291	3	294
FAN	Material ndërtimor	Qyteti i Podujevës	193	7	200
Vellezerit Geci	Material ndërtimor	Qytetit i Skenderajt	149	1	150
Euroblock	Material ndërtimor	Qyteti i Podujevës	99	1	100
Ben-Af	tregti	Qytetit i Skenderajt	65	35	100
Fetoshi	Material ndërtimor	Fshati Bellacerkva	60	0	60
OSA Termosistemi	Përpunim industrial	Fshati Bernjake	54	2	56
Laberion	Prodhimtari bujqësore	Fshati Gllamnik	44	9	53
Korenica	Material ndërtimor	Xerxe	49	3	52
Total			1,356	76	1,432

Përrjashtimi masiv i shqiptarëve nga punësimi në industritë socialiste gjatë viteve 1990 dhe kushtet e shkollimit në sistemin paralel faktikisht kanë përrjashtuar një gjeneratë të tërë nga trajnimi në punë dhe ka çuar në një humbje të shpejtë të shkathtësive. Me rënien e industrive socialiste, trajnimi në kompani i takon së kaluarës. Për shkak të mungesës së aplikantëve të duhur, OSA Termosistem është tani në procesin e hartimit të një skeme të brendshme të trajnimit që do të përcillte shkathtësitë nga një gjeneratë e punëtorëve në tjetrën.¹²⁰ Por vetëm disa kompani në Kosovë kanë madhësinë dhe mjetet financiare të investojnë në trajnimet e punëtorëve gjatë shërbimit në punë.

Shumica e sektorit privat të Kosovës është e përbërë nga ndërmarrje të vogla familjare, bizneset e shitblerjes / shitore dhe butikët. Si pjesë e këtij hulumtimi, IKS ka pasur intervista të hollësishme me 58 ofrues të shërbimeve dhe tregtisë. Me mesatarisht katër punëtorë, këtyre kompanive u mungojnë kapacitetet menaxheriale, financiare dhe teknike për të investuar në trajnimet që ofrohen gjatë shërbimit. Vetëm disa nga këto kompani kanë plane për të punësuar dikë në të ardhmen, meqë shumica luftojnë për të mbijetuar. Shkathtësitë e identifikuar si të nevojshme të përmendura në intervista reflektojnë natyrën e sektorit privat në Kosovë. Profesionet dhe shkathtësitë e përmendura janë ato të instruktorëve për vozitje, agjentëve të udhëtimit, marketingut dhe asistentëve administrativë, shitësve, kamarierëve, kontabilistëve dhe zyrtarëve të marrjes së kredive. Aftësi të tjera më specifike janë ato të procesimit të ushqimit dhe përvojës farmaceutike, përvojës laboratorike, vreshtari dhe prodhimin e pijeve, përvojë dentisti dhe bujqësore (shiko aneksin II, tabela për nevojat e shkathtësive).

Shumica e vendeve të punës kërkojnë së paku të kenë të kryer shkollën e mesme; kërkesat për fuqi punëtore të gjinisë femërore pa kualifikime janë minimale. Shumica e vendeve të punës janë të koncentruara në qendrat e mëdha urbane, si në qytetin e Podujevës, Rahovecit apo Skenderajt. Punët me pagesë në fshatin si Açarevë, Dobërdol apo Zoqishtë, ku jeton shumica e popullsisë, pothuajse nuk ekzistojnë. Për disa punë me pagesë që ekzistojnë në vendet jurbane, sidomos ato që kërkojnë shkathtësi profesionale, femrat me përvojë që janë të

120 Intervistë me Sahadete Dulën, bashkëpronare, 'OSA Termosistemi' në Bërnjakë (Rahovec), 4 korrik 2007

punësuarat aty vijnë nga qytetet pranë. Lendita Pula, udhëheqëse e Resurseve Njerëzore në 'M&Silosi' në Xërxë, ka konfirmuar duke thënë se ' shumica e të punësuarave në fabrikë vijnë nga qyteti i Rahovecit, Prizrenit dhe Gjakovës, posaçërisht femrat që punojnë në laboratore dhe administratë.'¹²¹ Vetë Lendita është avokate e diplomuar dhe udhëton çdo ditë 24 km nga Gjakova për të ardhur në punë.

Kompania e prodhimit 'Korenica' në Xërxë është duke planifikuar të rrisë biznesin dhe të fillojë prodhimin e paketimeve plastike. Kjo nënkupton krijimin e 10 vendeve të reja të punës, përfshirë këtu edhe 3 vende potenciale të punës në paketim, nëse kandidatet kanë shkathtësitë e duhura. Mustafë Korenica, drejtori i kompanisë, ka kërkuar femra me shkathtësi marketingu dhe administrate, por meqë nuk ka persona të shkathtë për shkak të mentalitetit të Rahovecit, ai është obliguar të kërkojë punëtorë në qytetet përreth.¹²²

Në mungesë të shkathtësive që kërkohen për tregun e punës, femrave të vendeve rurale u mbetet të zgjedhin punët si pastruese, floktare, rrobaqepëse apo në kuzhinë. Këto janë vende të punës, pagesa e të cilave nuk mund të kompensojë as shpenzimet e punësimit jashtë shtëpisë. Rroga mesatare për një femër më të re se 35 vjet me shkollë filllore ishte 132 Euro në muaj, krahasuar me 307 Euro për një femër me shkollim universitar që paguhet 307 Euro.¹²³

Duhet durim dhe perspektivë afatgjate. Edhe me rritje të nivelit të investimeve në arsim dhe trajnim të popullatës së femrave, Kosova do të ketë rënie në pjesëmarrjen e femrave në fuqinë punëtore në aspektin afatshkurtër. Në tërë botën, pjesëmarrja e femrave në fuqinë punëtore në vendet shumë të varfra, si dhe në vendet e zhvilluara është shumë e lartë dhe femrat kryesisht punojnë në ferma dhe në ndërmarrje të tjera të familjes. Si vendet më të varfra, ashtu edhe ato të pasura kanë arritur të kenë më së shumti 50% pjesëmarrje të femrave në fuqinë punëtore, ndërsa ka rënie në 35% në vendet ku pagat janë më pak se 2.500 dollarë në kokë banori.¹²⁴ Ngritja e zhvillimit ekonomik fillimisht i largon femrat nga fuqia punëtore dhe sjell rënie të pjesëmarrjes së femrave në fuqinë punëtore. Dëshmitë nga vendet e tjera tregojnë se vendet me të ardhura të ulëta, ku femrat janë të përfshira në ndërmarrjet familjare, zhvillimi ekonomik që vjen në formë të një sektori të ri industrializimi, fillimisht ka përmirësuar mundësitë e ekonomike për meshkuj në krahasim me mundësitë për femra.¹²⁵

Politikëbërësit dhe planifikuesit duhet doemos të kenë një vizion më afatgjatë. Me zhvillimin ekonomik, natyra e punëve të femrave ndryshon. Në ekonomitë e tjera të industrializuara, përfshirë këtu edhe SHBA-të, ngritja e shkallës së femrave në fuqinë punëtore ka qenë rezultat i ngritjes së punëve profesionale, kryesisht në sektorin e punëve të administratës.¹²⁷ Përfitimet nga shkollimi i femrave, si në kuptimin e përgjithshëm, por edhe në raport me nivelin e shkollimit të meshkujve, ka mundësuar që femrat të kenë punë profesionale dhe të punojnë jashtë shtëpisë. Me rritjen e nivelit të shkollimit të femrave (hapja e mundësive të punëve profesionale në tregun e punëve me paga më të larta) dhe me rënie të produktivitetit (zvogëlimi i shpenzimeve të punëve jashtë shtëpisë), femrat kanë kaluar në sektorin formal në numër të madh.

121 Intervistë me Lendita Pulën, udhëheqëse e Resurseve Njerëzore 'M&Silosi', Rahovec

122 Intervistë me Mustafë Korenicën, drejtor, 'Korenica', Rahovec

123 Studim për fuqinë punëtore, ESK, 2002

124 Puna e femrës dhe zhvillimi ekonomik, Kristin Mammen dhe Christina Paxson, Revistë e perspektivave ekonomike, Vëllimi 14, Numri 4, Vjeshtë 2000, fq. 141-164

125 Puna e femrës dhe zhvillimi ekonomik, Kristin Mammen dhe Christina Paxson, Revistë e perspektivave ekonomike, Vëllimi 14, Numri 4, Vjeshtë 2000, fq. 141-164

126 Puna e femrës dhe zhvillimi ekonomik, Kristin Mammen dhe Christina Paxson, Revistë e perspektivave ekonomike, Vëllimi 14, Numri 4, Vjeshtë 2000, fq. 141-164

127 'Mbështetja e të papunësuarve dhe punëkërkuësve në Kosovë: Rritja e punësueshmërisë. Një strategji për arsimim profesional'





KAPITULLI IV: RETORIKA DHE REALITETI

Nuk ka mungesë të strategjive, planeve të punës dhe direktivave. Strategjia Kombëtare për Zhvillim të Punësimit dhe Fuqisë Punëtore është aprovuar në vitin 2001 dhe bën thirrje për ndërrmarjen e masave aktive për të siguruar qasjen e femrave në punë dhe mundësi aftësimi. Ligji mbi barazinë gjinore, i aprovuar në vitin 2004, në veçanti bën thirrje për mundësi të barabarta për vijimin e arsimit, aftësimin profesional dhe kurse që përmirësojnë shkathhtësitë profesionale. Neni 13.6 thotë:

'punëdhënësit apo institucionet që ofrojnë trajnime profesionale ... nuk do të diskriminojnë në baza individuale apo gjinore'.¹²⁸

Në letër, Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë Gjinore, i aprovuar në vitin 2004, siguron pjesëmarrje të barabartë dhe prezantim të femrave në të gjitha sferat politike, ekonomike, kulturore dhe sociale të jetës.¹²⁹ Plani i Veprimit po ashtu në mënyrë specifike bën thirrje për shkollim të barabartë pa stereotipe gjinore dhe diskriminim.¹³⁰ Por, vullneti politik dhe resurset adekuate për t'i kthyer këto dokumente nga letra të vdekura në politika konkrete ende mungon.

Momentalisht institucionet publike për arsim të të rriturve përfshinë rrjetin e 8 qendrave të trajnimit profesional, drejtuar nga MPMS, Programin e Shkrimit dhe Leximit Bazik të mbikëqyrur nga MASHT dhe të implementuar nga 21 OJQ, klasët e bashkëngjitura për pakicat (MASHT) dhe arsimin joformal të ofruar në shkollat e mesme (MASHT). Një vlerësim i bërë kohët e fundit nga Fondacioni Evropian i Arsimit dhe Aftësimin me bazë në Torino (ETF), ka theksuar se ka deficit në ofrimin e arsimit të të rriturve apo, siç thuhet me fjalët e ETF-së:

'Arsimi post-sekondar dhe arsimi i vazhdueshëm pothuajse nuk ekzistojnë, pjesërisht si rezultat i promovimit të arsimit të të rriturve. Arsimi formal i të rriturve pothuajse mungon tërësisht dhe ka pasur tendencë kohët e fundit që zhvillimi i këtij lloj arsimit të fokusohet vetëm në arsimin universitar dhe të përjashtojë pothuajse çdo formë tjetër'

128 Ligji për barazi gjinore nr. 2004/2, qershor 2004, Neni 13.6

129 Plani kombëtar i veprimit për arritjen e barazisë gjinore, Kapitulli III, pika 17 dhe 18, fq.7

130 Plani kombëtar i veprimit për arritjen e barazisë gjinore, Seksioni 10.1, 10.2, fq. 21-22

Resurset aktuale nuk mund të arrijnë të ndryshojnë nevojat e dala nga dekada të mungesës së investimeve në kapitalin njerëzor dhe zhvillimin e shkathtësive. Në vitin 2004 Kosova ka harxhuar vetëm 0.14 % të BPV në arsimin e të rriturve.¹³¹ Në fund të vitit 2006 MASHT ka pasur 224 punëtorë dhe një buxhet të aprovuar prej 33,850,156 EURO për vitin 2007.¹³² Një rritje prej 38.1 milionë Eurosh, siç është planifikuar për vitin 2008 ende e lë Kosovën me më pak se 20 Euro për kokë banori në arsim.¹³³ Sistemi i shkollimit ka po ashtu mungesë të fondeve dhe shkollat marrin vetëm 18 Euro për nxënës në vit për të mbuluar infrastrukturën dhe materialet për mësim.¹³⁴ Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka po ashtu mungesë fondesh. Me një buxhet vjetor prej 911,116 Euro për aftësimin profesional dhe ritrajnimit për punë, MPMS harxhon më pak se 3 Euro (€ 2.8 Euro) për të papunët e regjistruar.¹³⁵ Ndersa numri i të papunëve të regjistruar është rritur nga marsi 2004 deri në korrik 2007 për 43,078 apo 15 %, fondi për arsim dhe aftësim profesional është zvogëluar 12 %.¹³⁶ Në letër, rregullorja e UNMIK-ut 2002/24 e obligon Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale të hartojë politika aktive të tregut të punës, lidhshmëri mes punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe ofrim të aftësimeve profesionale. Në praktikë, në vitin 2006 vetëm 3,455 persona, më pak se 1% e të papunëve të regjistruar, kanë përfutur nga fondet publike të aftësimit profesional.¹³⁷

Kërkesat për përmirësim të punës nuk mund të mbulohen nga MPMS. Në tërë Kosovën ka pasur 454 të papunë për një vend pune në vitin 2006. Në shifra të përgjithshme, zyrat e punësimit publik kanë pasur kërkesa për 8,561 vende pune dhe kanë gjetur vende pune për 7,348 punëkërkues.¹³⁸ 73 për qind e punëkërkuesve që kanë gjetur punë përmes ndihmës së institucioneve publike ishin meshkuj, ndërsa femrat përbëjnë përafërsisht një të tretën e të punësuarve. Shumica e këtyre vendeve të punës i kanë marrë femrat me shkathtësi të lartë, çdo e katërta e të diplomuarave në shkollë të mesme kanë gjetur punë në krahasim me 0.4 % të femrave me mungesë të shkathtësive. Shumë më e madhe është nevoja për aftësime profesionale sesa ofrohen tani. Shumica e të papunëve të regjistruar janë pa shkathtësi dhe kualifikime. Nga 18,894 të papunë të regjistruar në komunën e Skënderajt, 11,667 janë të pakualifikuar, 3,453 kanë të kryer shkollën e mesme dhe 64 kanë kryer universitetin.¹³⁹ Femrat përsëri janë të në pozitë të disfavorshme; pesë herë më shumë meshkuj sesa femra marrin pjesë në programet e trajnimeve të mbajtura nga MPMS. Vetëm 18% të pjesëmarrësve janë femra.¹⁴⁰ Për shkak të mungesës së fondeve publike, aftësimi profesional dhe arsimi joformal varen shumë nga donatorët, por mezi ndahet 6% e asistencës së donatorëve për përkrahje sektorale të arsimit dhe punësimit.¹⁴¹

131 Integrimi me Evropën: strategjia për mësimin e të rriturve për Kosovën (2005-2015), Observimi i punësimit dhe shkathtësive në Kosovë, prill 2004

132 Qeveria e Kosovës, Buxheti 2007, fq.99

133 Duke e supozuar një popullatë rezidente prej 1.9 milion banorëve. Shpenzimet e projektit sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore, 12 shtator 2007

134 MASHT, MPBZHR, FAO 'Një strategji për arsimimin e popullsisë në viset rurale në Kosovë', 2004-2009, fq.7

135 Qeveria e Kosovës, Buxheti 2007, fq.103

136 Buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për arsimin profesional 2005-2006, MC fq. 72

137 MPMS, Departamenti për punë dhe punësim, 2006, fq.xvi

138 MPMS, Departamenti për punë dhe punësim, 2006, fq.17

139 Intervistë me Shukrije Mehmetin dhe Tafil Shatrin, Zyra për Punësim, Skenderaj

140 Aspektet gjinore, fq.15

141 UNICEF, Tabela 32, Kontributet e donatorëve sektoreve në Kosovë

Mungesa e përgjegjësisë politike po ashtu reflektohet edhe me mungesën e të dhënave. Nuk ka të dhëna për resurset njerëzore në nivel kombëtar. Udhëheqësi i njësisë përgjegjëse për Statistika të Arsimit në MASHT ka pranuar se nuk ka të dhëna për shkallë të analfabetizimit, vijim apo shkallë të braktisjes. Më tej, pas institutit për përgjigje, ai thotë: "Oh jo, ne nuk i kemi këto informata ... po, do të ishte mirë të kishim këto të dhëna në ministrinë tonë po nuk i kemi".¹⁴² Po ashtu, nuk ka sistem të përcjelljes së shkallës së braktisjes apo edhe të të diplomuarve të arsimit dhe aftësimit profesional që do të mundësonte një vlerësim të mirëfilltë për relevancën dhe kualitetin e trajnimeve të ofruara. Mungojnë të gjitha informatat elementare për nivelet e shkathtësive të punëtorëve në sektorin formal dhe informal, shkathtësitë e mundshme tek të papunët apo shkathtësitë e sektorit privat. Parashikimi i besueshëm i nevojave të shkathtësive dhe trendeve mbetet ende një detyrë e përealizueshme.

Të paarrtshme

Qendra e Aftësimeve Profesionale në Mitrovicë është katër kilometra jashtë qytetit, në rrugën prej Mitrovicë për në Mal të Zi. Qendra është ndërtuar në vitin 2000 nga fondet e marra nga Danimarka. Që nga viti 2003 është nën administrim të MPMS.

Qendra e Aftësimeve Profesionale në Mitrovicë është një ndërtësë në "ndërtim e sipër". Terasa para hyrjes, si dhe karriget e tavolinat e drurit që i shfrytëzojnë nxënësit gjatë pauzës së drekës në verë janë konstruktuar nga nxënësit e diplomuar në kursin e zdrukthtarisë. Punëtorët e zdrukthtarisë është e bashkëngjitur në ndërtesën kryesore dhe është e ndërtuar nga nxënësit e diplomuar në kursin e ndërtimtarisë. Në klasët e mbushura me makina të qepjes dhe me rafte të teshave; trajnerët e tekstitil qepin uniforma për nxënësit e tjerë. Klasat për kuzhinierë mbahen në kuzhinën pranë dhe në kohën e drekës pjesëmarrësit në trajnimet e tjera vijnë të provojnë ushqimin. Një dhomë me hapësirë të madhe përgjatë korridorit përdoret për kursin e zdrukthtarit; punëtorët e metalpunësve gjenden në katin e parë. Klasat për IT dhe administrim biznesi janë të pajisura me 10 kompjuterë modernë dhe një makinë faksi.

Ferdane Haxhimustafa, një grua energjike 35-vjeçare, e udhëheq qendrën. Çdo mëngjes në orën 8.00 Ferdanja takohet me stafin për të planifikuar punën në kurse. Kurset fillojnë në 8.30. Shumica e stafit është punësuar që nga viti 2000 dhe trajnuar nga Shkolla Daneze për Prodhim (Danish Production School), që fillimisht e ka udhëhequr punën në qendër. Diku prej vitit 2003 deri në gusht të vitit 2007, Qendra e Aftësimit Profesional në Mitrovicë ka mbajtur trajnime për 1,814 nxënës, përfshirë këtu edhe 515 femra (28%). Studentët mund të zgjedhin shtatë profile profesionale, përfshirë edhe kursin për kuzhinierë, prodhim tekstili, trajnim për kompjuterë, administrim biznesi, ndërtimtari, zdrukthtari dhe metalpunës.¹⁴³ Në ditët e punës, Qendra është përplot me nxënës.

142 Intervistë me Enver Mekollin, udhëheqës i Njësisë për Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim, pjesë e Divizionit për Planifikim dhe Analizë brenda MASHT, dhjetor 2007

143 Intervistë me Ferdane Haxhimustafën, drejtoreshë, Qendra Rajonale për Aftësim Profesional në Mitrovicë, 12 shtator 2007

Tabela 9: Qendra e Aftësimit Profesional në Mitrovicë¹⁴⁴

Viti	Meshkuj	Femra	Totali	Femra %
2003	106	24	130	18 %
2004	349	72	421	17 %
2005	412	126	538	23 %
2006	327	148	475	31 %
2007*	105	145	250	58 %
Total	1299	515	1,814	28 %

*Gusht 2007

Profilet profesionale janë zgjedhur nga gjithsej 23 profile profesionale të seleksionuara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, bazuar në nevojat e tregut të punës të nxjerra në vitin 2001. Profilet e tanishme janë kryesisht të orientuara kah profesionet e lidhura me ndërtimtari që reflektojnë nevojat e ekonomisë së pasluftës në Kosovë. Duke marrë parasysh ekonominë agrare të Kosovës, të befason fakti se asnjë nga prioritetet për trajnime nuk i përfshijnë trajnimet për prodhimet bujqësore, për zhvillimin rural, përveç një kursi për mirëmbajtjen e makinerisë së fermave.¹⁴⁵ As në qendrat e aftësimit në Prizren, Mitrovicë ose Prishtinë nuk ka trajnime specifike të fokusuara në nevojat e fermerëve apo gjenerimin e të ardhurave në pjesët rurale. Po ashtu, është befasuese që pas shtatë viteve të ndryshimeve të shpejta të ekonomisë nuk është bërë ndonjë rishikim i 23 profileve origjinale të zgjedhura në vitin 2001. Kështu që nuk ka pasur përpjekje për t'iu adaptuar nevojave që dalin nga sektori privat.¹⁴⁶

Seleksionimi i kurseve të aftësimit po ashtu nuk ka qenë i barabartë nga aspekti gjinor; 16 nga gjithsej 23 profile janë emëruar në favor të profileve tradicionale të meshkujve, që nuk konsiderohen të përshtatshme për punëkërkuueset femra. 'Profilet në qendrën tonë janë kryesisht për meshkuj, pra numri i femrave në trajnime është i ulët', e pranon Sinan Gashi, drejtor i QAP në Prizren.¹⁴⁷ Vetëm dy – një i tekstilit dhe një i administritës në zyrë konsiderohen profile të femrave, ndërsa gjashtë janë të përshtatshme për të dy gjinitë. Këto janë administrim biznesi, IT, dizajn grafik, kontabiliteti, vetëpunësimi dhe kuzhinieri.¹⁴⁸ Asnjë nga këto kurse nuk janë të dizajnuara për femrat e zonave rurale që kanë të kryer më pak se shkollën fillore apo pa përvojë paraprake të punës. Nuk është për t'u çuditur se më pak se çdo i pesti pjesëmarrës në Qendrën e Prizrenit është femër.

144 Intervistë me Ferdane Haximustafën, drejtoreshë, Qendra Rajonale për Aftësim Profesional në Mitrovicë, 1 2 shtator 2007

145 MEST, MAFRD, FAO, 'A Strategy for Education for Rural People in Kosovo', 2004-2009

146 Intervistë me Valli Corbanese, drejtor, Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Prishtinë

147 Intervistë me Sinan Gashin, drejtor, Qendra për Aftësim Profesional në Prizren

148 Gender dimension, fq.15

Të tetë qendrat profesionale të aftësimin janë të vendosura në qytete, në distancë të madhe nga vendet rurale ku gjenden shumica e të papunëve. Në të vërtetë, kurset e aftësimin profesional ofrohen pa pagesë, por nxënësit duhet të paguajnë transportin deri te qendrat. Distanca nga qendrat dhe harxhimet për transport janë një barrierë reale për pjesëmarrësit potencial nga zonat rurale, veçanërisht femrat. Shasivar Sadiku, drejtor i Qendrës Rajonale të Prishtinës, që mbulon 6 komuna, pranon se 'shumica e pjesëmarrësve në programet e trajnimit janë nga Prishtina'.¹⁴⁹ Komunitat si Podujeva, nga e cila duhet të udhëtohet për në Prishtinë, janë shumë të pafavorizuara. Vetëm 0.57 për qind të të papunëve në Podujevë kanë marrë pjesë në trajnimet e mbajtura në Prishtinë.

Po ashtu, vetëm 2.4% e pjesëmarrësve në trajnim në Qendrën e Prizrenit janë nga Rahoveci. Në Skënderaj, nga viti 2003 deri në gusht të vitit 2007, vetëm 107 persona kanë marrë pjesë në Mitrovicë. Më pak se 0.5% të 18,894 të papunëve të regjistruar në Skënderaj kanë përfituar nga këto trajnime.¹⁵⁰

Sejdi Behrami, 44 vjeçar, i cili ka migruar nga Gjermania, ka punuar në fabrikë për prodhimin e metalit me vite të tëra. Pas luftës, autoritetet gjermane e kanë detyruar familjen Behrami të kthehet në Kosovë. Sejdi Behrami është kthyer në fshatin e tij në Krasmirovc në Skënderaj, ku jeton me gruan dhe 5 fëmijët e tij me ndihma sociale. Në vitin 2007 Sejdi Behrami është regjistruar në kursin për prodhim të metalit në Qendrën e Aftësimeve Profesionale në Mitrovicë. Ai shpreson se do të marrë një certifikatë që të dëshmojë shkathtësitë e tij që i ka fituar në Gjermani. Të arrish nga Mitrovica në Krasmirovc është shumë vështirë. Sejdi duhet të ecë 40 minuta nga fshati i tij në fshatin më të afërm, Qirez, pastaj të marrë autobusin deri në Skënderaj, që kushton 1 Euro dhe pastaj përsëri autobusin për në Mitrovicë. Ai udhëton gati 4 orë deri në Mitrovicë. Pagesa për një biletë autobusi për të vijuar kursin tremujor është e njëjta shumë sa ndihma sociale e një muaji. Nëse Sejdi Behrami do të ishte femër, vijimi i këtij kursi do të ishte vetëm një ëndërr.¹⁵¹

Pagesa dhe vështirësitë për vijimin e këtij kursi u pamundësojnë femrave të zonave rurale të marrin pjesë, ato janë shumë më pak fleksibile dhe kanë më pak mundësi të lëvizjes sesa Sejdi Behrami. Në Rahovec, Skënderaj dhe Podujevë 17,427 femra janë të regjistruara si të papuna; kështu, femrat përbëjnë 47 % të të papunëve të regjistruar. Por, vetëm 65 femra, apo 0.37 për qind të femrave të papuna të regjistruara zyrtarisht kanë vijuar trajnimet gjatë shërbimit në një nga qendrat e aftësimin profesional në Prizren, Mitrovicë apo Prishtinë. Nga komuna e Rahovecit, gjithsej 14 femra, ndërsa nga komuna e Skënderajt vetëm 5 kanë vijuar kurset.¹⁵² Kjo shkallë e ulët e pjesëmarrjes në programet e aftësimeve profesionale, 18% në tërë Kosovën, del kryesisht nga komunitat ku gjenden qendrat e aftësimin profesional.

149 Intervistë me Shasivar Sadikun, drejtor, Qendra Rajonale për Trajnim Profesional, 31 korrik 2007

150 Intervistë me Shukrije Mehmetin, Zyra për Punësim në Skënderaj

151 Intervistë me Sejdi Behramin, QAP Mitrovicë, 2007

152 Intervistë me Ferdane Haximustafën, drejtoreshë, Qendra Rajonale për Aftësim Profesional në Mitrovicë, 12 shtator 2007

Tabela 10: Shkalla e pjesëmarrjes së femrave të regjistruara si të papunësuar në tri QAP

Komuna	# I të papunëve të regjistruar	# I femrave të papuna	% Femrave
Skenderaj ¹⁵³	18,894 (prill)	9,976	53 %
Rahovec ¹⁵⁴	6,883 (qershor)	3,227	47%
Podujevë ¹⁵⁵	10,419 (qershor)	4,224	40.5%
Totali	36,196	17427	46.8%

Femrat që nuk mund të angazhojnë dikë të kujdeset për fëmijët e tyre gjatë orëve të kursit, janë automatikisht të përjashtuara. Nuk ka çerdhe në fshatra apo edhe mundësi të paguajnë çerdhet në qytetin e Podujevës, Skënderajit apo Rahovecit, për shkak të çmimeve të larta. PAGESA mujore për një fëmijë në çerdhe sillet prej 25 deri në 30 Euro, një biletë kthyes nga cilido fshat në qytet me transportin publik kushton 1 Euro dhe mesatarisht 21 Euro në muaj. Pra, të dërgosh fëmijën në çerdhe të kushton 50 Euro në muaj.¹⁵⁶ Ka shumë pak familje që kanë këtë mundësi – në Skënderaj 60 fëmijë janë të regjistruar në çerdhe, në Podujevë 55 dhe në Rahovec vetëm 22.

Komuna	# trajnerëve	# Femra trajnere
Skënderaj ¹⁵⁷	107 ¹⁵⁸	5
Rahovec ¹⁵⁹	165 ¹⁶⁰	14
Podujevë ¹⁶¹	60 ¹⁶²	46
Gjithsej	332	65

Përveç harxhimeve për vijim të trajnimeve më larg se vendbanimi i tyre, shumë femra të zonave rurale nuk kanë dëgjuar kurrë për qendrat e trajnimeve profesionale të MPMS. Nexhmije Ismaili, një ish-mësuese e Programit të Shkrimit dhe Leximit Bazik në një lagje të Podujevës është regjistruar si e papunë. Ajo nuk ka qenë kurrë e informuar nga zyra e punësimit në komunë për këto trajnime në Qendrën e Aftësimeve Profesionale në Prishtinë.¹⁶³ Fixhrije Aliu, 38 vjeçare, ka mbaruar vetëm një muaj të shkollës fillore. Ajo tani jeton në fshatin Kerpimeh të Podujevës, me burrin, dy djem dhe prindërit e burrit. Ajo dëshiron të gjejë punë si rrobaqepëse apo në fabrikë, por nuk di se ku duhet të kërkojë punë. Ajo po ashtu kurrë nuk ka dëgjuar për kurse të trajnimit të ofruara nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).¹⁶⁴ Në të vërtetë, shumica e femrave të intervistuar nuk ka dëgjuar për kurset e ofruara në qendrat e trajnimeve profesionale të MPMS.

153 Intervistë me Shukrije Mehmetin, Zyra për Punësim në Skenderaj

154 Intervistë me Hilmiye Bugarin, drejtoresh në Zyrën për Punësim në Rahovec, qershor 2007

155 Intervistë me Idriz Hetemin dhe Arzije Poterën, Zyra për Punësim në Podujevë

156 Statistikat e arsimit shqip 2006-2007, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe bisedë telefonike me Taibe Nishevcin, drejtoreshë e çerdes në Podujevë dhe Jashar Lushtaku, drejtor i çerdes në Skenderaj.

157 Intervistë me Shukrije Mehmetin, Zyra për Punësim në Skenderaj

158 Intervistë me Ferdane Haximustafen, drejtoreshë, Qendra për Trajnim Profesional në Skenderaj, 12 Shtator 2007

159 Intervistë me Hilmiye Bugarin, drejtoreshë e Zyres për Punësim në Rahovec, qershor 2007

160 Intervistë me Sinan Gashin, drejtor i Qendres Rajonale për Trajnim Profesional, Prizren

161 Intervistë me Idriz Hetemin dhe Arzije Poterën, Zyra për Punësim në Podujevë

162 Intervistë me Shpetim Kalludra, shef, Sektori i Punës dhe Analizave të Tregut, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 12 shtator 2007

163 Intervistë me Nexhmije Ismailin, ish-trajnere e shkrimit dhe leximit bazik në Lagjen e Kuvajtit, Podujevë

164 Intervistë me Fixhrije Aliun, fshati Kerpimeh, Podujevë

Këtë e ka konfirmuar edhe Avdullah Jasiçi, trajner në QAP në Prishtinë, i cili ka thënë për IKS se 'shumica e pjesëmarrëve në kurse janë befasuar kur kanë kuptuar sa kurse ofrohen në qendrën tonë, falas'.¹⁶⁵

Përgjegjësia për të informuar dhe për të përfshirë të papunët e zonave rurale u mbetet kryesisht zyrtarëve të punësimit në komunë. Për të pasur të drejtë të marrësh pjesë në trajnime në një nga 8 QAP-të, fillimisht duhet të shkohet në zyrat komunale të punësimit. Në bazë të së ashtuquajturës 'Kartela e punëkërkuarit', këshilltarët e punësimit harmonizojnë nevojat e kandidatëve me kurset që ofrohen.

Sidoqoftë, zyrat komunale të punësimit në Kosovë kanë mungesë të stafit dhe resurseve.

Sipas stafit të vjetër të ILO-së, nën presionin e bërë nga IMF, shumë vende pune janë eliminuar, si ai i sekretarit dhe koordinitorit të trajnimeve. Si pasojë, këshilltarët e punësimit tani kanë më pak kohë të merren me harmonizimin e kandidatëve potencial dhe konkurset dhe të bëjnë këshillime dhe orientime në karrierë.¹⁶⁶ Mesatarisht, një zyrtarë punësimi është përgjegjës për 1,638 të papunë në krahasim me mesataren në BE, që është një zyrtar për 149 të papunë.¹⁶⁷

# trajnerë	# stafit	shkalla e stafit/
Skënderaj ¹⁶⁸	4	1:4724
Rahovec ¹⁶⁹	3	1:2294
Podujevë ¹⁷⁰	3	1:3473

Katër zyrtarët në zyrën e punësimit në Skënderaj kanë përgjegjësi të merren me 4,724 të papunë të regjistruar. Atyre iu mbetet pak kohë për aktivitete konkrete për përfshirje të të papunëve apo fushata për ngritjen e vetëdijes që promovojnë mundësitë e trajnimit në fshatrat e largëta. Bashkëpunimi i rregullt me 841 biznese të regjistruara në komunë është detyrë e rëndë për komunën e Skënderajt, e shtrirë në më se 37,440 hektarë të kodrave të ashpra që arrijnë lartësinë deri në 1,080 metra (Mali i Qyqavicës). Shumica e 52 fshatrave janë të lidhura me rrugë të paasfaltuara, që janë të pakalueshme në kohën e dimrit. Pa ndonjë mjet transporti personal, ekipi prej katër anëtarësh e ka shumë të vështirë të mbajë kontakte me bizneset lokale dhe të identifikojë konkurset potenciale. Prej janarit e deri në korrik 2007 të këtij viti, zyrtarja për punësim Shukrije Mehmeti ka mundur të vizitojë 77 kompani në Skënderaj. Në tremujorin e parë të këtij viti, Zyra ka gjetur punëtorë për 4 konkurse në Qendrën Tregtare dhe në restorantin fast food 'Ben-Af' si dhe në fabrikën e blloqeve 'Geci', të privatizuar në prill të vitit 2005 dhe ka punësuar 13 punëtorë sezonal.¹⁷¹ Por, këto 17 vende të punës janë një pikë uji në det, duke marrë parasysh sa e madhe është sfida e punësimit.

165 Intervistë me Avdullah Jasiçin, trajner në Qendrën për Trajnim Profesional në Prishtinë

166 Intervistë me Vali Corbanese, drejtor i Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) Prishtinë, 26 qershor 2007

167 MLSW 'Labour and Employment', Annual Report 2006, fq. 13

168 Intervistë me Shukrije Mehmetin dhe Tafil Shatrin, Zyra për Punësim, Skenderaj

169 Intervistë me Hilmije Bugarin, drejtoreshë e Zyres për Punësim, Rahovec

170 Intervistë me Idriz Hetemin, drejtor i Zyres për Punësim, Podujeve, 5 korrik 2007

171 Intervistë me Shukrije Mehmetin dhe Tafil Shatrin, këshilltarë për punësim, Zyra për Punësim, Skenderaj

Është e qartë se qendrat publike të aftësimeve profesionale i favorizojnë punëkërkesit më të shkolluar; 55 % të pjesëmarrësve në kurset e trajnimeve të MPMS kanë kryer shkollën e mesme. Vetëm 30% e pjesëmarrësve janë meshkuj të pakualifikuar apo gjysmë të kualifikuar. Femrat e pakualifikuara, përfshirë edhe femrat të cilat vijnë në programin SHLB janë kryesisht të pafavorizuara. Shkalla e pjesëmarrjes së fermave të pakualifikuara në aftësimet profesionale publike është vetëm 2% në krahasim me 70% të pjesëmarrësve të cilët kanë kryer shkollimin e mesëm.¹⁷² Meqë janë 155,373 femra të regjistruara si të papunë, më se dy të tretat janë të pakualifikuara, apo me kualifikim të ulët, në krahasim me një të pestat me shkollim të mesëm, pra femrat e pakualifikuara janë shumë të pafavorizuara.¹⁷³

Tabela 11: Shkalla e arritshmërisë së të papunëve të regjistruar¹⁷⁴

Shkalla e arritshmërisë	Gjithsej	femra	% femra/gjithsej femra
≤ të pakualifikuara/ gjysmë të kualifikuara	212,397	117,512	75.6 %
Të kualifikuara	29,679	4,506	2.9 %
≥ Shkolla e mesme	90,773	33,355	21.5 %
Gjithsej	332,849	155,373	100 %

Analfabetizmi funksional dhe mungesa e certifikatave zyrtare të shkollës fillore te femrat e zonave rurale është një nga pengesat kryesore për të marrë pjesë në arsimin dhe aftësimin e të rriturve. Asnjë nga kurset e ofruara në qendrat e trajnimit në Prishtinë, Mitrovicë apo Prizren nuk i përfshin femrat me aftësi të kufizuara në shkrim dhe lexim. Nëntëmbëdhjetë profilet profesionale në tri qendrat rajonale kërkojnë kandidatë që së paku dinë shkrim dhe lexim bazik.¹⁷⁵ Një kuzhinier duhet të dijë të lexojë recetat dhe të masë përmbajtësit për zierje, një sekretarëshë duhet të dijë të identifikojë dokumentet sipas titullit apo edhe t'i perpiltojë ato. Një rrobaqepës duhet të dijë të masë, të blejë materialin apo edhe të shkruajë fatura. Xhanije Berisha, trajnere për kuzhinierë në Prishtinë, kujton rastin kur një vajzë e re nuk mund të shkruante e të lexonte. Pa ndihmën e saj për të lexuar e shkruar gjatë trajnimit, ajo nuk do të mbetej në kurs.¹⁷⁶ Ka shumë femra të tilla që kanë nevojë për një trajnim të veçantë paraprofesional apo klasë përgatitore.

Qendrat private të arsimit profesional që operojnë me ndihmën e OJQ-ve ndërkombëtare apo edhe organizatave qeveritare janë në përgjithësi më të orientuara nga femrat gjysmë të kualifikuara apo të pakualifikuara, përfshirë edhe të zonave rurale. Në vitin 2003, 41% të fermave janë përfshirë në institucionet publike dhe private.¹⁷⁷ Në komunën e Skënderajit, për shembull,

172 MPMS, Zyra për Punësim, dhjetor 2003

173 Numri i fermave të pakualifikuara dhe gjysmë të kualifikuara në dhjetor 2006 ishte 117,512 femra, apo 76% e të gjithë fermave të regjistruara si të papuna

174 Informata për tregun e punës në Kosovë, korrik 2007, MPMS

175 QAP në Prizren ofron kurset si autoelektrik, hidraulik, dhe pneumatik, elektronikë industriale, metal-punues, riparimi i pajisjeve shtëpiake, administrim biznesi, vetëpunësim, kuzhinier, kamerier, prodhimtari e qumështit, dhe shkathtësitë bazike kompjuterike. QAP në Mitrovicë ofron metalpunues, administrim biznesi, kuzhinier, trajnim bazik për kompjuterë, ndërtimtari, zdrukthtari dhe tekstil. QAP në Prishtinë ofron punë në zyrë, riparim i pajisjeve për zyrë, bukëpjekës, kurse të IT-së dhe elektronikës industriale, pastiçeri, vetëpunëim dhe administrim biznesi.

176 Intervistë me Xhanije Berishën, trajnere në Qendrën Për Trajnim Profesional, Prishtinë

177 Aspektet gjinore, fq.15

një mori organizatash ndërkombëtare, përfshirë ILO, IOM dhe një organizatë e financuar nga arabët e quajtur 'Katari', ka ofruar kurse të trajnimeve profesionale. Prej vitit 2000 deri më 2003, përafërsisht 230 femra kanë marrë pjesë në kursin e rrobaqepësisë, gjuhës angleze apo kompjuterëve, por edhe në trajnimet për karrierë dhe planifikim biznesi apo ritrajnim për infermiere.¹⁷⁸ Por, pa akreditimin zyrtar këto kurse mbesin një mundësi e kotë.

Rast studimi: Hareja dhe Gratë Fermere

OJQ-ja në Rahovec, e quajtur "Hareja", është themeluar në qershor të vitit 2000 nga tri femra: Sahadete Dula, Muradije Shehu dhe Nusrete Sokoli. Qëllimi i OJQ-së Hareja është të fuqizojë femrat dhe t'i edukojë e stimulojë fëmijët përmes kurseve dhe aktiviteteve në bashkëpunim me institucionet lokale dhe qendrore si dhe OJQ-të tjera. Hareja, si çdo OJQ tipike kosovare, ka punuar me një mori donatorësh, përfshirë UNICEF, OSBE, CARITAS si dhe donatorët tjerë bilateral si SIDA, Zyra Gjermane dhe Zyra Amerikane. Pas viteve të punës, Hareja është rritur dhe është popullarizuar si qendër për femrat e të gjitha moshave dhe etniciteteve në komunën e Rahovecit, si nga aspekti i të mësuarit ashtu edhe socializimit.

Në portfolion e tyre ka projekte të ambulancës gjinekologjike me një mjek dhe dy asistente, që ofrojnë këshillime dhe trajnime për afro 80 femra në muaj; kurset e ndryshme të floktarisë, rrobaqepësisë, aerobikut, kompjuterëve dhe gjuhës angleze, një radio show javor të quajtur Zëri i Femrave që adresojnë çështjet nga shëndeti e deri te politika dhe të drejtat e femrave; dhe një punëtori qilimash, ku 16 femra mësohen të prodhojnë dhe shesin qilimët e tyre. Deri tani, më shumë se 500 femra në komunë janë trajnuar dhe kanë marrë certifikata nga Hareja.

Projekti i fundit nga Hareja "Bujqësia e favorshme për ambient dhe marketingu në Kosovë" adresojnë nevojat kryesore të femrave të zonave rurale dhe kanë për qëllim të shtojnë rrogat e femrave fermere, të forcojnë rolin dhe njohuritë e tyre në bujqësi dhe marketing. Në dy vitet e fundit, Hareja ka trajnuar 30 femra "aktiviste" të etniciteteve të ndryshme nga qyteti i Rahovecit dhe 15 fshatra¹⁷⁹, si pjesë të programit trajnimi i trajnerëve me qëllim që të sigurojnë trajnime edhe për 360 femra të tjera. Janë seleksionuar katërmëdhjetë module të projektit të dizajnuara, ashtu që të plotësojnë nevojat dhe shkathtësitë e grave që janë lidhur për shtëpitë dhe punët e fermës. Në 326 orë të trajnimit, femrat mbulojnë tema prej analizave të nevojave të fshatit deri te teknikat e

178 Strategjia komunale për zhvillim, 2005-2010, Zyra për Punësim në Skenderaj, fq.15

179 Apterushë, Fortesë, Nagavc, Hoça e Madhe, Hoça e Vogël, Celinë, Ratkovc, Krusha e Madhe, Qiflak, Denj, Rugovë, Xërxë, Zoqishtë, Polluzhë dhe Drenovc

mbjelljes, serrat, ujitja dhe fertilizimi, si dhe planifikimi i bizneseve dhe marketingu. Teoria është e kombinuar me praktikën – vepra e mëso.

Disa nga aktivitetet dhe femrat e OJQ-së Hareja që kanë marrë pjesë në trajnime kanë formuar një asociacion të ri të quajtur Gratë Fermere. Si përgjigje ndaj nevojave të mëdha, Gratë Fermere janë fokusuar në prodhimin dhe konservimin e perimeve, veçanërisht specave. Gratë kanë mbledhur frutet e punës së tyre menjëherë; sipas Muradije Shehut, tanimë ka nevoja të mëdha në treg për perimet e konservuara-turshi. Me ndihmën e asociacionit Gratë Fermere kanë hapur kanalet e shitjes dhe mund të shesin perime direkt në supermarketet si Albi, BenAf dhe Maxi. Vetëm për tre muaj, një grup prej 5 femrave nga fshati i Krushës kanë siguruar 5,000 kg të perimeve turshi, duke nxjerrë një profit prej 1,000 euro për secilën. Këto femra tani janë në pozitë të fitojnë një rrogë më shumë, duke punuar prej shtëpisë. Për t'iu përgjigjur nevojave të mëdha, Grate Fermere planifikojnë të lidhin kontratat me supermarkete dhe 10 grupeve të tjera të femrave. Hareja është një rast studimi interesant i një institucioni të vogël lokal, që u mundëson femrave të zonave rurale të zhvillojnë shkathësitë e marketingut dhe mundësitë për përfitime materiale.

Ligji për Arsimin dhe Aftësimin Profesional parasheh që të gjitha institucionet e arsimit profesional, publike ose private, të licencohen nga MASHT, kurrikula të aprovohet nga MASHT dhe certifikimi të bëhet duke u bazuar në Ligjin për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.¹⁸⁰ Ligji po ashtu parasheh krijimin e Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional (KAAP), që do të themelohet me mbikëqyrjen e MASHT për të këshilluar qeverinë për politikën e arsimit dhe aftësimin profesional.¹⁸¹ Në praktikë, sidoqoftë, ky ligj mbetet në letër të vdekur. Asnjë nga kurset e aftësimin profesional të OJQ-ve dhe aktorëve të tjerë nuk akreditohen dhe certifikohen zyrtarisht. Programi i Leximit dhe Shkrimit Bazik i Dritare Jete, edhe pse nën mbikëqyrjen direkte të MASHT-it, nuk është licencuar zyrtarisht. MASHT-i nuk ka aprovuar ende ndonjë plan-program për trajnime të reja. Këshilli për Arsimin dhe Aftësimin Profesional ka ngecur ende në të ashtuquajturën 'fazë e të mësuarit' dhe përveç disa mbledhjeve joformale nuk ka qenë operativ. Ende nuk ka pasur rishikim të nevojave të arsimit profesional dhe asnjë progress në licencimin e ofruesve të trajnimeve profesionale.

180 Ligji për arsimimin profesional dhe trajnimin, Ligji nr. 02/L-42, nenet 5.2, 9.1, 11.1.

181 Ligji për arsimimin profesional dhe trajnimin, Ligji nr. 02/L-42, nenet 13.1, 13.1, 15.1 dhe 15.3.

Duhet të hulumtohet urgjentisht opcioni për partneritet të trajnimeve private dhe publike, që është në interes të femrave nxënëse. Është urgjent edhe licencimi i programeve zyrtare si 'Dritare Jete' nga MASHT.

Çështja kryesore që mungon për fuqizimin dhe punësimin e femrave është ofrimi i arsimit adekuat kompensues pa pagesë për të gjitha femrat që nuk e kanë kryer arsimin e obliguar.

"Gjeneratës së humbur" nga e kaluara, atyre që kanë braktisur shkollimin gjatë 1990 dhe "gjeneratës së humbur" të ditëve të sotme, të gjitha grave dhe vajzave të cilat nuk mund të vazhdojnë shkollimin apo që janë detyruar të ndalojnë shkollimin si rezultat i presionit të familjes, i paragjy-kimeve dhe diskriminimit, duhet t'u jepet një mundësi e dytë. Në një sistem modern të arsimit, barrierat mes arsimit dhe aftësimin formal dhe mësimin joformal dhe informal, duhet të tejkalohen. I tërë të mësuarit duhet të njihet dhe të transferohet për t'iu shmangur mospërfundimit të procesit të të mësuarit. MASHT-i, në partneritet me komunat, duhet të arrijnë në zgjidhje praktike për të zhvilluar programin Dritare Jete për femra, si mënyrë për të përfunduar arsimin fillor. Pa njohjen e certifikatave të shkollës fillore, femrat nuk kanë mundësi të marrin pjesë në programet aktuale të trajnimeve apo skemave të punësimin. **Punësimi mbetet një ëndërr e porealizuar pa certifikata të shkollës fillore.**

Shembulli 1:

Që nga viti 2003, në Prishtinë është hapur qendra edukativo-sociale Don Bosko, një projekt i përbashkët i përkrahur nga International Salesian Congregation. Qendra të tilla të ngjashme ekzistojnë në më se 130 vende në tërë botën. E vendosur në mes të Prishtinës dhe Fushë-Kosovës, kjo qendër moderne përfshin një bibliotekë, dhomë për aktivitete sociale dhe kulturore dhe një fushë sporti. Qendra Don Bosko vepron si qendër për aftësim profesional, një shkollë e mesme për elektrotekninë dhe qendër të të rinjve. Qendra për aftësim profesional ka synim grupin e të rinjve, të papunët gjysmë të kualifikuar dhe posaçërisht personat që kanë braktisur shkollën.¹⁸² Sipas Anton Gojanit, kryekoordinator në qendrën Don Bosko, parakusht për vijim në çdo kurs në Qendër janë shkathtësitë dhe aftësitë e leximit dhe shkrimit bazik.¹⁸³ Femrat të cilat e kanë përfunduar me sukses Programin e shkrimit dhe leximit bazik, por nuk kanë kualifikim të mirëfilltë të arsimit fillor, nuk mund të regjistrohen në programet e trajnimit në Don Bosko.

182 Për momentin, Qendra ofron trajnime në pesë fusha, duke përfshirë elektroteknikë, IT dhe web dizajn, kontabilitet dhe financa, trajnime profesionale për punë administrative dhe në shitje, si dhe trajnime për gjuhë. Duke filluar nga viti 2008 Qendra do të ofrojë kurse në saldimitin e hekurit, termohidraulikë, dhe procesim të pemëve dhe perimeve. Të gjitha këto kurse do të përbëhen nga 350 orë brenda 4 muajve.

183 Intervistë me Anton Gojanin, koordinator në Don Bosko, Qendra Edukative dhe Sociale, Prishtinë

Shembulli 2:

Në vitin 2005, divizioni i sapoformuar i Aftësimin Profesional në MASHT ka iniciuar arsimin joformal profesional në shkollat e mesme në tërë Kosovën.¹⁸⁴ Grupet e synuara në këtë program janë ata që kanë braktisur shkollën në vitin 1990, migrantët e kthyer dhe ata që kanë fituar shkathtësi profesionale në punë, por që nuk u janë njohur zyrtarisht. Sistemi është dizajnuar të jetë më i shpejtë, që të përfundojnë dy vjet të shkollimit të rregullt brenda një viti kalendarik.

Rezultatet e pilot-projektit ndryshojnë sipas komunave. Në shkollën e mesme Xhelal Hajda-Toni në Rahovec, për shembull, projekti ka dështuar.¹⁸⁵ Shumica e studentëve kanë braktisur programin kur kanë kuptuar se duhet të paguajnë 150 Euro për një vit kalendarik. Prej 22 studentëve, përfshirë 14 femra, vetëm 8 kanë paguar çmimin e vijimit dhe kanë marrë certifikatën.¹⁸⁶ Interesimi filloi të zvogëlohet shpejt dhe në vitin 2007 i tërë programi stagnoi. Në shkollën Fan Noli në Podujevë, programi filloi në vitin 2006 me 16 aplikantë të specializuar në riparimin e pajisjeve për zyrë. Aplikantët ishin 100 % meshkuj. Në ndërkohë, në shkollën Isa Boletini në Podujevë, klasa e parë me 48 studentë ka diplomuar pas përfundimit të suksesshëm të vitit të dytë të arsimit joformal në sistemin bankar, kontabilitet apo doganë dhe logjistikë. Programi vazhdon me 156 studentë që kanë vijuar kurset në administrim biznesi dhe praktikë juridike. Orët e mësimin organizohen gjatë vikendeve dhe kohës së dimrit. Shumica e mësimdhënësve janë mësimdhënës të rregullt të shkollës së mesme dhe pagohen 2 Euro për një orë mësimi.

Mungesa e materialeve dhe teksteve është një problem serioz që duhet të zgjidhet nga MASHT-i; plan-programi dhe materiali për mësimdhënie i shumicës së profileve profesionale është i vjetruar apo mungon në tërësi. Në Rahovec, për shkak të mungesës së materialeve të mësimdhënies, mësimdhënësit e ekonomisë duhet të diktojnë përmbledhjen dhe pjesë të teksteve të universitetit.¹⁸⁷ Në Podujevë, të vetmet materiale të përdorshme janë shënimet në klasë. Sidoqoftë, në Isa Boletini interesimi është më i madh sesa çfarë ofrohet. Sipas drejtorit të shkollës, 'për shkak të kapaciteteve të kufizuara, shkollat në Podujevë nuk mund të absorbojnë të gjithë të rinjtë të cilët duan të vazhdojnë shkollimin'.¹⁸⁸ Për femrat pa certifikata të shkollës fillore, aplikimi nuk mbetet fare opion.

184 Intervistë me Ajshe Balajn, Qendra Rajonale për Arsim Profesional, MASHT, Prishtinë

185 Me dy shkolla paralele të ndara në Ratkoc dhe Krushë të Madhe, shkolla punëson gjithsej 98 punëtorë, duke përfshirë 11 mësuese femra dhe 1 femër si staf administrativ.

186 Intervistë me Sadik Deliun, sekretar në shkollën e mesme Xhelal Hajda, Rahovec

187 Intervistë me Sadik Deliun, sekretar i shkollës së mesme Xhelal Hajda Toni, Rahovec

188 Intervistë me Ilmije Cakiqin- Ganiu, drejtoreshë e shkollës së mesme profesionale 'Isa Boletini', Podujevë

Shembulli 3:

UNDP në mars të vitit 2007 ka lancuar një skemë të punësimit, që synonte punësimin e femrave, të pakicave dhe personave me aftësi të kufizuara. Programi i UNDP përmban trajnimin e parapunësimit dhe punësimit, një skemë të punësimit me grante dhe programe praktike.¹⁸⁹ Në Skënderaj, skema e financuar nga UNDP synon të sigurojë mundësi punësimi për 19 të papunësuar, përfshirë 10 femra.¹⁹⁰ Nëntë kompanitë pjesëmarrëse të kësaj skeme përfaqësojnë një qasje tipike sektoriale të sektorit privat në Skënderaj. Ato përfshijnë 3 restorante, 2 shitore të rrobaqepësve, një mekanik, një sallon floktarie, një zyrë avokature dhe një minierë gurësh.¹⁹¹ Deri në vitin 2007, të gjitha 9 pozitat për meshkuj ishin marrë, ndërsa 5 nga 10 pozitat e rezervuara për femra mbeten të zbrazëta. Programi i UNDP-së, jo vetëm që nuk i sfidoi stereotipet aktuale, por i konfirmoi ato. Pesë femrat që janë punësuar përkohësisht janë në 3 profesionet më të zakonshme: kuzhinieri, rrobaqepëse dhe frizere. Natyrisht se kjo nuk është për t'u befasuar, meqë shumica e zyrtarëve dhe trajnerëve në zyrat komunale dhe rajonale të punësimit janë meshkuj dhe nuk kanë vetëdije të lartë për pozitën e femrave.¹⁹² Femrat, në përgjithësi "këshillohen" të ndjekin profesionet tradicionale të femrave, që rezultojnë me mundësi me pagesa minimale dhe perspektiva të kufizuara të karrierës. Për t'u regjistruar në një nga katër komponentët e programit të UNDP-së, të gjithë kandidatët duhet të kenë përfunduar së paku shkollën fillore.¹⁹³ Kjo automatikisht përjashton shumicën e femrave që marrin pjesë në Programin e Shkrimit dhe Leximit Bazik të UNICEF-it, por që nuk kanë marrë certifikatën ekuivalente të shkollës fillore.

189 Si pjesë e trajnimit në punë tremujore, UNDP paguan një shumë fikse prej 50 Eurove punëdhënësit dhe 100 Eurove punëtorit. Në këtë skemë të subvencionimit të punësimit, UNDP paguan një pagë të subvencionuar prej 100 Eurove për një periudhë prej gjashtë muajsh. Ky është zhvillim i një programi të punësimit të të rinjve nga viti 2004, që ishte implementuar në partneritet me MPMS dhe ILO, dhe ka përfshirë rreth 4,000 individë.

190 Intervistë me Tafil Shatrin, këshilltar Punësimi në Zyrën e Punësimit, Skënderaj

191 Intervistë me Tafil Shatrin, këshilltar Punësimi dhe koordinator i UNDP në Skënderaj. Shtatë bizneset e përfshira në skemën e UNDP janë; Hysi Commerce, Valentina dhe Hollyëood, si dhe Dona dhe Fedra Ekos, Besniku dhe Vanesa, Kushtrimi dhe Zyra e avokaturës.

192 The Prishtina and Mitrovica Vocational Training Centers has 4 and 2 female trainers respectively, Prizren none.

193 Për programin e internshipit, kandidatët duhet ta kenë përfunduar edhe shkollimin terciar





KAPITULLI V: MUNDËSIA E DYTË

Në vitin 2002, UNICEFi ka lancuar një program për shkrim dhe lexim bazik në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Programi njihet me emrin 'Dritare Jete'. Projekti u financua nga Banka Botërore, me qëllim që të luftojë analfabetizmin e femrave dhe të përmirësojë shkollimin e hershëm. Duke parë rëndësinë e femrave si edukatore apo si shembuj të mirë, shkrimi dhe leximi bazik dhe aftësitë e jetës ishin qenësore për këtë program.

Në fazën fillestare, programi implementohej në partneritet me KFOS, me OJQ-në ndërkombëtare Every Child dhe një rrjet të 21 OJQ-ve në tërë Kosovën. Në dy vitet e para, programi ka pasur afro 1,500 femra nxënëse nga 15 komuna nga tërë Kosova. Në vitin 2003, MASHT-i ka marrë përgjegjësinë për realizimin e programit nga UNICEF.¹⁹⁴ Programi u vazhdua nga i njëjti rrjet i OJQ-ve në 130 qendra dhe në fund të vitit 2004 përfshiu 2,500 gra dhe vajza. Deri më sot, është programi më i madh i implementuar në Kosovë pas luftës.

Për shumë femra rurale ky program ka qenë një mundësi e re për të vazhduar shkollimin. Pjesëmarrëset, nga 13 deri në 60-vjeçare, kanë qenë femra të reja pa njohuri paraprake, ato që kanë lënë shkollimin, si dhe ato që kanë përfunduar shkollimin fillor, por donin të shtojnë mundësitë e punësimit. Në Skënderaj, Podujevë dhe Rahovec 211 femra kanë marrë pjesë në Programin për Lexim dhe Shkrim Bazik.¹⁹⁵

Remzije Sejdiu, nga fshati Dobërdol i Podujevës, ka vijuar kursin në moshën 28-vjeçare. Pasi që ka ndërprerë shkollimin, e detyruar nga familja, ajo është munduar ta mësojë shkrimin dhe leximin me vite të tëra. Për të, Programi ishte një mundësi jetësore dhe menjëherë e shfrytëzoi mundësinë me entuziazëm. Naile Gashi, mësuesja e saj në programin 'Dritare Jete', u befusua nga progresi i saj. Ajo i tha IKS-it 'Unë nuk kam besuar se ajo nuk ka kryer asnjë klasë, ajo ka përparuar shumë dhe është shumë e interesuar të mësojë më shumë. Kur Remzija e pa bibliotekën e burrit tim, më pyeti nëse mund të marrë ndonjë libër ta lexojë. Kjo ishte një kënaqësi.'¹⁹⁶ Sot, Remzija punon në restorantin e familjes në Prishtinë.

Për Hamide Hotin, një femër gazmore 50-vjeçare nga fshati Revuçë i Podujevës, Programi i Shkrimit dhe Leximit Bazik ishte një ëndërr që u bë realitet. 'Unë gjithmonë kam dëshiruar të mësoj të lexoj dhe shkruaj, edhe kur kam qenë e re. Gjithmonë kam shpresuar se nuk vdes pa ditur si të lexoj dhe shkruaj', i thotë ajo IKS-it. Kur e kuptoi se ofrohet ky kurs në Revuçë, Hamidja ishte duke jetuar në Prishtinë derisa rindërtonin shtëpinë e saj të djegur. Ajo punonte si rrobaqepëse në atë kohë, por meqë dontë të vijonte kursin, ajo udhëtonte dy

194 Intervistë me Aferdita Jahën, Sektori i arsimit joformal, MASHT, 6 gusht 2007

195 Informata nga Aferdita Jaha, Sektori i arsimit joformal, MASHT, 6 gusht 2007 (Numri total i femrave të regjistruara në fillim në tri komunat ishte 211)

196 Intervistë me Naile Gashin, trajnere e shkrimit dhe leximit bazik në Dobërdol, Podujevë, 15 gusht 2007

herë në javë nga Prishtina në Revuçë. 'Unë isha shumë e hidhëruar kur nuk mund të vijoja një orë mësimi', thoshte ajo duke buzëqeshur. Burri i saj, duke parë entuziazmin e saj, po ashtu i tha IKS-it: 'Sa herë që vinte në shtëpi pas kursit, ajo menjëherë fillonte t'i bëjë detyrat e shtëpisë dhe na luste t'ia kontrollojmë dhe të mësojme me të'.¹⁹⁷

Për shumë femra, ky program ishte mundësi e mirë për t'u socializuar jashtë shtëpisë dhe për të ndarë hidhërimin. Lagja e Kuvajtit është një lagje në Podujevë e ndërtuar nga organizata bamirëse arabe për rastet sociale dhe viktimat e luftës. 128 familje jetojnë në kontejnerë, përfshirë edhe 33 familje që mbahen nga femrat të cilave u kanë vdekur burrat në luftë. Razije Maliqi, një nga trajnerët e shkrimit dhe leximit bazik, është 29 vjeçare. Djali i saj ishte 7 muaj kur i vdiq babai në luftë. Ajo tani jeton me djalin e saj në një kontejner dydhomësh në Lagjen e Kuvajtit. Pasi që ka mbaruar fakultetin e mësuesisë në vitin 2004, ajo punon si mësuese në shkollën vendore të quajtur "Martirët Kombëtarë". Sot, së bashku me një trajnerë tjetër të shkrimit dhe leximit bazik, Razija ka mësuar grupin e 13 femrave, duke përfshirë 4 femra të cilat ishin analfabete dhe të tjerat që kishin 3-4 vjet të arsimit fillor. 'Shumë femra vijnë këtu për të ndarë dhimbjen dhe vështirësitë me njëra-tjetrën', shpjegon Razija. 'Ne kemi diskutuar çdo gjë, problemet tona, shëndetin, vështirësitë, kemi qeshur, kemi biseduar si të kujdesemi për fëmijët dhe si të mirremi me institucionet shtetërore,' kujtohet kolegja e saj, Nexhmije Ismaili. Dymbëdhjetë femra kanë përfunduar katër nivele të programit Dritare Jete.¹⁹⁸

Duke iu shmangur qasjes tradicionale të mësimdhënies në Qendër dhe duke theksuar komunikimin dhe bashkëveprimin gjatë mësimdhënies, programi Dritare Jete ka sjellë mënyra inovative të mësimdhënies dhe mësimi në Kosovë. Po ashtu ka ndihmuar me trajnimin e një kuadri të mësimdhënësive me përvojë në shkrimin dhe leximin bazik në 15 komuna. Ky program ka vënë bazën për fushatën e shkrim-leximit dhe arsimimit të të rriturve, duke përfshirë më se 3,000 nxënësive femra nga komunitetet e largëta, autoritetet lokale e OJQ-të. Por, për të arritur sukses, disa çështje duhet të adresohen.

Topi tani është në fushën e MASHT-it; si shenjë përkushtimi për arsimin e të rriturve dhe mundësive të barabarta, MASHTi duhet ta bëjë këtë program pjesë qendrore të Sistemit të Arsimit dhe Trajnimit të të Rriturve në Kosovë. Qeveria ua ka borxh këtë mijëra femrave në tërë Kosovën, të cilat kanë filluar arsimimin e tyre joformal, që t'u ofrojë një 'mundësi të dytë'. Në nëntor të vitit 2006, nxënëset e këtij programi hynë në provim për të testuar rezultatet e arritshmërisë së programit me ato të klasës 1-4 të arsimit fillor.¹⁹⁹ Në vend të vlerësimit formativ, femrat kanë prezentuar portfoliot me ese, aftësi elementare të dijes dhe matematikës, dhe simulime të situatave reale në jetë, ku kërkohen shkrimi dhe leximi bazik. Ky portfolio i vlerësimit tregon një lëvizje të madhe nga qasja tradicionale, ku vlerësohet të mësuarit përmes viteve të vijimit dhe rezultateve përfundimtare, ku nxënësit duhet të demonstrojnë që e kanë arritur një shkathtësi apo kompetencë²⁰⁰.

197 Intervistë me Hamide Hotin, pjesëmarrëse e Programit, Revuçë/Kërpimeh (Podujevë), 21 gusht 2007

198 Intervistë me Razije Maliqin dhe Nexhmije Ismajlin, mësuese e Programit, Lagja e Kuvajtit, Podujevë, 14 gusht 2007

199 Intervistë me Afërdita Jahën, Sektori i arsimit joformal, MASHT, gusht 2007

200 Standardet specifikojnë çfarë pritet nga një i rritur në shkrim dhe lexim bazik (shkathtësitë përfshijnë bisedimin dhe dëgjimin, leximin, shkrimin) dhe matematikë bazike (shkathtësitë përfshijnë kuptimin dhe përdorimin e të dhënave matematikore, kalkulimin, interpretimin e rezultateve, dhe komunikimin e të dhënave matematikore) në nivele të ndryshme, në mënyrë progresive. Shiko Rezultat e arritshmërisë (standardet përmbajtësore) për Shkrim dhe Lexim Bazik dhe Komunikim ABET Niveli 1 (klasët 1-3) dhe Niveli 2 (klasët 4+5)

Dhjetë muaj pas provimit, asnjëra prej femrave nuk është informuar se a ka kaluar provimin apo jo. Portfoliot vetëm janë grumbulluar në një kënd të pluhurosur të Ministrisë. Zyrtarisht, MASHT-i nuk ka dhënë certifikata, me arsyetimin se nuk është bërë ekuivalenca dhe akreditimi i kurrikulave dhe se nuk janë definuar rezultatet e arritshmërisë për klasën e pestë të arsimit të obliguar. Përgjegjësia për një zgjidhje praktike mbetet në MASHT.

- MASHT-i duhet të veprojë shpejt dhe me efikasitet të arrijë ekuivalencën mes programit “Dritare Jete” dhe klasës së 5 të arsimit të obliguar që ata nxënës që duan të vazhdojnë arsimin e lartë dhe të punësohen t’iu mundësohet kjo zyrtarisht.
- MASHT-i urgjentisht duhet të themelojë një sistem efektiv të ekuivalencës dhe akreditimit të programeve të Arsimit Joformal, bazuar në Arsimimin Bazik të të rriturve dhe Sistemin e Trajnimit (shiko tabelën 1) dhe Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve.
- Kuvendi i Kosovës në përbërje të re duhet të orientojë përpjekjet në aprovimin e Ligjit për kualifikime dhe Kornizën Kombëtare pa vonesë.

Hyrja e ligjit në fuqi është vetëm hapi i parë, pastaj vjen implementimi i tij. Ligji për arsimin e të rriturve është nënshkruar më 22 korrik 2005 me qëllim që të promovojë mësimin gjatë gjithë jetës për të gjithë qytetarët.²⁰¹ Ky ligj e obligon MASHT-in që të

*‘krijojë kushtet e nevojshme për arsimin e të rriturve që të zhvillojnë shkathtësitë, njohuritë ... sipas nevojave të tyre’.*²⁰²

Ligji kërkon që MASHT-i të regjistrojë dhe licencojë arsimimin dhe trajnimin e të rriturve, të përvetësojë dhe aprovojë programe për trajnimin publik të të rriturve, të themelojë ekuivalencën dhe standardet e njohurive për njohjen e certifikatave dhe diplomave, të sigurojë cilësinë të mësimdhënësit dhe trajnerët dhe të ofrojë arsim kompensues për ata që nuk e kanë vijuar arsimin e obliguar.²⁰³ Ligji po ashtu thotë qartë se MASHT-i është përgjegjës të

*‘gjejë linjë të veçantë buxhetore për të financuar programet vjetore të arsimit të të rriturve’.*²⁰⁴

Realiteti është tjetër. Kur është pyetur në tetor të vitit 2007, sekretari permanent i MASHT-it ka thënë se nuk di çfarë shuma janë ndarë për arsimin e të rriturve.²⁰⁵

201 Ligji për arsimimin profesional dhe trajnimin, Ligji nr. 02/L-42, neni 1.1

202 Ligji për arsimimin profesional dhe trajnimin, Ligji nr. 02/L-42, neni 1.3

203 Ligji për arsimimin profesional dhe trajnimin, Ligji nr. 02/L-42, nenet 2, 7.1, 9.1, 11, 12, 23.2, 26.1

204 Ligji për arsimimin profesional dhe trajnimin, Ligji nr. 02/L-42, neni 36

205 Intervistë me Fehmi Ismajlin, Sekretar Permanent i MASHT, 19 tetor 2007

206 Intervistë me Fehmi Ismajlin, Sekretar Permanent i MASHT, 19 tetor 2007

Përveç një shërbyesit civil të punësuar, nuk janë ndarë as vija buxhetore e as staf tjetër për arsimin joformal.²⁰⁶ Programi 'Dritare Jete' është momentalisht e vetmja strategji për luftimin e analfabetizimit, por resurset dhe përkrahja institucionale nga MASHT janë minimale. Burokracia e brendshme në MASHT po ashtu kërkon shumë nënshkrime për të autorizuar një pagesë mujore prej 60 Eurosh për trajnerët e shkrimit dhe leximit bazik. Është bërë normale që pagesat të vonohen për disa muaj. Më me rëndësi është se deri sot as programi Ditare Jete apo ndonjë program tjetër i arsimit joformal nuk janë certifikuar zyrtarisht, gjë që shkel Ligjin e arsimit dhe trajnimit të të rriturve.

Duke marrë parasysh se programi Ditare Jete është i vetmi program gjithëpërfshirës dhe kompensues për arsim bazik, i cili funksionon dhe përfshin femrat e zonave rurale, ky është një test për përgjegjësinë e MASHT-it, si dhe mundësi për t'i kthyer ligjet ekzistuese nga letra në veprim. Kjo kërkon ndarje të mjaftueshme të buxhetit dhe stafit për të siguruar vazhdimin dhe qëndrueshmërinë e programit Ditare Jete.

Nga një këndvështrim më i afërt, rezultatet e arritshmërisë, objektivat dhe aftësitë për jetën, të definuara në Kornizën e Re Kurrikulare të Kosovës për Arsimin Fillor (1-5) dhe rezultatet e përshkruara në Shkrimin dhe Leximin Bazik për vajzat dhe gratë (niveli I-IV) faktikisht korrespondojnë në masë të madhe me programin Ditare Jete. Rezultatet e arritshmërisë në programin Ditare Jete përfshijnë shkathtësitë e shkrimit dhe leximit bazik që janë ekuivalente me ato të arsimit të obliguar (1-5, ISCED 1), përdorshmëria e gjuhës së shkruar dhe të folurit si mjet komunikimi, zgjidhja logjike e problemeve dhe matematika e aplikuar në situata reale jetësore, statistikat elementare, kalkulimi, të kuptuarit bazë të shkencave natyrore dhe vetëdija për ambientin. Plan-programi është po ashtu i dizajnuar të ngjallë interesim për histori, letërsi dhe art dhe të promovojë vlerat demokratike dhe vetëdijen për të drejtat e femrave dhe të fëmijëve. Disa elemente të caktuara janë posaçërisht të orientuara kah nevojat dhe interesat e femrave, si higjiena, rritja e fëmijëve dhe recetat për zierje. E vetmja pikë ndryshimi dhe një e metë e pashmangshme e programit Ditare Jete është mungesa e gjuhës angleze si gjuhë e huaj.

Për të siguruar ekuivalencë të programit Ditare Jete dhe të klasës së 5-të të arsimit të obliguar, MASHT-i duhet të ofrojë trajnime shtesë të gjuhës për mësimdhënëset e shkrimit dhe leximit bazik dhe/ose kurse intensive të gjuhës angleze të hartuara në mënyrë specifike për nxënëset femra. Po ashtu, MASHT-i mund të konsiderojë zëvendësimin e kërkesave të gjuhës angleze me rezultate alternative të arritshmërisë, përfshirë edhe gjuhët e tjera (p.sh gjermane), njohuri të avancuara të shkencave natyrore apo shkathtësi të jetës si ato të ndërmarrësisë apo të komunikimit. Ndryshe nga nxënësit e shkollave fillore, shumë nxënës të rritur janë tanimë në faza të shkathtësive të jetës që dalin përtej rezultateve të definuara ngushtë të arritshmërisë ekuivalente me klasën e 5-të.

Për akreditim dhe ekuivalencë të plotë të programit Ditare Jete, sigurimi i cilësisë është një pengesë. Në vitet e para, shumë fasilitatorë dhe trajnerë të programit janë rekrutuar me 'fjalë goje'

apo me kontakte personale. Përmes aftësimeve të shumta dhe përvojave me ekspertë ndërkombëtarë të arsimit, vullnetarët e hershëm të shkrimit dhe leximit bazik janë transformuar me sukses në trajnerë me përvojë. Ata janë një resurs i rëndësishëm për arsimin e të rriturve dhe skemat e trajnimit në të ardhmen.

Në interes të kualitetit të lartë të mësimdhënies, MASHT-i duhet të definojë kriteret objektive që duhet të përmbushen nga trajnerët e certifikimit në harmoni me Ligjin për arsimin dhe aftësimin e të rriturve. Për akreditim të plotë, trajnerët duhet të japin një provim të administruar në mënyrë të pavarur dhe t'i arrijnë kriteret e definuara nga MASHT-i. Ata që kalojnë testin duhet të njihen si trajnerë të certifikuar të shkrimit dhe leximit bazik dhe të kompensohen financiarisht për këtë. Për të pasur trajnerë të trajnuar mirë dhe me kualifikime të larta, donatorët duhet t'i ndihmojnë MASHT-it dhe t'i sigurojnë resurset dhe ekspertizën e duhur.

Programi Dritare Jete, për të përfshirë femrat që kanë më së shumti nevojë, po ashtu duhet të ofrohet në komuna të ndryshme. Një mangësi e veçantë e programit është se nuk ka arritur të ofrohet tek komunitetet më të varfra dhe plotësisht analfabete. Posaçërisht nënat që nuk kanë askend për t'u kujdesur për fëmijët e tyre dhe femrat e varfra që nuk kanë mundësi transporti nuk janë përfshirë.

Ka nevojë për fonde shtesë për t'u ofruar femrave më të pafavorizuara kujdesin për fëmijët gjatë orëve të mësimi si dhe transportin, e posaçërisht femrave që janë kryefamiljare.²⁰⁷ Po ashtu, MASHT-i në partneritet me autoritetet komunale dhe qendrat e trajnimeve profesionale mund të konsiderojnë të dërgojnë ekipe lëvizëse në lokacione të reja dhe ku femrat arrihen me vështirësi. Duhet fleksibilitet më i madh edhe me orarin e kurseve, që t'iu përshtaten nevojave të femrave të cilat nuk e kanë përkrahjen e familjes. Kurse intensive duhet të organizohen në bllok – gjatë sezonit së dimrit për shembull, mund të jenë një mundësi për të punuar në fermë dhe për të kryer obligimet për rritjen e fëmijëve.

Vetëdija publike për ekzistimin e një program të tillë mbetet e ulët, posaçërisht në vendet ku nuk janë mbajtur klasë deri tani. Shumë femra po ashtu nuk janë të inkurajuar për shkak të turpit, paragjyimeve apo kundërshtimeve që vijnë nga familja. Autoritetet lokale, udhëheqësit e komunitetit dhe zyrat e punësimit duhet të jenë më aktivisht të përfshirë në ngritjen e vetëdijes dhe inkurajimin e femrave nxënëse që të marrin pjesë në program. Kjo duhet të jetë pjesë e fushatës kombëtare të shkrimit dhe leximit bazik dhe një strategji për përfshirjen e femrave, që do ngriste vetëdijen për zakonet diskriminuese dhe normat sociale dhe të denonconte ata që kundërshtojnë mundësitë e barabarta, si dhe do të inkurajonte femrat të tejkalonin frikën dhe ndjenjën e turpit.

207 Vlerësimi afatmesëm, Raport përfundimtar, Mbështetja parandalimit të konflikteve dhe kohezioni social përmes zhvillimit në fëmijëri të hershme në Kosovë, nëntor 2004, fq.9

Programi Dritare Jete duhet të plotësojë nevojat e femrave që kërkojnë punësim dhe trajnim profesional, duke u siguruar femrave nxënëse shkathtësi të transferushme dhe për tregun e punës dhe të drejtën për të marrë pjesë në trajnimet profesionale aktuale dhe skemën e punësimit. Për të rritur mundësinë e punësimit të femrave rurale në veçanti, rekomandohet të përfshihen elemente shtesë të trajnimeve paraprofesionale. Duke marrë parasysh realitetin ekonomik në Kosovën rurale, vendet e punës për femrat që kanë kryer programin Dritare Jete janë të kufizuara dhe janë kryesisht punë manuale, si pastruese, personele të kuzhines, floktare dhe rrobaqepëse. Këto punë paguhen pak dhe ofrojnë pak mundësi për karrierë. Me trajnime shtesë, mundësitë e punësimit mund të zgjerohen dhe të përfshijnë punë kujdestareje të fëmijëve dhe infermiere (p.sh për persona të vjetër apo për persona me aftësi të kufizuara), punë në fermat komerciale apo edhe me prodhime bujqësore (p.sh industrinë e procesimit të frutave) dhe punë si recepcioniste, nëpunëse, manikuriste etj. Për të përgatitur femrat për ndërmarrësi dhe vetëpunësim duhet të përfshihen më shumë shkathtësi të drejtuara kah fusha e biznesit, siç janë skathtësitë e IT-së dhe të komunikimit.

Femrat e zonave rurale në Kosovë janë pjesë e rëndësishme dhe e padukshme e fuqisë punëtore të Kosovës, meqë janë duke bërë punë të lodhshme në fermat e familjes, punë të rënda në familje dhe duke u kujdesur për gjeneratën e ardhshme. Për momentin, femrat në Kosovën rurale kanë një kontroll të dobët të resurseve produktive; shumë pak femra fermere e kanë tokën në emrin e tyre. Femrat rurale kanë pak qasje në inputet dhe teknologjinë e fermave, kreditë dhe shërbimet e shtuara bujqësore. Këto shërbime janë të orientuara kryesisht kah meshkujt, shpesh meqë meshkujt janë agjentë dhe pasi që komunikimi mes femrave dhe meshkujve të zonave rurale nuk pëlqehet kulturalisht.²⁰⁸ Derisa femrat nuk janë në qendër të strategjisë së zhvillimit rural të Kosovës, produktiviteti i fermave dhe të hyrat në nivel kombëtar nuk do të kenë rritje.

Në të kaluarën, trajnime për të arritur shkathtësitë në sektorin bujqësor janë organizuar në shkallë të lartë, duke kombinuar bujqësinë dhe industrinë prodhuese. Asnjëherë shteti nuk ka ofruar sistem të trajnimit të shkathtësive që kanë si synim fermat e vogla familjare. I vetmi objekt formal që ka ekzistuar për trajnime profesionale në Institutin e Bujqësisë në Pejë është mbyllur tani vonë, për shkak të mungesës së kërkesës.²⁰⁹ MASHT-i po ashtu ka vendosur të heq dorë nga specializimet në bujqësi, të cilat kanë qenë pjesë e mësimin në shkollat të ndryshme profesionale. Kjo ka qenë posaçërisht e papritur në rastin e shkollës Xhelal Hajda-Toni në Rahovec, duke marrë parasysh rëndësinë e bujqësisë dhe agrobiznesit në Rahovec.²¹⁰ Tani, të vetmet trajnime të ofruara në ferma janë ad hoc dhe të organizuara nga OJQ-të dhe KFOR-i, përfshirë edhe Qendrën e Trajnimit në Lipjan dhe Farmën Rudina në Prizren.²¹¹ Sistemi i ri i zgjerimit të shërbimeve të bujqësisë (SZSHB) është duke u themeluar tani nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.²¹²

208 Puna e femrës dhe zhvillimi ekonomik, Kristin Mammen dhe Christina Paxson, Revistë e perspektivave zhvillimore, Vëllimi 14, Numri 4, Vjeshtë 2000, fq. 141-164

209 MASHT, MPBZHR, FAO 'Një strategji për arsimimin e popullsisë në viset rurale në Kosovë', fq.36

210 Intervistë me Sadik Deliu, sekretar, shkolla e mesme 'Xhelal Hajda-Toni', Rahovec, 21 shtator 2007.

211 MASHT, MPBZHR, FAO 'Një strategji për arsimimin e popullsisë në viset rurale në Kosovë', fq.32

212 Intervistë me Shaban Dreshaj, Drejtor, Sektori për Shërbime Këshilluese dhe Përkrahëse, në MASHT, nëntor 2007.

Politikëbërësit duhet të kuptojnë se investimet në arsimin e femrave rurale janë një mjet për transformim të zonave rurale. Për fuqizimin e femrës rurale, ata duhet të sigurojnë një arsim dhe trajnim të dizajnuar posaçërisht për ato. Femrat fermere jo vetëm që kanë nevojë për njohuri për prodhimet bujqësore, por ato duhet të dinë edhe për treg, çmime, standarde dhe burime alternative të të ardhurave. MASHT-i, në partneritet me MPMS, MBPZHR dhe aktorë të tjerë, duhet të hulumtojë mundësitë për përfshirjen e komponentës së trajnimit paraprofesional në plan programin Dritare Jete, që fokusohet në teknologjitë e ngritjes së produktivitetit, trajnimin për ndërmarrësi, komunikim dhe shkathtësitë për jetë.

Kosova ka nevojë për një program profesional tërësisht të akredituar të programit Dritare Jete, i orientuar drejt dhe i cili është pjesë përbërëse e strategjisë kombëtare të Arsimit dhe Aftësisimit të të Rriturve, që t'u ofrojë femrave të zonave rurale shkathtësi të jetës të përshtatshme për treg të punës. Kjo është bileta për një të ardhme më të mirë. Arsimitimi i të rriturve dhe krijimi i mundësive të punësimit janë të lidhura ngushtë dhe nuk mund të trajtohen si çështje të "një ministrie". Deri sot nuk ka pasur një politikë gjithëpërfshirëse dhe integruese për arsimimin e të rriturve. Ministrinë e Kosovës kanë një qasje të ndarë, politikat janë të fragmentuara dhe arsimimi i të rriturve është "copëtuar". Infrastruktura e tanishme e të mësuarit është e pazhvilluar, e stërshtirë dhe pa resurse të nevojshme. Ka një numër të pamjaftueshëm të institucioneve formale që ofrojnë arsimimin e të rriturve në nivel qendror dhe lokal.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka pohuar se *'përmirësimi i punësueshmërisë së fuqisë punëtore të Kosovës është aspekti më i rëndësishëm për lëvizjen e vendit drejt një ekonomie të lirë, duke siguruar më shumë konkurrencë mes ndërmarrjeve dhe zhvillim më të gjerë socio-ekonomik'*.²¹³ Tani është koha që të ndjekim këshillat e Fondacionit Evropian të Trajnimit dhe *'të zhvillojmë një sistem të arsimit dhe aftësisimit të të rriturve për të zvogëluar nivelet e analfabetizimit funksional dhe për të shtuar kompetencat bazë (përfshirë edhe ndërmarrësinë), veçanërisht tek të papunët'*.²¹⁴

213 Punësueshmëria në Kosovë, Vlerësim dhe opsionet për zhvillim, Punësimi dhe shkathtësitë
Observator, prill 2003, fq. vii

214 Fondacioni Evropian për Trajnime, Strategji për Kosovën, 2007, fq.4





KAPITULLI VI: DREJT LISBONËS

Bashkimi Evropian është dakorduar në Lisbonë që të synojë të ketë “ekonominë më konkurruese dhe dinamike në botë, të bazuar në njohuri, që mund të shpjerë në një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe të ofrojë punë të reja dhe më të mira.”²¹⁵ Strategjia e Lisbonës është lancuar bazuar në faktin se konkurrenca varet kryesisht nga investimet në kapitalin njerëzor. Njohuritë dhe kompetencat janë mjeti më i fuqishëm për përmirësimin e ekonomisë. Arsimit dhe trajnimit janë mjetet më të cilat shoqëria mund t’iu ndihmojë qytetareve që në mënyrë të barabartë të kenë qasje në përmirësimin e ekonomisë, vendimmarrje demokratike dhe zhvillim personal.²¹⁶

Duke marrë parasysh situatën e paparashikueshme ekonomike në Kosovë, investimi në kapitalin njerëzor bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Shoqëria e Kosovës paguan një çmim të lartë për qasjen joserioze që e ka ndaj arsimit dhe aftësimin profesional, analfabetizmit të femrave dhe mungesës së resurseve. Pabarazia gjinore dhe pabarazia në arsim dhe trajnim kanë një çmim të lartë.

“Pabarazia gjinore imponon kosto jodirekte, duke penguar produktivitetin, efikasitetin dhe progresin ekonomik. Me ngadalësimin e akumulimit të kapitalit njerëzor përmes paragjytimeve në shtëpi dhe në treg të punës, si dhe përjashtimit sistematik të femrave dhe meshkujve nga resurset, shërbimet publike dhe aktivitetet e caktuara produktive, diskriminimi gjinor ndikon në zvogëlimin e mundësisë së përparimit të ekonomisë dhe zhvillimit njerëzor.”²¹⁷

Sipas studimeve të fundit të OECD, një vit shkollor më shumë rezulton me një ngritje të prodhimit për kokë banori prej 4 deri në 7 për qind në aspektin afatmesëm apo afatgjatë.²¹⁸ Në SHBA, mesatarja e kostos bruto për shoqërinë, gjatë jetës së një 18- vjeçari që ka braktisur shkollën e mesme, vlerësohet të jetë përafërsisht 450.000 dollarë amerikanë. Kjo përfshin rënie në taksat e rrogave, shtimin e kërkesave të kujdesit shëndetësor dhe asistencës publike, si dhe shtimin e shkallës së krimeve dhe delikuencës. Në Mbreterinë e Bashkuar, nëse vetëm një për qind e popullatës punuese do të kishte nivelin A të shkollimit, në vend të të qenit të pakualifikuar, përfitimi do të ishte afro 665 milionë funta në vit, me reduktim të krimeve dhe ngritjes së potencialit për fitim.²¹⁹

215 Konkluzione të Presidencës, Lisbonë, paragrafi 37.

216 Raport nga Këshilli për Arsim Këshillit Evropian për objektivat konkrete për të ardhmen në arsim dhe sisteme të trajnimit, shkurt 2001

217 Stimulimi i zhvillimit përmes barazisë gjinore në aspektin e të drejtave, burimeve dhe të drejtës për t’u shprehur, Banka Botërore Raport për hulumtime të politikave, janar 2001, fq.74

218 Mirëqenia e kombeve: Roli i kapitalit njerëzor dhe social, Përmbledhje ekzekutive, OECD, fq.4

219 Komunikim nga Komisioni tek Këshilli dhe tek Parlamenti Evropian: Efikasiteti dhe drejtësia në sistemet Evropiane për trajnim dhe arsimim, shtator 2006, fq.3

Ndër më të rrezikuarit janë të varfrit, minoritetet, prindërit e ndarë dhe punëtorët me kualifikime të ulëta dhe ata me aftësi të kufizuar. Ekziston një lidhshmëri e ngushtë në mes të arsimit dhe pjesëmarrjes së lartë qytetare, vullnetarizmit dhe bamirësisë, si dhe nivelit të ulët të rrezikut nga aktivitetet kriminale.²²⁰

Një nga predispozitat për përparim ekonomik dhe zhvillim të shoqërisë është arritja e një niveli të lartë të shkrim-leximit dhe aftësive bazë të matematikës të popullatës. Shkathësitë bazë janë esenciale për vazhdimin e shkollimit dhe mundësitë për punësim në përgjithësi. Në një publikim të fundit për Strategjinë e Arsimit të të Rriturve në Evropën Juglindore, Fondacioni Evropian i Trajnimit ka nënvizuar:

‘Kualiteti i kapitalit njerëzor dhe shoqëror është përcaktuesi kryesor për të ardhmen e zhvillimit ekonomik, krijimit të pasurisë dhe përparimit shoqëror të çdo vendi. Nëse nuk ndërmerren veprime për të ngritur nivelin e përgjithshëm të shkathësisë në vendet në transicion dhe territoret në fjalë, kjo mund të jetë një nga pengesat kryesore në prodhim dhe konkurrencë, por po ashtu edhe në përpjekjet për zvogëlimin e varfërisë’²²¹

‘Drejt Lisbonës’ ka të bëjë me afrimin e Kosovës me Evropën në aspektin e zhvillimit të kapitalit njerëzor, shpenzimeve në arsimin e të rriturve, pjesëmarrjen e femrave në treg të punës dhe rritjen e të ardhurave për kokë banori. Për të pasur investime që do të sjellin rezultatet në të ardhmen e afërt, Kosova duhet të fillojë investime në popullatë tani. Që rinia e Kosovës të jetë përparësi e jo përgjegjësi politike dhe ekonomike, arsimi gjithëpërfshirës duhet të jete prioritet nacional. Qeveria aktuale duhet të mendojë përtej pavarësisë dhe të ndertojë ardhmërinë e vendit me dhe për të gjithë njerëzit që ajo i perfaqëson, përfshirë femrat, pakicat, personat me aftësi të kufizuar dhe të rinjtë. Para 2,625 vjetësh, kinezët kanë pasur një proverb të fuqishëm:

‘Kur planifikoni për një vit, mbillni misër. Kur planifikoni për një dekadë, mbillni drunj. Kur planifikoni për një jetë, shkolloni dhe arsimoni njerëzit’ Guanzi, 645 para Krishtit.

220 Mirëqenia e kombeve: Roli i kapitalit njerëzor dhe social, Përmbledhje ekzekutive, OECD, fq.4

221 Planifikimi i strategjive për mësimnxënien e të rriturve – Rasti i Evropës juglindore, Fondacioni Evropian për trajnime, 2006, fq. 9; për Kosovën, OBP ‘Plani për punësimin e të rinjve në Kosovë, 2007, fq. 14.

Rruga 'Drejt Lisbonës' është një sfidë e vërtetë. Në Bashkimin Evropian, 77.8 për qind e të rinjve kanë së paku arsimin e lartë të mesëm, në krahasim me 44 për qind në Kosovë.²²² Mësatarisht, 9.6 për qind e evropianëve të moshës 25-64 janë përfshirë në arsim dhe aftësim/trajnim në krahasim më 4 për qind në Kosovën rurale.²²³ Përfshirja e studentëve në arsimin e lartë në BE 27 ishte 15 për qind më 2004²²⁴ në krahasim më 13 për qind në Kosovë.²²⁵ Përfshirja mesatare e femrave në fuqinë punëtore në BE-25 ishte 62.6 për qind në krahasim me 33 për qind në Kosovë.²²⁶

Pa dyshim, ka dallime të mëdha mes vendeve anëtare të BE. Në vitin 2003 Finlanda ka pasur shpenzimet më të larta me 1.1 për qind të BPV, pastaj Hungaria dhe Holanda, të cilat kanë ndarë 1 për qind të BPV për arsimin profesional.²²⁷ Kosova për të shpenzuar 1 për qind të BPV në arsimin dhe aftësimin profesional do të duhej të harxhonte së paku 22 milionë Euro.²²⁸ Natyrisht, kjo zbeh dukshëm buxhetin e arsimit për vitin 2007, që arrin €34 milionë. Në të mësuarit gjatë gjithë jëtës dhe arsimimin e të rriturve, arritjet më të mëdha i kanë shënuar Suedia, Danimarka dhe Mbretëria e Bashkuar e më pas Finlanda. Sa i përket barazisë gjinore, Estonia, Bulgaria dhe Romania janë duke udhëhequr.²²⁹ Asnjë politikë apo përvojë e shteteve tjera nuk do të mund t'iu përshtatej nevojave të Kosovës, por ka shumë mësim që Kosova mund të nxjerrë nga përvojat e vendeve tjera, përmes një dialogu dhe bashkëpunimi të ngushtë me shtetet e ndryshme anëtare të Evropës.

Politikat arsimore janë të rëndësishme, por nuk mjaftojnë për të zgjidhur të gjitha problemet e Kosovës. Një qasje ndërsektoriale, që përfshin ministrinë dhe partnerët e ndryshëm, do të mund të nderlidhin politikat e arsimit dhe aftësim/trajnimin me ato të punësimit, zhvillimit industrial dhe rural, rinisë dhe shëndetësisë dhe së fundi, po aq të rëndësishme, me politikat që fuqizojnë mobilitetin e fuqisë punëtore në rajon dhe në Evropë.

Qeveria e Kosovës duhet urgjentisht t'i fokusojë përpjekjet e saj në zhvillimin e politikave të qëndrueshme dhe politikisht të pranueshme të migrimit të fuqisë punëtore. Kjo nënkupton marrëveshjet bilaterale me vendet e BE-së dhe shteteve fqinje, për të rënë në pajtim lidhur me skemat e migrimit të fuqisë punëtore dhe tejkalimin e çështjeve praktike, duke filluar nga të drejtat e pensionit deri te kujdesi shëndetësor. Kjo kërkon një qasje të koordinuar, që përfshin Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Arsimit, Ministrinë e Bujqësisë, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Zyrën e Kryeministrit. Në kontekstin e Evropës së 'plakur', fuqia e re punëtore e Kosovës është një mundësi si për politikëbërësit kosovarë, ashtu edhe ata

222 Përparimi drejt objektivave të Lisbonës në arsim dhe aftësim, treguesit dhe standardet, tetor 2007, Dokument pune i stafit të Komisionit

223 MASHT, MPBZHR, FAO 'Një strategji për arsimimin e popullsisë në viset rurale në Kosovë', fq. 72

224 Të dhënat kryesore mbi arsimin e lartë në Evropë, edicioni 2007, Eurostat

225 UNDP, Raporti për Zhvillim Njerëzor, 2006, fq.47

226 UNMIK, IPVO, ILO 'Plani i veprimit për rini në Kosovë', 2007, fq.16.

227 Përparimi drejt objektivave të Lisbonës në arsim dhe aftësim, treguesit dhe standardet, tetor 2007, Dokument pune i stafit të Komisionit

228 Korniza afatmesme e shpenzimeve 2008-2010, Vëllimi I, Makro Korniza Fiskale, 17 korrik 2007, Shtojca I, treguesit kryesorë, bazuar në vlerësimet e FMN-së, shkurt 2007, me BPV të supozuar prej 2,244 milionë eurove në vitin 2006.

229 Përparimi drejt objektivave të Lisbonës në arsim dhe aftësim, treguesit dhe standardet, tetor 2007, Dokument pune i stafit të Komisionit

evropianë. Deri në vitin 2050, Evropa do të ketë 65 për qind të popullatës mbi moshën 65- vjeçare dhe 20 për qind më pak të moshës së përshtatshme për punë (15-64 vjeçare).²³⁰

Arsimi duhet të jetë pjesë integrale e politikave të migrimit. Sidoqoftë, pyetja që duhet shtruar është – çfarë lloj arsimi dhe çfarë lloj migrimi? Në tërë botën, me ekonomitë moderne që mbështeten kryesisht në informata dhe njohuri, numri i vendeve të punës që kërkojnë shkollimin bazë është në zvogëlim e sipër. Deri në vitin 2010, 50 për qind e vendeve të reja të punës në Evropë do të kërkojnë kualifikim të lartë të nivelit universitar nga punëkërkuuesit dhe vetëm 15 për qind do të jenë të përshtatshme për personat me nivel bazë të arsimit.²³¹

Ky raport u bën thirrje politikëbërësve kosovarë që të definojnë strategjinë ambicioze të ashtuquajtur "Strategjia e Prishtinës" dhe të zhvillojnë një strategji për zhvillimin e kapitalit njerëzor. Sa i përket strategjisë, për të qenë efektive duhet të jetë e bazuar në fakte solide dhe të ketë standarde të matshme, linjë kohore dhe buxhet real. Suksesi është në interes të Europës, po aq sa është edhe në të Kosovës. Kosovës i duhet BE-ja si partner proaktiv dhe i mirëfilltë dhe BE-ja dëshiron stabilitet dhe prosperitet në 'kopshtin' e saj. Por, nuk do të ketë stabilitet pa zhvillim ekonomik dhe mobilitet të fuqisë punëtore. Nuk do të ketë zhvillim ekonomik në të ardhmen pa investime në kapitalin njerëzor sot. Është koha për politikëbërësit të jenë vizionarë dhe të kenë qëllime ambicioze.

230 European Commission Staff Working Paper (SWP) (SEC (2006) 1096)

231 Recommendation of the European Parliament and of the Council on 18 December 2006 on key competences for life long learning, artikulli 9





KAPITULLI VII: PËRMBLEDHJE E REKOMANDIMEVE PËR POLITIKA

**Vizioni për shoqërinë kosovare dhe për sistemin arsimor:
“Kosova-shoqëri e dijes, e integruar në rrjedha evropiane me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë individëve, të cilët i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror”²³²**

Shpallja e zhvillimit të burimeve njerëzore si prioritet kombëtar

- Hartimi i një plani kombëtar për zhvillimin e burimeve njerëzore deri në fund të vitit 2008, bazuar në dëshmi solide, duke përfshirë standarde të matshme, afate dhe buxhet real
- Sigurimi se të gjithë qytetarët arrijnë një nivel operacional të shkrim-leximit dhe njehësimit (siç është përcaktuar nga Bashkimi Evropian: shkathtësitë themelore të leximit, shkrimit dhe matematikës, si edhe mënyra për të mësuar dhe shkathtësitë e reja të përcaktuara në Lisbonë²³³ si: shkathtësitë e TI-së, gjuhët e huaja, kulturën teknologjike, ndërmarrësin dhe shkathtësitë sociale)²³⁴
- Përmirësimi i shkallës së regjistrimit të vajzave në shkollën e mesme dhe zvogëlimi i shkallës së braktisjes së shkollës në të gjitha nivelet
- Zhvillimi i fushatës kombëtare për të adresuar paragjykimet dhe pabarazitë gjinore në arsimim dhe punësim, përfshirë edukimin qytetar për prindër dhe programet për vetëdijësim me fokus në barazinë gjinore
- Shpallja e vitit 2009 si vit i ‘mësimi gjatë gjithë jetës’
- Hartimi i politikës kombëtare për shtimin e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës dhe rritja e pjesëmarrjes së popullatës në moshë pune në mësimin gjatë gjithë jetës
- ‘Krijimi i kulturës së të mësuarit’ duke ngritur mundësitë për mësim, rritur nivelet e pjesëmarrjes dhe duke stimuluar kërkesën për mësim

MASHT, komunitat, MPMS, MBPZHR, Zyra e Statistikave, donatorët, shoqëria civile dhe kompanitë publike/private

232 Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar në Kosovë 2007-2017, p.9, <http://www.ks-gov.net>

233 Në takimin e Këshillit të Evropës në Lisbonë (mars 2000), udhëheqësit e shteteve ose qeverive nxorën ‘Strategjinë e Lisbonës’ me qëllim që ekonominë e Bashkimit Evropian (BE) ta bëjnë si ekonominë më konkurruese në botë dhe që do të arrijnë punësimin e plotë deri me 2010; Konkluzionet e Presidencës, Lisbonë, parag. 37

234 Standardet specifikojnë se cka një i rritur pritet të jetë i aftë të bëjë në shkrim-lexim (shkathtësitë përfshijnë të folurit dhe dëgjuarit, të lexuarit dhe të shkruarit) dhe numërim (shkathtësitë përfshijnë të kuptuarit dhe përdorimin e të dhënave matematikore, llogaritjen dhe manipulimin me të dhënat matematikore, interpretimin e rezultateve dhe komunikimin e të dhënave matematikore) në nivele të ndryshme dhe në mënyrë progresive. Shiko rezultatet e të mësuarit për Shkrim-Lexim & Komunikim ABET Niveli 1 (shkalla 1-3) dhe Niveli 2 (shkalla 4+5)

<p>Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave për të siguruar se politikat e arsimit mbështeten në dëshmi solide</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe mbledhja sistematike e të dhënave kombëtare për burimet njerëzore, përfshirë edhe nivelet e shkathësive themelore të të punësuarve dhe të papunësuarve, si dhe nevojat e tregut të punës, shkallën e braktisjes dhe numrin e të regjistruarve • Themelimi i mekanizmave përcjellës për të diplomuarit nga shkollat e mesme, universitetet dhe institucionet për aftësi profesionale • Prezantimi i kulturës së vlerësimit përbrenda sistemeve të trajnimit 	<p>MASHT, komunitat, Zyra e Statistikave, organizatat ndërkombëtare</p>
<p>Rritja e fondeve financiare për arsimim dhe aftësi profesionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rritja e shpenzimeve për arsimim dhe aftësi profesionale deri në nivelet krahasuese me BE-në (1 për qind e BPV) • Rritja e dukshme e shpenzimeve për arsimimin e të rriturëve, në veçanti për femrat • Sigurimi i arsimimit kompensues, i cili ofrohet falas për të gjithë ata që kanë mbetur mbrapa në arsimimin e detyrueshëm ose e kanë braktisur herët • Sigurimi i fondeve të nevojshme për zbatimin e Ligjit mbi arsimimin dhe aftësimin profesional, Ligjit mbi arsimimin dhe aftësimin për të rritur dhe Rregullores e cila qeveris Këshillin për arsimimin dhe aftësimin profesional 	<p>Bashkimi Evropian, vendet anëtare, MASHT, MEF</p>

Rritja e mundësive për punësim përmes trajnimeve

- Përforcimi i shërbimeve të punësimit publik me personel dhe burime shtesë, si dhe investim në përmirësimin e shërbimeve për dhënie të udhëzimeve për karrierë
- Rritja e shkallës së pjesëmarrjes së të papunëve në programet për arsimimin dhe aftësimin profesional të financuara nga fondet publike, në më shumë se 1 për qind, sa është aktualisht
- Rritja e shkallës së pjesëmarrjes së femrave në aftësime profesionale nga 18 për qind sa është aktualisht, veçanërisht në mesin e femrave të cilat janë në pozita jo të favorshme
- Ofrimi i kurseve paraprake të aftësimeve profesionale të bazuara në nevoja dhe i mësimin të përshtetshëm për personat të cilët trajnohen, por të cilët janë në pozitë të pafavorshme
- Rishikimi i plotë i 23 profileve profesionale, duke iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës
- Sjellja e aftësimit profesional më afër personave të cilët aftësohen në viset rurale, duke dërguar ekipe mobile, duke krijuar objekte të ndara për aftësim dhe duke siguruar transport të subvencionuar
- Rritja e numrit të pjesëmarrësve më pak të arsimuar dhe trajnuar në krahasim me pjesëmarrësit me shkathtësi të larta
- Investimi në vetëdijësimin për çështje gjinore në mesin e zyrtarëve të punësimit publik, mësuesve dhe prindërve për t'iu qasur stereotipeve gjinore dhe ndarjes së profileve profesionale sipas gjinisë
- Dizajnimi i masave për zvogëlimin e dallimeve gjinore dhe zgjedhjeve 'tradicionale' të karrierës, duke i bërë profilet profesionale teknike më tërheqëse për vajzat dhe gratë e reja

MPMS, MASHT, MKRS, OJQ, zyrat e punësimit, Oda Ekonomike, partnerët social, kompanitë publike/private

Fuqizimi i MASHT-it

- Investimi në aftësimin shtesë të stafit dhe caktimi i mjaftueshëm i stafit në lëmenjtë prioritarë, përfshirë arsimimin për të rritur dhe aftësimin profesional
- Zhvillimi i një sistemi të integruar për arsimimin dhe aftësimin themelor të të rriturve dhe themelimi i një sistemi efektiv për barasvlerën dhe akreditimin e programeve për edukim joformal, bazuar në Sistemin e arsimimit dhe aftësimin themelor për të rritur dhe Kornizën kombëtare për kualifikime (sistemi ABETS)
- Mënjanimi dhe tejkalimi i barrierave tradicionale në mes të arsimimit dhe aftësimin formal dhe joformal, si dhe mbështetja dhe lehtësimi i iniciativave/rrugëve individuale të mësimin, që të sigurohet se i tërë mësimi është i vlefshëm dhe i transferueshëm
- Funksionalizimi i plotë dhe pa vonesë i Agjencisë së Akreditimit dhe kryerja e ndryshimeve të nevojshme ligjore për ta autorizuar atë, edhe për licencimin e arsimit parauniversitar dhe aftësimin profesional
- Fuqizimi i njësisë e cila është përgjegjëse për vlerësim dhe standarde brenda MASHT-it
- Investimi në zhvillimin e materialeve moderne për arsimimin joformal dhe profilet e ndryshme të arsimimit profesional

MASHT, organizatat ndërkombëtare

Zbatimi i ligjeve ekzistuese, harmonizimi dhe rishikimi i të gjitha ligjeve për arsimin, aftësimin profesional, punën dhe rininë

- Zbatimi i Ligjit mbi arsimimin dhe aftësimin profesional, veçanërisht i dispozitave për licencimin e institucioneve arsimore, miratimi i planprogramit, lëshimi i certifikatave të pranuar në bazë të Ligjit mbi kualifikime dhe Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve
- Zbatimi i Ligjit mbi arsimimin dhe aftësimin e të rriturëve, veçanërisht i dispozitës së ndërlidhur me regjistrimin e masave për arsimin dhe aftësimin e të rriturëve, miratimin e programeve publike për aftësimin e të rriturve, caktimin e standardeve dhe barasvlerës dhe njohurive, sigurimin e kontrollit të cilësisë në mesin e mësuesve dhe trajnerëve dhe ofrimi i arsimimit kompensues për ata që kanë ngelur prapa në arsimimin e detyrueshëm
- Alokimi i buxhetit vjetor për arsimimin e të rriturëve, në pajtim me Ligjin për arsimimin dhe aftësimin e të rriturëve
- Sigurimi i një bashkëpunimi të ngushtë mes Këshillit për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Agjencisë së Akreditimit, si dhe pajisja e Këshillit me buxhet dhe staf profesional në pajtim me rregullorën që e themelon këtë këshill
- Miratimi i Ligjit mbi kualifikimet dhe Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve pa vonesa të mëtutjeshme

MASHT, MPMS, Kuvendi i Kosovës dhe partnerët social

Integrimi i programit Dritare Jete në sistemin e arsimit dhe zgjerimi i shtrirjes së tij si pjesë e fushatës mbarëkombëtare për zhdukjen e analfabetizmit

- Licencimi i programit Dritare Jete dhe ndarja e mjaftueshme buxhetore dhe e stafit për të siguruar funksionimin normal dhe qëndrueshmërinë
- Kompletimi i udhëzimeve të nevojshme administrative për arritjen e plotë të barasvlerës në mes të programit Dritare Jete dhe klasës së 5-të të arsimit të detyrueshëm
- Themelimi i grupit punues për të përpiluar dhe rishikuar standardet, kriteret dhe mekanizmat për procesin e vlerësimit përkatës (mundësisht brenda Institutit Pedagogjik)
- Përfshirja e shkathtësive shtesë të tregtueshme dhe transferueshme dhe elemente të aftësisimit paraprofessional në plan-programin Dritare Jete, përfshirë kurse intensive të gjuhës angleze dhe/ose kurse të kompjuterit për t'i përmbushur kriteret për barasvlerë me arsimin e detyrueshëm
- Ofrimi i certifikatave të shkollës fillore duke u bazuar në rezultatin e provimeve për femrat të cilat kanë marrë pjesë në programin Dritare Jete dhe programe tjera të arsimit të detyrueshëm, për të siguruar se mësuesit të cilët dëshirojnë të vazhdojnë shkollimin e lartë ose të kërkojnë punë janë të pajisur më tituj përkatës
- Përcaktimi i kriterëve objektive për aftësuesit e certifikuar për të rritur, për të siguruar akreditimin e plotë duke u bazuar në një provim të administruar në mënyrë të pavarur dhe ofrimi i kompensimit adekuat për aftësuesit e certifikuar për mësimin e shkrim-lëximit
- Zgjerimi i programit në komuna tjera dhe dërgimi në terren i ekipeve mobile me fokus të veçantë në femrat më të varfëra dhe ato që është vështirë të arrihen
- Aranzhimi i orareve të kurseve në pajtim me nevojat e femrave, përfshirë edhe kurset intensive gjatë sezonit të dimrit
- Investimi në fushatën për vetëdijësimin e publikut në partneritet me komunat, zyrat komunale për punësim dhe udhëheqësit e fshatrave për të inkurajuar pjesëmarrjen e më shumë femrave
- Përfshirja e palëve të interesuara dhe ekspertëve të arsimit për të mësuar mësimin dhe përvoja më të mira nga Programi për shkrim-lëximin e femrave për t'iu përshtatur programeve tjera joformale të arsimit për të rritur

MASHT, MTI, Instituti Pedagogjik, komunat, donatorët, UNICEF, ILO, organizatat ndërkombëtare, OJQ, media, etj.

<p>Politika kombëtare e migrimit</p> <ul style="list-style-type: none"> • Arsimi dhe aftësimi të jenë pjesë integrale e politikës kombëtare për migrim, duke u bazuar në nevojat e tregut të punës në vendet e BE-së dhe vendet tjera pranuese • Hyrja në marrëveshje bilaterale me vendet anëtare të BE-së dhe vendet fqinje për skemat mbi migrimin e fuqisë punëtore • Zgjidhja e çështjeve praktike, nga të drejtat pensionale e deri tek përfitimet mbi kujdesin shëndetësor nëpërmjet koordinimit ndërministror 	<p>MPMS, MASHT, MBPZHR, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Shëndetësisë, Zyra e Kryeministrit, organizatat ndërkombëtare</p>
<p>Diversiteti rural</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hartimi i politikave për të diversifikuar ekonominë rurale të Kosovës përmes aftësimi dhe arsimimit i cili është i përqendruar në rritjen e produktivitetit bujqësor, lëvizjes tek punësimi jashtë fermës dhe krijimi i të hyrave përmes vetëpunësimi • Bërja e femrës dhe e të rinjve shtyllë qendrore e strategjisë kosovare për zhvillim rural dhe përmirësimi i qasjes në mjete dhe teknologji të nevojshme në ferma, kredi dhe shërbime të zgjeruara bujqësore • Ringjallja e interesit për shkollimin në bujqësi dhe rihapja e profileve të ndërlidhura me bujqësi në nivel të shkollimit të mesëm, duke u bazuar në plan-programin modern dhe duke u fokusuar në rritjen e produktivitetit dhe krijimin e të hyrave për fermerët • Përforcimi i bashkëpunimit me Ministrinë për Bujqësi dhe projektin SASS²³⁵ të financuar nga BE-ja • Zhvillimi i plan-programit specifik duke integruar elemente para-profesionale dhe profesionale të aftësimi, duke u përqendruar në shumëllojshmërinë dhe ndërmarrësinë rurale (p.sh. përpunimi dhe paketimi i ushimit, shkathësitë në marketing, administrimi i kafshëve, teknologjitë e fermave, etj) 	<p>MBPZHR, MPMS, MASHT, AER, organizatat ndërkombëtare</p>

235 Zhvillimi i Shërbimeve Mbështetëse Këshillëdhënëse Rurale, Projekt i BE-së për përkrahjen e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për shërbime këshilluese bujqësore

Ndërtimi i bashkëpunimit të ngushtë mes MASHT-it dhe komunave

- Përfshirja e komunave në fushatat lokale për arsimin dhe informimin e qytetarëve për luftimin e analfabetizmit dhe paragjytimeve
- Dizajnimi i shpërblimeve për mësimin e shkrim-leximit, shpërblimin për nxënësin më të mirë dhe shpërblimin për mësuesin si pjesë e fushatës kombëtare, e cila ushqen kulturën e të mësuarit
- Tërheqja e fondeve shtesë për grante për arsim për vajzat nga viset rurale dhe nxënësit e rritur, si dhe studentët tjerë të lënë anash
- Ndërmarrja e masave për subvencionimin e transportit dhe objekteve për kujdesin e fëmijëve për nënat që nuk kanë kush të kujdeset për fëmijët e tyre ose lirimi nga taksat për bizneset që ofrojnë shërbime të tilla
- Organizimi i kampeve arsimore për grupe të veçanta të nxënësve gjatë muajve të verës
- Definimi i detyrave dhe përgjegjësive mes MASHT-it dhe komunave, duke u bazuar në rishikimin e dhe harmonizimin e plotë të ligjeve dhe politikave ekzistuese

MASHT, komunitat dhe organizatat vendore të shoqërisë civile

NDIHMJA NDËRKOMBËTARE

- Bashkimi Evropian dhe qeveritë tjera të interesuara të sigurojnë fonde shtesë për zhvillimin e sistemit kombëtar për arsimimin dhe aftësimin për të rriturit
- Donatorët të japin më shumë fonde në lëmin e arsimit, aftësimin dhe mësimin gjatë gjithë jetës, për të ndihmuar Ministrinë në hartimin e planit kombëtar për zhvillimin e burimeve njerëzore, duke u bazuuar në dëshmi solide dhe hulumtim shtesë
- Donatorët të ofrojnë ndërtimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve përmes shtimit të programeve për aftësim dhe shkëmbim të përvojave brenda MASHT-it, MPMS-së, MBPZHR-së dhe nivelit lokal
- Përkrahja e shkëmbimit të përvojave dhe mësimave të nxjerra në mesin e vendeve anëtare të BE-së dhe Qeverisë së Kosovës
- Shqyrtimi i opsioneve për të rritur lëvizshmërinë e punëtorëve sipas nevojave të identifikuara të tregut të punës
- Hyrja në negociata me Qeverinë e Kosovës pa u vonuar mbi regjimin e vizave për lëvizjen e lirë si pjesë e strategjisë evropiane për tejkalimin e izolimit të Kosovës dhe shtimin e kontakteve të ndërsjella njerëz-me-njerëz

EU member states, Kosovo government, International organisations

ANEKS I: PROPOZIMI PËR SISTEMIN E ARSIMIT DHE AFTESIMIT BAZIK TË TË RRITURVE

Sugjerimi është të ndërtohet një ABETS (tabela 1), që do të:

- jetë pjesë e sistemit arsimor të Kosovës;
- integrojë masat ekzistuese, siç është Programi për arsimin bazik të vajzave dhe grave të rritura “Dritare Jete” (“Windows into Life”);
- është i barasvlershëm me Nivelin 1 (Leaving Certificate for Compulsory Education) të Kornizës së ardhshme Kombëtare për Kualifikime, me Nivelin 1 dhe 2 të ISCED-it dhe me 9 vjet të arsimit të përgjithshëm obligator;
- bazohet në kornizën e re të programit mësimor të Kosovës;
- jetë i hapur, fleksibil dhe nxitës në zhvillimin e kulturës për të mësuarit gjatë gjithë jetës në Kosovë;
- kombinojë përmbajtjen e fushave (profesionale) akademike dhe praktike të të mësuarit
- është i modular dhe i bazuar në rezultate
- është në harmoni veçanërisht me nevojat e të mësuarit dhe interesat e njerëzve dhe të rinjve, femrave, minoriteteve dhe grupeve të caktuara të anashkuara;
- shfrytëzojë burimet dhe masat ekzistuese;
- jetë bllok ndërtimi i strategjisë dhe sistemit për të mësuarit gjatë gjithë jetës në Kosovë.

Korniza e re e Programit Mësimor të Kosovës (edukimi formal)	Klasat e mësim-nxënies për minoritete (braktisjet e shkollës nën moshën 15)	Programi gjeneral për edukimin joformal (ka filluar në 2005 – të përfundojë)	Programi i arsimit bazik për të rritur “Dritare Jete” (edukimi joformal për femra ka filluar në 2001)	Arsimi dhe aftësimi bazik për të rritur (arsimi dhe aftësimi joformal)	ISCED Nivelet	Korniza Kombëtare për Kualifikime (propozim)	
9		9		4	ISCED 2	Q1 (Çertifikata për kryerjen e shkolimit të detyrueshëm)	
8		7 + 8		3			
7		5 + 6		2			
6		3 + 4	IV.	1	ISCED 1		
5			III.				
4			II.				
3			I.				
2		1 + 2					
1							

ANEKSI II: TABELA E SHKATHTËSIVË TË NEVOJSHME

Tabela: Shkathtësitë e ranguara sipas frekuencës së cekur

sektori kodi	shkathtësitë e kërkuara	frekuenca
O	certifikata për frizere	8
D	inxhinier elektrik/elektroteknik/teknolog, ekspertizë industriale/përpunuese,	7
D	prodhimtari të drurit, plastikës, tullave dhe mobilieve	6
D	Prej cilave: ekspertizë në prodhimtarinë e ushqimit (furrë, mullinj)	5
G	Shitës	5
O	Marketing	4
O	gjuhë e huaja (gjuha angleze për biznes)	3
O	ekspertiza në rrobaqepësi	3
H	kamerierë (gjuha e huaj)	3
D/A	teknikë	2
D/A	laborator (prodhimtaria e ushqimit)	2
O	asistent administrativ	2
H	kuzhinier	2
A	fakulteti bujqësor	2
D/A	shkathtësitë e vreshtarisë	1
D	inxhinier mekanik	1
D	përpunimi i metalit (metalgdhendës)	1
D	Ekonomist	1
D	Paketim	1
H	gastronomi/hoteleri	1
O	instruktorë të vozitjes	1
J	Kontabilist	1
N	stomatolog (impiant dental)	1
N	asistent farmaceutik	1
J	Arkëtarë	1
J	zyrtarë për kredi financiare	1
O	shkathtësi kompjuterike	1
O	sistemi kompjuterik i agjencive të udhëtimit	1
		68

ANEKSI III: SHEMBULLI I PETESORIT: FEMRAT

pjesëmarrëset (me provim)

pjesëmarrëset (braktisje)

tjera

A. Të dhënat personale

Emri/Mbiemri: _____;

Mosha _____;

Lokacioni: _____;

Statusi personal: e martuar beqare e shkurorëzuar vejushë

Sa fëmijë i keni? Totali: _____

djem _____ (specifiko moshën) vajza _____ (specifiko moshën)

Kursi shkrim-lexim: _____ (p.sh: 2002,3 vjet)

Programi për shkrim-lexim: po (ka kaluar) po (ka rënë) jo

Nëse Jo, ju lutem jepni arsyet

Shkollim tjetër: _____

(p.sh. 6 vjet të shkollës fillore, 1992-1998)

trajnime tjera profesionale:

(p.sh: 3 muaj kurs të rrobaqepësisë, në Skenderaj, 2004 organizuar nga GTZ)

B. Programi Shkrim-Lexim

Si keni mësuar për Programin e Shkrim-Leximit?

- kontaktuar nga OJQ
- prej miqve, shokëve
- Institucioneve publike (komuna, Ministria e Arsimit, Ministria e Punës)
- reklamës, broshurave etj
- tjetër (specifiko) _____

Motivimi për të marrë pjesë?

- të bëheni më të pavarur: (p.sh, që të mund të votoni, të shkoni në bankë, etj)
- që të punoni
- të vazhdoni shkollimin
- tjetër (specifiko) _____

Me çfarë sfidash jeni përballur gjatë vijimit të PSHK ? (ose, jepni arsytet pse e keni braktisur)

- rezistenca nga familja (kryefamiljari, bashkëshorti, vjehrra)
- çështje financiare (transporti, tjetër)
- Obligime familjare (kujdesi për fëmijë, përgatitja e ushqimit, puna në fushë)
- presioni social (turpi)
- tjetër (specifiko) _____

Si i përdorni njohuritë e fituara në jetën e përditshme?

A do të dëshironit të vazhdoni shkollimin??

- shkollën fillore deri në klasën e nëntë
- shkollën e mesme
- fakultetin
- trajnime profesionale:
- tjetër (specifiko) _____

A dëshironi të punoni jashtë shtëpisë?

- po jo nuk e di

Nëse PO, çfarë pune dëshironi të keni?

Specifiko llojin e profesionit/punës _____

Nëse Po, për çfarë trajnimi/kursi shtesë do të kishit nevojë ose do të dëshironit të merrni pjesë para se të filloni punën?

Specifiko: _____

Nëse Jo, pse nuk punoni?

- femra nuk duhet të punojë jashtë shtëpisë
- keni filluar të punoni, por e keni humbur atë vend pune
- nuk ka vende pune
- ka, por nuk janë të përshtatshme për ju
 - rezistenca familjare (kryefamiljari, bashkëshorti, vjehrra)
 - çështjet financiare (transporti, tjetër)
 - obligime familjare (kujdesi për fëmijë, përgatitja e ushqimit, puna në fushë)
 - ju mungojnë shkathtësitë duhura
- tjetër (specifiko) _____

Cilat profesione mendoni se janë më të përshtatshme për femrat?

Specifiko _____

Me çfarë kushtesh do të punonit jashtë shtëpisë?

- përkujdesje falas për fëmijë (parashkollorë, çerdhe)
- rroga minimale (specifiko) _____
- specifiko lokacionin _____
(p.sh. në fshat, distanca më këmbë prej shtëpisë, vetëm me anëtarët e familjes, etj)
- tjetër (specifiko) _____

C. Informatat për familje

Struktura e familjes sipas moshës

Mosha	Meshkuj	Femra	TOTALI
0 - 15 vjet			
16 - 65 vjet			
65 +			
TOTALI			

Anëtarët e familjes jashtë vendit

Mosha	Meshkuj	Femra	TOTALI
0 - 15 vjet			
16 - 65 vjet			
65 +			
TOTALI			

Specifiko marrëdhënie

Niveli i edukimit të familjes

Numri i anëtarëve të familjes që ndjekin shkollimin	Meshkuj	Femra	TOTALI
Parashkollor			
Shkolla fillore			
Shkolla e mesme			
Universiteti			
Shkollim tjetër terciar			
Trajnim tjetër profesional (specifiko)			
TOTALI			

Mosha e punës nga anëtarët e familjes

Niveli i shkollimit për 16- e më lart	Meshkuj	Femra	Totali
(A) analfabetë			
(B) < shkollën fillore (specifiko vitet)			
(C) Shkolla fillore			
(D) Shkolla e mesme			
(E) Universiteti			
(F) Shkollim tjetër terciar			
(G) Trajnim tjetër profesional (specifiko)			
TOTALI			

Struktura e familjes

Toka

 1-2 ha 2-5 ha 6-10 ha më shumë se 10 ha (specifiko sa) _____A e kultivoni tokën Po Jo

Kafshët

 1-3 lopë 3-6 lopë Më shumë se 6 lopë (specifiko sa) _____

Të dhënat për punësim

Anëtarët e punësuar	Informatat e përgjithshme			Vend i punës/aktiviteti	Të hyrat (mesatarja mujore)
	M/F	mosha	Niveli i shkollimit (A-G)		
Personi 1					
Personi 2					
Personi 3					
Personi 4					
Personi 5					
			TOTALI	Të hyrat mesatare mujore:	

Të regjistruar si të papunë _____ (specifiko numrin dhe gjininë)

Të hyrat mujore mesatare në familje

Të hyrat prej punësimit/aktiviteti _____

Të hyrat prej shitjes së prodhimeve bujqësore _____

Ndihma sociale _____

Pensioni _____

Tjetër (remitancat) _____

TOTALI: € _____

DREJT LISBONËS

Vlerësimi i nevojave për trajnime profesionale,
si dhe i krijimit të mundësive për punësim të femrave në zonat rurale

D. Kryefamiljari

Kryefamiljari	<input type="checkbox"/> Mashkull	<input type="checkbox"/> Femër
Mosha		
Edukimi (A, B, C, D, E, F, G)		
Specifiko drejtimin		
Trajnim profesional tjetër (specifiko)		
I punësuar	<input type="checkbox"/> Me pagesë (rregullisht)	<input type="checkbox"/> Pa pagesë
Tjetër (pension, invalid, ndihmë sociale)		

Kryefamiljari: Qëndrimet ndaj punës

A do të dëshironit që grua/vajza juaj të punonte jashtë shtëpisë?

po jo

Nëse jo, trego pse: _____

Cilat profesione mendoni se janë të përshtatshme për femrat?

Specifiko: _____

A do ta lejonit gruan/vajzën të punonte në profesionet e shënuara më poshtë:

Taksiste	<input type="checkbox"/> po	<input type="checkbox"/> jo
shitëse (shitore)	<input type="checkbox"/> po	<input type="checkbox"/> jo
kameriere	<input type="checkbox"/> po	<input type="checkbox"/> jo
zdrukthëtare	<input type="checkbox"/> po	<input type="checkbox"/> jo
Asistente administrative	<input type="checkbox"/> po	<input type="checkbox"/> jo

A do ta përkrahnit gruan/vajzën (edhe financiarisht) që të vazhdonte shkollimin apo/ose të merrte pjesë në kurset e trajnimit profesional?

Po, sa para _____

Jo

Varet (shpjego) _____

FUNDI I PYETËSORIT

ANEKS IV: SHEMBULLI I PYETESORIT: NDERMARRESI

A. IDENTIFIKIMI I NDERMARRËSIT/PUNËDHËNËSIT

Emri i ndërmarrjes: _____

Komuna/Vendi: _____

Emri i pronarit _____ Kontakti: _____

Forma e pronësisë Private Publike Shoqërore/Komercializuar

Informata shtesë

Data e themelimit _____ Data e privatizimit _____

Aktiviteti kryesor ekonomik (NACE) _____

Shembull i produkteve, mallrave që prodhohen ose shërbimeve që ofrohen:

B. TRENDET E PUNËSIMIT

Numri i punonjësve të rregullt sot (p.sh që marrin paga të rregullta mujore)

Meshkuj _____ Femra _____ Total _____

Punëtorë sezonal: Meshkuj _____ Femra _____ Total _____

Numri i punëtorëve të rregullt në fillim të themelimit (ose privatizimit)

Meshkuj _____ Femra _____ Total _____

Punëtorë sezonal: Meshkuj _____ Femra _____ Total _____

Numri i punëtorëve para dy vjetëve

Meshkuj _____ Femra _____ Total _____

Punëtorë sezonal: Meshkuj _____ Femra _____ Total _____

DREJT LISBONËS

102

Vlerësimi i nevojave për trajnime profesionale, si dhe i krijimit të mundësive për punësim të femrave në zonat rurale

C. EDUKIMI/NIVELI I SHKATHTËSIVE

Sa nga stafi juaj punojnë në pozitat vijuese?

	Pozita	M	F	Totali
A.	Drejtorë; Menaxherë; Pronarë			
B.	Pozita administrative dhe sekretariate			
C.	Punëtorët/Të punësuarit [të angazhuar në aktivitetin kryesor të biznesit; p.sh në prodhimin e tullave; në shitje në shitore			
D.	Staf ndihmës (kujdestar sigurie, pastrues etj)			
E.	Tjera			

Niveli arsimor i stafit

Shkollimi	Total	M	F	Paga mesatare mujore
Universitetin				
Shkollim tjetër terciar				
Shkollën e mesme				
Shkollën fillore				
Më pak se shkollën fillore				

Cilat profile/aktivitete në ndërmarrjen tuaj kërkojnë vetëm njohuri bazike të shkrim-leximit dhe shkathtësi numerike (më pak se shkollimin fillor?)

Numëroj: _____ Specifikoj: _____

D. VENDET E LIRA TË PUNËS - PUNËSIMI

Si i keni punësuar punëtorët në të kaluarën?

Përmes familjes: _____ (specifiko numrin)

Gazeta/Radio/përmes njoftimeve tjera _____

Zyra komunale e punësimit/Qendra për aftësi profesionale: _____

Tjera: _____ (specifiko)

E. TRENDET E PUNËSIMIT NË TË ARDHMEN

A mendoni se ndërmarrja juaj do të rritet brenda pesë vjetëve të ardhshëm?

po jo nuk e di

Nëse po, në cilat fusha specifike mendoni se do të ketë rritje?

Specifiko: _____

F. FUTURE SKILLS NEEDS

Do you expect to hire new staff in the next 12 months?

yes no don't know

Nëse po, për cilat profile dhe cili është minimumi i shkathtësive që kërkohen (p.sh shitës, shkollën e mesme, 2 vite përvojë pune)

Specifiko: _____

G. ANALIZA E NEVOJAVE PËR TRAJNIME

Cilat shkathtësi mungojnë në ndërmarrjen tuaj dhe çfarë trajnimesh shtesë do të jenë të nevojshme për punëtorët tuaj

Specifiko _____

A do të ishit në gjendje të paguani për trajnime shtesë për punëtorët tuaj?


po Sa: _____ jo

A keni organizuar ose keni marrë pjesë në ndonjë trajnim pune ose af në të kaluarën?

po jo

Specifiko _____ (p.sh programin aftësues të ILO-së)

HARTA E KOSOVËS



Burimi
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë SMIA 2007-08

Shënim: Vijat kufitare dhe emërtimi i përdorur në këtë hartë nuk paraqesin miratim zyrtar dhe të pranuar nga Kombet e bashkuara.